



RAPORT VJETOR 2013

RAPORT VJETOR PËR GJENDJET NË SFERËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË VITIN 2013

Raport vjetor për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë
në vitin 2013

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
REZIME	6
I. GJYQËSORI	13
1. Hyrje.....	13
2 Rasti Martin Neshkoski	16
3. Lustracioni	18
4. Gjykata Kushtetuese dhe autonomia e Universitetit	19
II. LEGJISLACIONI	22
1. Ligji për provimin e jurisprudencës.....	22
2. Ligji për ndërprerjen e shtatzanisë.....	23
3. Ligji për mbrojtje nga ngacmimi në vend të punës (Mobing).....	24
III. VEPRIMET POLICORE DHE INSTITUCIONET E MBYLLURA	26
1. Hyrje.....	26
2. Tortura policore në Ohër.....	27
3. Tortura policore në Demir Hisar.....	28
4. Maltretimi policor në shërbimin në Shkup.....	29
5. Tortura në INR Idrizovë.....	30
6. Mbipopullimi në njësitë e paraburgimit në burgje.....	31
7. Precedent gjyqësor me mbikëqyrjen ndërkombëtare të burgjeve.....	33
IV. DISKRIMINIMI	34
1. Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike.....	34
2. Diskriminimi ndaj bashkësive etnike	35
3 Diskriminimi ndaj grave dhe shkelja e të drejtave	37
4. Diskriminimi ndaj grupeve të marginalizuara - personave LGBTI.....	40
5. Diskriminimi në bazë të aftësive të kufizuara - personave të verbër	41
6. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi	42
V. VEPRA PENALE TË KRYERA NGA URREJTJA	43
VI. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE	47
1. Përkeqësimi i statusit të personave të zhvendosur brenda vendit.....	48
2. Personat me dëgjim të dëmtuar.....	49
3. Punësim jotransparent i kategorive të cënueshme të qytetarëve	50
4. Labirinhet juridike në sferën e mbrojtjes sociale	51
VII. TË DREJTAT E FËMIJËS	52
1. Rregullimi i marrëdhënieve familjare në rastet me element të huaj.....	52
2. Rasti Atanas Iliev - shkelje e vrazhdë e të drejtave të fëmijës	53

3. Rasti Tatjana Boshnjakovska	55
VIII. TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE	57
1. Nisma qytetare „AMAN“	57
2. Zgjedhjet lokale 2013	58
3. Shkelje e të drejtave për tubim dhe liri të shprehjes	59
4. Protesta të dhunshme	61
5. Gjuha e urrejtjes	63
6. Nisma për definim kushtetues të martesës si bashkësi mes një burri dhe një gruaje.....	64
7. Të burgosurit politikë.....	65
IX. Komuniteti LGBTI.....	70
Hyrje	71
1. Homofobia dhe dhuna.....	71
2. Institucionet	75
3. Korniza juridike	78
4. Mediat	80
5. Gjuha e urrejtjes	83
6. Mbështetja ndërkombëtare	84

HYRJE

Në pajtim me misionin e vet për të monitoruar situatën me të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Maqedonisë, Komiteti i Helsinkit çdo vit publikon raport vjetor, në të cilin paraqet pikëpamjet dhe mendimet e veta që kanë të bëjnë me të gjitha fushat në të cilat janë prekur të drejtat dhe liritë e njeriut. Raporti për vitin 2013 paraqet një përmbledhje të punës së Komitetit përgjatë gjithë vitit, në aspekt të monitorimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për të cilat kemi informuar në raportet mujore.

Vlerësojmë se edhe në vitin 2013, ashtu sikur edhe gjatë disa viteve të kaluara, u konstatuan shkelje serioze të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe shkelje drastike të parimit të sundimit të të drejtës dhe shtetit juridik. Gjatë kësaj, shqetëson veçanërisht fakti se shkeljet e regjistruara të të drejtave dhe lirive të njeriut, flasin jo vetëm për problemet sistemore në funksionimin e organeve dhe institucioneve, por edhe për keqpërdorim të kompetencave të tyre. Raporti vjetor paraqet një përmbledhje të analizave të situatave të konstatuara me të drejtat e njeriut në fushat e mëposhtme:

- Gjyqësor
- Vepra penale të kryera nga urrejtja
- Legjislacion
- Të drejtat ekonomike dhe sociale
- Veprim policor
- Të drejtat e fëmijës
- Institucionet e mbyllura
- Të drejtat dhe liritë civile dhe politike
- Diskriminim
- Komuniteti LGBTI

Duke marrë parasysh që Kushtetuta dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare garantojnë mundësinë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Komiteti i Helsinkit do të vazhdojë të monitorojë situatën e të drejtave të njeriut, t'i promovojë ato dhe t'u sigurojë mbrojtje juridike qytetarëve të cilëve u cënohen të drejtat dhe liritë.

REZIME

GJYQËSORI

Tradita e monitorimit të procedurave gjyqësore nga ana e Komitetit të Helsinkit të Republikës së Maqedonisë, si dhe programi për ndihmë juridike falas, ofron mundësinë për shqyrtimin dhe trajtimin e një numri të madh të çështjeve gjyqësore. Krahasuar me dekadën e kaluar, dukshëm është zvogëluar numri i lëndëve aktive gjyqësore, por akoma qëndrojnë probleme sistemore të cilat Gjyqësori nuk arrin t'i tejkalojë, i kapërcen shumë ngadalë, ose edhe i thellon.

Komiteti, gjatë punës së vet si mbikqyrës i proceseve gjyqësore, ka konstatuar një sërë paqëndrueshmëri sistemore: shkelje të prezumimit të pafajësisë; praktikë të shqiptimit të vendimeve kolektive, identike dhe stereotipike mbi paraburgimin; mosprezentim të përbërjes së Këshillit gjyqësor; mosrespektim të vendimeve të Kryetarit të Gjykatës Supreme për xhirimin e seancave kryesore; përjashtim të publikut gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar / mbrojtur dhe tejkallim të afateve për përpilimin e verdikteve; shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm; tejkallim të afateve për shpalljen dhe përpilimin e verdikteve.

Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë veçon rastin e Martin Neshkovskit, në të cilin u shkelën nenet 2 (e drejta për jetë) dhe 13 (e drejta e një ankese reale) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke qenë se policia dhe Prokuroria Publike bënë një hetim joefektiv të rastit të vrasjes, kurse gjykatat refuzuan të zhvillojnë procedurë gjyqësore. Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit përgatiti një ankesë të cilën ia dërgoi Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga aspekti i nismave drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë, me keqardhje konstaton se gjatë punës së Gjykatës çënohet parimi i ndarjes së pushtetit dhe çënohet pavarësia e sistemit gjyqësor nga pushteti ekzekutiv. Gjegjësisht, Gjykata Kushtetuese vendosi të mos fillojë procedurë për vlerësimin e të ashtuquajturit, Ligji i lustracionit, me çka i dha legjitimitet, padyshim, ligjit më antikushtetues të miratuar ndonjëherë në Maqedoni. Lidhur me lustracionin, Komisioni, të cilit i ka skaduar mandati, akoma vazhdon me këmbëngulje dhe me arrogancë të shkelë Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë (veçanërisht në pjesën e vlefshmërisë së ligjit pas vitit 1991), duke mos përfillur mendimin e Komisionit të Venecias të vitit 2012 dhe rekomandimet e përfshira në Rezolutën e Këshillit të Evropës 1096 (1996), ku procesi i lustrimit në Maqedoni me këto akte është në kundërshtim të plotë me të gjitha standardet mbi të

cilat duhet të zhvillohet ky proces - i cili u shndërrua në një “gjueti shtrigash” të hapur.

Gjithashtu, sa i përket ndikimit të drejtpërdrejtë të pushtetit ekzekutiv në punën e Gjykatës Kushtetuese dhe shkeljes së parimit të sundimit të së drejtës, me vendimet e Gjykatës Kushtetuese u bë shkelje e autonomisë së garantuar me Kushtetutë të Universitetit, në pjesën e vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit, punës dhe detyrimeve të Bordit për akreditim dhe evaluim, në të drejtën për të përcaktuar kriteret dhe kushtet për shkallën e parë, të dytë dhe të tretë të studimit, si dhe në kushtet për zgjedhje në titull mësimor-shkencor, për të vendosur në mënyrë të pavarur për shpenzimin e fondeve nga buxheti i Universitetit dhe për vlerësimin e njohurive të studentëve.

LEGJISLACIONI

Lidhur me praktikën e hartimit të ligjeve të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë që kërkojnë debat të gjerë publik dhe rregullojnë fusha të ndjeshme, Komiteti i Helsinkit thekson përdorimin e theksuar të procedurës së shkurtuar, me të cilën shmanget pjesëmarrja e opinionit profesional, veçanërisht kur ligjet e propozuara nuk janë përpunuar sa duhet dhe përmbajnë shumë risi. I tillë është rasti me Ligjin për Provimin e Jurisprudencës, ku shfrytëzohen zgjidhje që nuk korrespondojnë me sistemin tonë juridik, do të thotë kanë ndikime negative në gjyqësor dhe në punën e administratës shtetërore.

Në linjën e kritikave ndaj procesit të miratimit të ligjeve me procedurë të shkurtuar, veçohet miratimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzanisë. Njëherit, duke pasur parasysh nenet dhe paragrafët diskutabilë të këtij ligji, veçanërisht paraqitjen e obligueshme të kërkesës me shkrim për ndërprerjen e shtatzanisë së padëshiruar nga ana e gruas deri tek institucioni shëndetësor, këshillimin e detyrueshëm për përparësitë e mundshme nga vazhdimi i shtatzanisë, pritjen e detyrueshme prej tri ditësh pas këshillimit për të bërë ndërhyrjen mjekësore për ndërprerjen e shtatzansë, e të cilat janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, si dhe me dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë, me organizata të tjera joqeveritare dhe me doc.dr. Karolina Ristova Asterud paraqiti një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Abortin, për të cilën Gjykata Kushtetuese akoma nuk ka marrë vendim.

VEPRIMET E POLICISË DHE INSTITUCIONET E MBYLLURA

Lidhur me veprimin e policisë, duke iu referuar ankesave të paraqitura nga viktimat e torturës dhe anëtarët e familjeve të tyre, Komiteti i Helsinkit vepron edhe me vetëiniciativë, duke iu ofruar ndihmë juridike falas viktimave të torturave fizike dhe psikologjike në

institucionet e mbyllura (stacionet e policisë, qendrat e paraburgimit, burgjet dhe institucionet psikiatrike), të cilat duke pasur parasysh përjashtimin e konsiderueshëm të mediave dhe vëmendjen e opinionit, i çojnë viktimat në një vakuum institucional. Kështu, nga pretendimet e bëra në disa raste, ka indikacione të forta dhe dyshim të arsyeshëm se oficerët e policisë, të cilët dihet se kush janë, por edhe oficerë policie të panjohur, kanë kryer krimin Torturë, trajtim dhe ndëshkim tjetër mizor, çnjerezor e degradues.

Komiteti i Helsinkit përkujton se shteti ende nuk siguron mbështetje përkatëse ligjore, mjekësore, psikologjike dhe sociale për viktimat e torturës, kështu që është i domosdoshëm zbatimi i Direktivës së BE-së, 2012/29 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.

Së fundmi, sa i përket institucioneve të mbyllura, është e rëndësishme të theksohet se masa e paraburgimit dhe vendimet për zgjatjen e paraburgimit, ndonjëherë shfrytëzohen si masë ndëshkuese ose si një metodë frikësimi, siç u vërtetua edhe në rastin "Syri i gjarprit", në të cilin Komiteti i Helsinkit përfaqësonte të akuzuarit para Gjykatës në Strasburg, ku kjo praktikë e këtillë maqedonase u karakterizua si e kundërt me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

DISKRIMINIMI

Në bazë të ankesave të pranuara, Komiteti i Helsinkit arriti në përfundim se gjatë gjithë vitit 2013, diskriminim më i pranishëm ishte diskriminimi i bazuar në përkatësinë politike, përkatësinë etnike ndaj komunitetit Rom dhe diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Numri i shtuar i ankesave për diskriminim politik është rezultat i zhvillimit të zgjedhjeve lokale në prill të vitit 2013 dhe ndërrimit të qeverisjes lokale në disa komuna (Karposh, Ohër, Gostivar). Rasti më specifik është shkarkimi i 8 drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Gostivarit, nga ana e kryetarit të ri të komunës, pa respektuar procedurën e shkarkimit, përkatësisht vendimi për shkarkim duheshte të jetë marrë nga këshillat e shkollave përkatëse.

Për më tepër, në lidhje me diskriminimin, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë ka raportuar vite me radhë mbi diskriminimin shoqëror por edhe sistematik ndaj anëtarëve të bashkësisë etnike rome. Tema veçanërisht të ndjeshme në këtë drejtim janë diskriminimi ndaj romëve në pikat kufitare (si një shembull tipik i gjasave për diskriminim të shumëfishtë, në bazë të përkatësisë etnike dhe racore), ndarja dhe trajtimi diskriminues i fëmijëve Romë në sistemin arsimor, mungesa e qasjes në mallra dhe shërbime, kufizimet në të drejtën për punësim dhe të drejtat e marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë vë në dukje diskriminimin në bazë të orientimit seksual, duke pasur parasysh mosreagimin dhe selektivitetin në

veprimet e institucioneve pas sulmeve të shumta ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI. Prandaj, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë konkludon që institucionet duhet të pranojnë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për diskriminim, në mënyrë që pjesëtarët e komunitetit LGBTI të marrin mbrojtje dhe mbështetje nga institucionet, të cilat duhet të mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe të veprojnë në mënyrë që të parandalojnë dhunën.

VEPRA PENALE NË BAZË TË URREJTJES

Gjatë vitit 2013, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, në kuadër të projektit “Monitorimi dhe raportimi për veprat e urrejtjes”, i cili është financuar nga Misioni i OSBE-së në vend, regjistroi 116 krime të urrejtjes. Rreth 84% e krimeve të urrejtjes kanë ndodhur për shkak të përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës. Pothuajse në të gjitha këto incidente, janë të përfshirë maqedonasit dhe shqiptarët. Në pjesën më të madhe të incidenteve të regjistruara (103) që kualifikohen si krime të urrejtjes, viktimat dhe autorët e krimit zakonisht janë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike (maqedonase dhe shqiptare), dhe veprimet e kryera përfshijnë: sulm, mbajtje dhe përdorim të armëve të paligjshme, dëmtim të pasurisë, vandalizëm, kërcënim, dhunë, zjarrvënie, etj. Në lidhje me sa më sipër, Komiteti dëshiron të theksojë se shteti nuk mbledh të dhëna për krimet e urrejtjes dhe duke qenë se ky problem nuk është shfaqur në diskursin publik, është e pasigurtë nëse në të ardhmen e afërt do të kemi në dispozicion të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për veprat e urrejtjes. Për më tepër, krimet e urrejtjes nuk raportohen dhe nuk hetohen siç duhet nga autoritetet, të cilët duhet të jenë të trajnuar për identifikimin dhe përgjigjen ndaj krimeve të urrejtjes.

TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

Komiteti i Helsinkit nuk konstatoi ndonjë përparim as në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale, megjithëse opinioni ka përshtypjen se ato po promovohen, veçanërisht në fushën e të drejtave të mbrojtjes sociale, të drejtës për punësim dhe të drejtës për mbrojtje shëndetësore.

Mosfunksionimi institucional në këtë fushë, vërehet gjithashtu edhe në rastin e grupit më të madh të personave të shurdhër dhe personave me dëgjim të dëmtuar, të cilët nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre në komunikim, për shkak të mospërgjigjes së interpretuesve të kualifikuar nga shteti, edhe përkaj obligimit në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhës së shenjave. Lidhur me këtë çështje, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM - së, me disa shkresa, reagoi pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së

Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, në vazhdimësi të protestave të kësaj kategorie të qytetarëve, ku rezultati ishte fillimi i trajnimeve për interpretues të rinj, si dhe fillimi i trajnimeve të punonjësve në disa farmaci, me qëllim aplikimin e gjuhës së shenjave në punën e tyre.

Në fushën e të drejtës për punësim, në opinion, interes të jashtëzakonshëm ngjalli rasti me shpalljen publike për punësim në Ndërmarrjen publike „Pyjet e Maqedonisë“, me ç'rast në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të RM-së arritën numër i madh ankesash nga qytetarët për jotransparencë, padrejtësi dhe selektivitet në zgjedhje. Në këtë pjesë do të dëshironim të theksonim jofunksionalitetin e Gjykatës Administrative në mbrojtjen e këtyre të drejtave, e cila vazhdon me tendencën e mosvendosjes brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe me mosmarrjen e vendimeve meritore në rastet kur ka prova të mjaftueshme për një vendim të tillë, me të cilin në mënyrë efikase do të mbroheshin të drejtat sociale.

TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Në fushën e të drejtave civile dhe politike, gjatë vitit të kaluar, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM - së, me punën e vet mbuloi edhe zgjedhjet lokale (2013), kështu që Komiteti përmes zyrës së vet të hapur, u mundësoi qytetarëve të paraqesin shkeljet e të drejtës së votës dhe në këtë mënyrë u verifikuan një sërë parregullësish në procesin zgjedhor.

Në lidhje me të drejtën e tubimit dhe lirinë e shprehjes nëpërmjet të formës së protestës ose tubimit publik, Komiteti ndoqi disa protesta në të cilat policia nuk reagoi me kohë ose reagoi në mënyrë joprofesionale, dhe verifikoi shkelje ose përpjekje për të penguar tubim publik, gjë që flet për praktikën e kufizimit të të drejtës së garantuar kushtetuese për të protestuar. Kjo u referohet dy grupeve të qytetarëve, të cilët, përmes të drejtës për protestë paqesore, dëshironin të shprehnin pakënaqësinë e tyre për ndalimin e gazetarit Tomislav Kezharovski dhe një grupi të nxënësve të shkollave të mesme që protestuan kundër zbatimit të testimit ekstern.

Komiteti gjithashtu ndoqi edhe protestat e dhunshme në vitin e kaluar dhe arriti në përfundim se në Republikën e Maqedonisë grupe të caktuara, në mënyrë të pandëshkueshme shkelin Kushtetutën dhe ligjet në Republikën e Maqedonisë, duke përdorur forma të dhunshme të shprehjes së pakënaqësisë gjatë tubimeve publike në formë të protestës ose ndonjë lloji tjetër të tubimit publik, që përbën vepër penale. Kjo i referohet protestave që u zhvilluan në fillim të marsit, të cilat u përcollën me gjuhë urrejtjeje mbi bazën e përkatësisë etnike dhe më tej, me akte të urrejtjes. Gjegjësisht, për disa vepra të këtyre protestave, që përfshinin forma të ndëshkueshme të dhunës

në shprehjen e pakënaqësisë, si dhe për forcën fizike të përdorur nga oficerët e policisë, institucionet nuk ngritën procedurë kundër autorëve të veprimeve të mësipërme dhe as nuk morrën përgjegjësinë për reagimin e papërshtatshëm të policëve, të cilët u përleshën me turmën e revoltuar. Nga ana tjetër, gjuha e urrejtjes bazuar në përkatësinë politike u shpreh ndjeshëm gjatë protestave të organizuara nga lëvizja joformale civile "Veritas".

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM-së, i udhëhequr nga paragrafi 3 i Rezolutës 1900 të Këshillit të Evropës të vitit 2012 - ku i burgosur politik është një person, heqja e lirisë e të cilit vjen si rezultat i përcaktimit të paraburgimit, në kundërshtim me ndonjë nga garancitë themelore të përfshira në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe / ose paraburgimi është rezultat i një procedure që është padyshim e padrejtë dhe duket se lidhet me motivet politike të autoriteteve - i thekson rastet e personave Jovan Vranishkovski, Ljube Boshkovski, Tomislav Kezharovski dhe Miroslav Shipoviq, si procese të montuara politike, ku bëhet shkelje e të drejtave dhe lirive të të dënuarve.

KOMUNITETI LGBTI

Vitin e kaluar, krimet e urrejtjes ku orientimi seksual dhe identiteti gjinor shfaqen si motive, janë të dytat në listën e rasteve të raportuara dhe statistikave të mbajtura nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM - së. Madje, dhjetë raste janë denoncuar në qytete të ndryshme si Shkup, Manastir, Tetovë. Por, edhe përkundër dhunës homofobike të shfaqur në disa raste, me të cilat është i njohur opinioni (sulmet ndaj aktivistëve LGBTI në Manastir, sulmet ndaj shtëpisë së Petar Stojkoviqit dhe sulmet ndaj Qendrës së Mbështetjes LGBTI), institucionet dështuan të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme dhe në mënyrë implicite shfaqën trajtimin e përgjithshëm diskriminues ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI, të cilët nuk gëzojnë garanci për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Rëndon edhe më tepër fakti që orientimi seksual dhe / ose identiteti gjinor nuk njihen në mënyrë eksplicite si bazë për diskriminim, kurse gjykatat dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk e zbatojnë atë si bazë, as tërthorazi në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, megjithëse në këtë i detyron legjislacioni evropian lidhur me këtë fushë.

Në raportet e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi nuk ka të dhëna për rastet e diskriminimit në bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Në praktikën e shtetit ka një obstrukcion në dukshmërinë e këtij lloji të diskriminimit, kurse nxitja dhe përhapja e urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes ndaj personave të komunitetit LGBTI, nga ana e serviseve mediatike qeveritare dhe proqeveritare vetëm që e rëndon edhe më shumë situatën. Përherë e më shumë jemi dëshmitarë të veprave të kryera nga urrejtja, të sulmeve ndaj personave që marrin pjesë në manifestimet e LGBTI popullatës dhe kushedi për të satën

herë sulmohen ambientet e Qendrës për mbështetje LGBTI.

Qendra për Mbështetje LGBTI, si filial i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM-së, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), zyra në Shkup, filloi me realizimin e projektit Forcimi i kapacitetit të organizatave civile për pjesëmarrje në procesin legjislativ, ku Qendra do t'i kushtohet realizimit të nismës legjislative "Neni 3" Nisma qytetare për harmonizimin e të drejtës kombëtare antidiskriminuese me të drejtën e BE-së. Shtrirja e projektit është e kufizuar në nenin 3 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, kurse aktivitetet e Qendrës Mbështetëse LGBTI do të jenë në drejtim të përcaktimit ligjor të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza të veçanta të mundshme për diskriminim.

Duke pasur parasysh mungesën e parandalimit dhe mbrojtjes ligjore nga diskriminimi bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, pjesëtarët e komunitetit LGBTI janë të kufizuar në sigurinë e tyre dhe përballen me pamundësinë për të ushtruar plotësisht të drejtat dhe liritë e tyre. Një ekspozim i tillë i këtij komuniteti, në veçanti, thekson dhunën që nuk trajtohet institucionalisht, duke mos pasur një kornizë të përshtatshme legjislative dhe praktikë gjyqësore. Kjo pasqyrohet në dhunën si rezultat i gjuhës së urrejtjes. Prandaj, duke reaguar ndaj keqpërdorimit mediatic të lirisë së shprehjes si justifikim për përmbajtje të caktuara të botuara, që, në fakt, kanë elemente të gjuhës së urrejtjes, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM-së, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë u bëri thirrje që më në fund të njohin nevojën për përfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për gjuhën e urrejtjes dhe veprimet e urrejtjes, në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, gjë që do të ishte fillimi i realizimit të parimit të respektimit të dallimeve si një nga parimet themelore të një shteti demokratik.

1. HYRJE

Një nga aktivitetet themelore të Komitetit të Helsinkit është monitorimi i procedurave gjyqësore në të gjithë vendin, veçanërisht atyre të sferës penale dhe civile. Gjatë vitit 2013 u monitoruan dhjetra raste, gjatë disa qindra seancave gjyqësore. Përveç kësaj, përmes programit të vet të ndihmës juridike falas, Komiteti i Helsinkit ishte në gjendje të shqyrtojë dhe të veprojë në një numër të madh të çështjeve gjyqësore, përfshirë edhe ato që zhvillohen para Gjykatës Administrative. Megjithëse numri i lëndëve aktive gjyqësore ka rënë ndjeshëm, krahasuar me dekadën e kaluar (një fakt që, ndër të tjera, është për shkak të transferimit të çështjeve në juridiksion të noterëve dhe përmbaruesve), ende janë të pranishme problemet sistemore të cilat Gjyqësori nuk arrin t'i tejkalojë, i kapërcen shumë ngadalë, ose madje i thellon ato. Problemet kryesore gjatë zhvillimit të procedurave penale përfshijnë: shkeljen e prezumimit të pafajësisë; praktikën e shqiptimit të vendimeve kolektive, identike dhe stereotipike për paraburgim; mosprezentimin e përbërjes së këshillit gjyqësor; mosrespektimin e vendimeve të Kryetarit të Gjykatës Supreme për xhirimin e seancave kryesore; përjashtimin e publikut gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar / të mbrojtur; dhe tejkalimin e afateve kohore për përpilimin e aktgjykimeve. Ndërkaq, në lëndët civile, problemet më të shpeshta përfshijnë: shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor; tejkalimin e afateve për shpalljen dhe përpilimin e aktgjykimeve dhe mosrespektimin e parimit “barra e provës”.

1.1. Procedura gjyqësore të materies penale - juridike

a) Shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë

Në disa prej procedurave gjyqësore të monitoruara nga Komiteti i Helsinkit, kundër të pandehurve u shqiptua masa e paraburgimit. Gjatë shqyrtimit të vendimeve për përcaktimin dhe zgjatjen e kësaj mase, vërehet se në formulimin e tekstit për arsyet për të cilat caktohet paraburgimi, gjyqtarët shkelin prezumimin e pafajësisë. Gjegjësisht, në disa vendime të paraburgimit, të cilat i gjasojnë njëra tjetrës, thuhet se paraburgimi përcaktohet për shkak të “shkallës së përgjegjësisë penale” dhe “mënyrës së kryerjes dhe motiveve për kryerjen e veprave”.

Shkalla e përgjegjësisë penale dhe mënyra e motivet e kryerjes së veprimeve mund të verifikohen vetëm pas përfundimit të seancës kryesore, dhe jo gjatë hetimit ose gjatë procesit gjyqësor.

b) Vendime kolektive, identike dhe stereotipike për përcaktimin e masës së paraburgimit

Në procedurat e monitoruara në të cilat si të pandehur paraqiten më shumë persona, u verifikua që gjyqtarët ende përcaktojnë dhe vazhdojnë paraburgimin përmes vendimeve kolektive. Megjithëse është shënuar progres i dukshëm gjatë përcaktimit (gjyqtarët në paragrafë të ndarë i referohen çdo të pandehuri individualisht), vazhdon praktika e zgjatjes kolektive të paraburgimit për një grup të të pandehurve, emrat e të cilëve përmenden, por mungon një rishikim individual i arsyeve pse secilit të pandehur individualisht i zgjatet masa e paraburgimit.

c) Mosshpallja e përbërjes së Këshillit Gjyqësor

Si Ligji i vjetër, ashtu edhe Ligji i ri për Procedurë Penale parashohin që gjatë fillimit të seancës kryesore gjyqësore, kryetari i këshillit, përveç detyrimeve të tjera, duhet detyrimisht të shpallë edhe përbërjen e këshillit. Në mbi 90% të procedurave të monitoruara, kryetari nuk ka prezentuar përbërjen e këshillit. Megjithëse kjo nuk është një shkelje thelbësore e ligjit, prezentimi i këshillit është i rëndësishëm si për transparencën e procedurës ashtu edhe për llogaridhënien e anëtarëve të këshillave gjyqësorë.

ç) Ndalimi i xhirimit gjatë seancave gjyqësore

Sipas Ligjit për procedurë penale, në sallën gjyqësore nuk mund të bëhen xhirime televizive. Me përjashtim, me lejen e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, gazetarët mund të xhirojnë seancë të caktuara dëgjimore kryesore. Gjatë monitorimit të procedurave gjyqësore në Gjykatën Themelore Shkupi 1, vëzhguesit e Komitetit të Helsinkit në disa seanca kryesore vunë re se këshilli largon gazetarët pas xhirimit të inserteve të shkurtra, edhe atë para se të fillonte seanca kryesore. Për shkak të kësaj praktike të gjykatës, opinioni nuk mund të fitojë pasqyrë të plotë të kushteve në të cilat zhvillohet një lëndë penale, kurse lihet hapësirë për gabime gjatë informimit mediatik. Megjithëse është e padiskutueshme që gjyqtari i gjykimit, përkatësisht këshilli gjyqësor mund të vendosë që të mos xhirohen pjesë të caktuara të seancës kryesore, nga procedurat e vëzhguara deri më tani, u verifikua se nga kameramanët kërkohet që të largohen nga salla e gjyqit, pa u marrë vendim. Me një veprim të këtillë nuk respektohet leja e Kryetarit të Gjykatës Supreme.

d) Përjashtimi i publikut gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari të rrezikuar / të mbrojtur

Duke i ndjekur procedurat gjyqësore në të cilat si dëshmitarë paraqiten persona me identitet të fshehur, Komiteti i Helsinkit vërtetoi se rregullisht përjashtohet publiku. Në çështjen që në opinion njihet si "Rover", një nga të pandehurit ishte edhe ish-Ministri i Brendshëm, Ljube Boshkovski. Gjegjësisht, në këtë proces gjyqësor, nga prof. Dr.

Gordan Kallajxhiev, u dërgua një njoftim se i njëjti, në rolin e një punëtori shkencor, si profesor i procedurës penale në Fakultetin e Drejtësisë "Justiniani I", do të monitorojë seancën. Pëlqim pozitiv që opinioni profesional të mos përjashtohet nga prezenca gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të mbrojtur, dha edhe Prokurorja Publike, si propozues i dëshmitarit, me çka për herë të parë, nga ana e Prokurorisë Publike u tregua vullnet për një transparencë më të madhe në procedurën e dëgjimit të një dëshmitari të mbrojtur. Megjithatë, Këshilli Gjyqësor vendosi të përjashtojë publikun në tërësi, përfshirë edhe publikun profesional. Vendimet e vazhdueshme të këshillave për të përjashtuar publikun në rastet kur shfaqen dëshmitarë të mbrojtur, nuk lejojnë hapësirë për të përcaktuar nëse realizohet parimi i gjykimit të drejtë dhe fer.

Përjashtimi i publikut profesional paraqet shqetësim të veçantë, me që i njëjti do të ndiqte mënyrën e veçantë të dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur, në mënyrë që të verifikohet zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë mënyrën e mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimin e saj në parimin e gjykimit të drejtë.

e) Tejkalimi i afateve për përpilimin e aktvendimeve

Përshtypja e përgjithshme është se gjykatat ndonjëherë nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale në lidhje me afatet për përpilimin e aktvendimeve. Nuk respektohet afati prej 15 ditësh për përgatitjen e aktvendimeve, që llogaritet nga mbylja e seancës kryesore, kurse janë vërejtur edhe raste të tejkalimit të afatit prej 60 ditësh për çështjet më komplekse. Përkaj faktit që kjo praktikë ndikon në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, ajo mund të shkelë veçanërisht të drejtat e të pandehurve që ndodhen në paraburgim, një situatë në të cilën Kodi i Procedurës Penale parashikon procedura urgjente gjyqësore.

1.2 Procedura gjyqësore në fushën e të drejtës civile dhe administrative-juridike

a) Shkelje e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor

Në procedurat ku parashikohet zgjidhje urgjente e çështjeve që zhvillohen para gjykatave civile, u konstatua zvarritja e tyre, si dhe mosrespektimi i afateve të parapara ligjore. Një shembull tipik i zvarritjes së procedurave është vërejtur në kontestet ku përcaktohet përgjegjësi për fyerje dhe shpifje, si dhe në marrëdhëniet e punës, procedurat e të cilave sipas Ligjit për Procedurë Civile konsiderohen urgjente dhe të njëjtat, para gjykatës së shkallës së parë, duhet të përfundojnë në afat prej gjashtë muajsh. Kështu, për shembull, në një rast në sferën e marrëdhënieve të punës, u konstatua se që nga dita e ngritjes së padisë e deri në dhënien e aktvendimit, kishte kaluar një periudhë prej dy vitesh dhe gjashtë muajsh, gjë që paraqet tejkalim shumëfishor të afatit të caktuar kohor.

Gjykata Administrative edhe gjatë vitit 2013 vazhdoi me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe procedurat që zgjatën nga 7 ose 8 vjet, dhe në një rast 17 vjet, nuk kanë përfunduar ende. Refuzimi i Gjykatës Administrative për

të vendosur në mënyrë meritore për lëndët, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtat ekonomike dhe sociale të qytetarëve, ndikon në mbrojtjen efektive gjyqësore në këto raste, dhe kështu vjen deri te shkelja e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

b) Tejkalimi i afateve për shpalljen dhe përgatitjen e aktvendimeve gjyqësore

Përshtypje e përgjithshme është se gjykatat shumë shpesh nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile në lidhje me afatet për shpalljen dhe përgatitjen e aktvendimeve gjyqësore. Aktgjykimet pothuajse kurrë nuk shpallen menjëherë pas përfundimit të seancës kryesore (në përputhje me nenin 324, paragrafi 3 i LPC), edhe pse jo përherë bëhet fjalë për çështje më të ndërlikuara. Nuk respektohet as afati prej tetë ditësh, llogaritur nga dita e përfundimit të seancës kryesore, në rastet kur bëhet fjalë për çështje më të ndërlikuara (neni 324, paragrafi 4 i LPC-së). Situata është e ngjashme edhe gjatë përgatitjes së aktgjykimeve, përkatësisht edhe në këtë pjesë është vërejtur mosrespektim i afateve ligjore gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të aktgjykimeve, referuar nenit 326, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurë Civile.

c) Mosrespektimi i institutit “barra e provës”

Respektimi i institutit të zhvendosjes së barrës së provës, ka një rëndësi të madhe, si në drejtim të mbrojtjes së viktimave, ashtu edhe në drejtim të monitorimit të praktikës ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian. Me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e punës që i referohen mbrojtjes nga ngacmimi në vendin e punës, pasuar nga Ligji për mbrojtjen nga ngacmimi në punë dhe Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, është paraparë që barra e provës të binte mbi të pandehurin, nëse ai ose ajo ka të ngjarë të ketë qenë viktimë e diskriminimit, ngacmimit në vendin e punës, fyerjes apo shpifjes. Nga procedurat e vëzhguara në këto fusha, mund të konkludohet se gjyqtarët nuk praktikojnë, e as që përpiqen të krijojnë një praktikë për zhvendosjen e barrës së provës tek i pandehuri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet e diskriminimit dhe ngacmimit në vendin e punës, pasi që mbledhja e provave nga paditësi është e vështirësuar duke pasur parasysh që paditësit jo gjithmonë kanë qasje në informacion që do të provonte diskriminimin e pretenduar, pra ngacmimin. Për më tepër, kjo ndikon në fillimin efikas të procedurës për verifikimin e diskriminimit, gjegjësisht ngacmimit, përmes së cilës mund të kërkohen masa të përkohshme për mbrojtje nga viktimizimi.

2. Rasti Martin Neshkoski

Në qershor të vitit 2011, punonjësit dhe zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë u përpoqën të fshehin vrasjen e Martin Neshkoskit, që ndodhi në Sheshin „Maqedonia“ në Shkup. Organet gjyqësore zhvilluan procedurë vetëm kundër

vrasësit, i cili u dënua me 14 vjet burg. Në mars të vitit 2013, familjes Neshkoski iu dërgua një vendim përfundimtar i Gjykatës së Apelit të Shkupit, me të cilin refuzohej fillimi i procedurës gjyqësore përmes së cilës do të ishte e mundur të vërtetohej ekzistenca e fajit të mundshëm dhe të shqiptohej një sanksion i duhur penal kundër të gjithë atyre që ishin të përfshirë në këtë ngjarje. Hetimi joefektiv i vrasjes nga ana e policisë dhe prokurorisë publike, si dhe rrefuzimi i gjykatave për të zhvilluar procedurë gjyqësore, rezultoi në shkelje të Nenit 2 (e drejta për jetë) dhe Nenit 13 (e drejta e një ankese reale) të Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut. Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit përgatiti një ankesë e cila iu dërgua Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Përpjekja për të mbajtur fshehtë vrasjen nga ana e oficerëve të policisë të pranishëm në shesh, duke mos marrë përsipër kompetencat e policisë siç janë identifikimi, marrja e deklaratave nga dëshmitarët, sigurimi i vendit të ngjarjes, arresti i të dyshuarit dhe paraqitja e vrasjes, tregon në faktin se policët e uniformuar jo vetëm që nuk ishin të pavarur në veprimet e tyre, por edhe ata vetë kanë kryer vepra penale. Ata u bënë bashkëpunëtorë në vrasje, duke shkelur kështu të drejtën për jetë. Në rastin konkret, ka lëshime serioze në hetimin policor, por edhe një mungesë të qëllimshme të koordinimit midis shërbimeve të ndryshme të policisë të përfshira në vrasje. Në lidhje me hetimin nga Prokuroria Publike, shkelja e Nenit 2 të Konventës i referohet besimit të pakushtëzuar gjatë pranimit të versionit të ngjarjeve të përshkruar nga oficerët e policisë dhe mungesës së vetëiniciativës dhe efikasitetit gjatë hetimit. Se Prokuroria nuk i ndërmoi të gjitha masat hetimore, ndër të tjera, flet edhe fakti se kërkesa për sigurimin e video incizimeve nga kamerat e vendosura në shesh, u përcoll disa muaj pas vrasjes. Duke vepruar kështu, Prokuroria me vetëdije nuk ndërmoi njëri nga procedurat më të rëndësishme hetimore që e ka pasur në dispozicion.

Asnjë nga arsyetimet për shkak të të cilave nuk është zhvilluar procedurë gjyqësore, si të Prokurorisë, ashtu edhe të Gjykatës, nuk kanë mbështetje ligjore dhe nuk bazohen në faktet për këtë çështje. Sipas autoriteteve gjyqësore, nuk ekziston asnjë bazë dyshimi se oficerët e policisë, të pranishëm në shesh, kanë kryer veprat penale, të cilat pretendohet se i kanë kryer. Kjo nuk është e vërtetë për arsyen e thjeshtë se nuk mund të besohet që oficerët e policisë kanë menduar se Martini ishte i sëmurë, pasi që vetëm disa minuta para se ta shihnin atë pa ndjenja, kanë folur me të dhe ai ishte në shëndet të shkëlqyeshëm. Ata gjithashtu kanë parë që vrasësi po e ndiqte, siç është e sigurtë se kanë parë që kishte lëndime në trupin e tij. Njëri prej këtyre oficerëve të policisë pranoi se ai duhej të kishte marrë përsipër kompetencat policore, por nuk e ka bërë atë. Gjithashtu, nuk mund të pranohet fakti që gjykatat kanë besuar në të gjitha deklaratat e policëve të paraqitur, pa i dëgjuar fare gjatë procesit gjyqësor publik dhe kundërshtues.

3. Lustracioni

Procesi i lustracionit vazhdoi të zhvillohej në një mënyrë që vetëm e konfirmon konstatimin e përsëritur disa herë, se qeveria e përdor këtë proces për t'u marrë me kundërshtarët politikë dhe me të gjithë ata që kanë një qëndrim kritik ndaj politikave të qeverisë aktuale. Rastet që gjatë vitit 2013 ishin objekt veprimi i Komisionit për Verifikimin e Fakteve ilustruan edhe mënyrën joprofesionale të punës, në dëm të nderit dhe reputacionit të qytetarëve. Komisioni vazhdoi të funksionojë edhe pas përfundimit të mandatit të tij pesëvjeçar. Gjegjesisht, në janar të vitit 2014, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë nuk arriti të sigurojë kuorum për të zgjedhur anëtarët e rinj të Komisionit. Pa një zgjedhje të re të anëtarëve të Komisionit dhe pa transferimin e mandatit nga trupi ligjvënës, Komisionit iu desh të vetëshpërndahej. Në prill të vitit 2014, Gjykata Kushtetuese debatoi lidhur me nismën e paraqitur nga Komiteti i Helsinkit në vitin 2012, për rishikimin e të ashtuquajturit Ligji i lustracionit. U vendos që nuk do të fillohej procedurë për vlerësimin e ligjit, me çka Gjykata Kushtetuese i dha legjitimitet, pa dyshim ligjit më antikushtetues të miratuar ndonjëherë në Maqedoni.

Në rastin e Petar Karajanovit, me një vendim të komisionit, u përcaktua se ai „ka bashkëpunuar me organet e sigurimit të shtetit, në cilësinë e bashkëpunëtorit të fshehtë” me ç'rast si provë për aktivitetet e tij, u përdor një dosje e një personi tjetër, me të njëjtin emër dhe mbiemër. Faktet në lidhje me gabimin e bërë janë të pakontestueshme, duke pasur parasysh të dhënat themelore për „Petar Karajanovin tjetër”. Megjithatë, Komisioni për Verifikimin e Fakteve, përkundër parregullsive të paraqitura publikisht dhe indikacioneve të Komitetit të Helsinkit, përsëri qëndroi në vendimin e miratuar. Duke pasur parasysh se procedura e gabueshme ishte shumë e qartë, Komiteti i Helsinkit për z. Karajnov siguroi ndihmë juridike në përpilimin e aktpadisë në Gjykatën Administrative, e cila, pa argumente, vetëm që e konfirmoi vendimin e Komisionit. Gjykata e Lartë Administrative aktualisht po vendos mbi ankesën e paraqitur nga Komiteti i Helsinkit.

Komisioni për Verifikimin e Fakteve gjithashtu lustroi profesorin dhe ishministrin e Brendshëm dhe të Jashtëm, Ljubomir D. Frçkovski duke vërtetuar se ai ka qenë urdhëruesi dhe shfrytëzuesi i informatave të organeve të sigurimit të shtetit, në kohën kur ka ushtruar funksionin e ministrit të brendshëm. Me këtë akt të lustracionit, Komisioni për verifikimin e fakteve vetëm që konfirmoi tendencën për të ndjekur dhe etiketuar të gjithë kritikët e qeverisë aktuale, pa mbajtur llogari për funksionin themelor dhe qëllimin e ligjit të lustracionit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Procesi i lustracionit në vitin 2013 u shënuar edhe me lustracion të personave të vdekur, siç ishte rasti i shkrimtarit të shquar maqedonas Sllavko Janevski, gjë që flet për politikën tashmë të qartë të ndjekjes së figurave të shquara të sistemit të mëhershëm, pavarësisht faktit se lustracioni para së gjithash, ka për qëllim që të ndalojë personat që në sistemin e mëhershëm kanë bërë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, të ushtrojnë funksione

publike në sistemin aktual. Pas reagimit ndaj lustracionit të Sllavko Janevskit, menjëherë vijoi lustracioni i akademikut Tome Serafimovski dhe shkrimtarit Bozhin Pavlovski, gjë që padyshim tregoi se qëllimi ishte të ndëshkohen, pasi që ata dënuan publikisht lustracionin e Sllavko Janevskit.

Me këtë, pushteti ekzekutiv, përmes Komisionit, me këmbëngulje dhe arrogancë vazhdon të shkelë Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë (sidomos në fushën e vlefshmërisë së ligjit pas vitit 1991), duke injoruar mendimin e Komisionit të Venecias të vitit 2012 dhe rekomandimet e përfshira në Rezolutën e Këshillit të Evropës 1096 (1996). Me këto akte, procesi i lustracionit në Maqedoni është zhvendosur plotësisht nga baza e vet morale dhe është në kundërshtim me të gjitha standardet mbi të cilat duhet të zhvillohet ky proces, i cili u shndërrua në një “gjueti shtrigash” të hapur dhe u pushuan nga puna profesorë dhe intelektualë, si në ditët e errëta të komunizmit dhe njëmendësisë.

Komiteti i Helsinkit dëshiron të kujtojë edhe një herë indikacionin e Këshillit të Evropës se procesi i pastrimit me të kaluarën duhet të bazohet në parimet e ligjshmërisë dhe drejtësisë. Në kundërshtim me postulatet e tilla, procesi i lustracionit në Maqedoni është një shembull klasik i një procedure të inkuizicionit në të cilën të pandehurit nuk dëgjohen fare dhe nuk kanë mundësi të mbrohen. Si pasojë, për një numër gazetarësh, profesorësh, akademikësh dhe të tjerë, rezultati i kësaj procedure është i barabartë me sanksionin penal të Kodit Penal - ndalimin e kryerjes së një profesioni, veprimtarie ose detyre. Ky qëndrim përmbahet edhe në disa aktgjykime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për të gjitha këto arsye, Komiteti i Helsinkit do të vazhdojë të mbrojë në mënyrë aktive të drejtat dhe liritë themelore të të gjitha viktimave të pafajshme të procesit antikushtetues të lustrimit. Nëse Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative nuk sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave personale, mbrojtjen e integritetit personal, respektimin e privatësisë, jetën familjare, dinjitetin dhe reputacionin, Komiteti është i bindur se drejtësia do të vendoset para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

4. Gjykata Kushtetuese dhe autonomia e Universitetit

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, gati 2 vjet pas paraqitjes së iniciativave nga një grup profesorësh për vlerësimin e 18 dispozitave të ndryshimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe disa dekreteve dhe rregulloreve që rregullojnë kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, vendosi të fillojë një procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë vetëm të nenit 70, paragrafi 6 të Ligjit për arsimin e lartë i cili i referohet emërimit të kryetarit të bordit të akreditimit dhe vlerësimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë

dhe nenit 96, paragrafi 7, sipas të cilit mentori i tezës së doktoratës nuk mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e tezës së doktoratës. Bazuar në këtë, u iniciua një procedurë edhe për nenin 15, paragrafi 2 të Rregullores mbi normat dhe standardet për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, i cili është në korrelacion me nenin 96, paragrafi 7 dhe sipas të cilit mentori i tezës së doktoratës nuk mund të jetë anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Tezës së Doktoratës. Duke pretenduar që vetëm në këto dispozita mund të shtrohet pyetja e shkeljes së autonomisë së Universitetit dhe shkeljes së parimit të sundimit të së drejtës, Gjykata Kushtetuese nuk arriti të mbrojë autonominë e Universitetit nga ndikimi i ekzekutivit në fushën e vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit, punës dhe detyrimeve të Bordit të Akreditimit dhe Vlerësimit, në të drejtën për të përcaktuar kriteret dhe kushtet për shkallën e parë, të dytë dhe të tretë të studimit, si dhe kushtet për zgjedhjen në titull mësimor-shkencor, për të vendosur në mënyrë të pavarur për shpenzimin e fondeve nga buxheti i universitetit dhe për vlerësimin e njohurive të studentëve.

Ne besojmë se me vendime të tilla të Gjykatës Kushtetuese forcohet ndikimi i pushtetit ekzekutiv në punën e Universitetit, i cili sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë e ka të garantuar autonominë. Përveç kësaj, autonomia e universitetit dhe parimet sipas të cilave duhet të udhëhiqet secili vend gjatë sigurimit të kësaj autonomie, janë të parapara edhe me Deklaratën e Lisbonës të Shoqatës Evropiane Universitare dhe në Magna Carta të universiteteve, sipas të cilave është e domosdoshme ekzistenca e lirisë akademike, autonomisë financiare, autonomisë organizative dhe autonomisë kadrovike të universitetit.

Ndryshimet e fundit në Ligjin për Arsimin e Lartë, të cilat me propozim të Qeverisë, u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë pa diskutim paraprak profesional, tregojnë se fare nuk janë marrë parasysh reagimet e profesorëve të universiteteve dhe senatorëve për shkeljen e autonomisë së universitetit nga ana e pushtetit ekzekutiv. Gjegjësisht, me ndryshimet e reja parashihet që miratimi i programeve mësimore, librave nga të cilët do të mësojnë studentët, mënyra e votimit në vendimmarrje, mënyra e shpenzimit të fondeve të Universitetit, të bëhen nga pushteti ekzekutiv, me çka në vazhdimësi shkelet autonomia financiare. Lidhur me këto ndryshime, u paraqit përsëri një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese, por e njejta edhe një herë nuk arriti të mbrojë autonominë e Universitetit, duke hedhur poshtë edhe iniciativën e dytë për të filluar një procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë (neni 87-a, paragrafët 1 dhe 2 dhe neni 99, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Arsim të Lartë, në tërësi). Komiteti i Helsinkit nuk është i befasuar nga ky veprim i Gjykatës Kushtetuese, nëse marrim parasysh vendimin e mëparshëm për të njëjtin ligj, por edhe vendimet e marra nga kjo gjykatë gjatë gjithë vitit 2013. Në mendimin që e dha Gjykata Kushtetuese, përkundër shkeljes flagrante të autonomisë së Universitetit me ndryshimet e fundit, thuhet: Pozicioni themelor është që garantimi i autonomisë së universitetit, e vendosur me nenin 46 të Kushtetutës, nuk përjashton mundësinë e ndikimit të shtetit në

punën e Universitetit në çdo segment të funksionimit të tij, madje edhe në menaxhimin e mjeteve financiare, përmes Ministrisë përkatëse, që është në drejtim të respektimit të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kushtetutës.

LEGJISLACIONI

1. Ligji për provimin e jurisprudencës

Në tetor të vitit 2013, u miratua Ligji i ri për Provimin e jurisprudencës. Përkundër faktit që ligji i miratuar paraqet një zgjidhje e re, krejtësisht të ndryshme nga mënyra aktuale e zbatimit të provimit të jurisprudencës, shqyrtimi i propozimit në Parlament u zhvillua në një procedurë të shkurtuar. Sipas Ligjit të ri, ndryshimet parashihen në përbërjen e komisionit për realizimin e provimit, materialit profesional dhe shkencor, subjektit për zbatimin teknik të provimit (i cili parashihet të jetë privat e jo shtetëror), provim elektronik përmes kompjuterit, sistemit të pikëve, etj. Parashihet që zbatimi i Ligjit të fillojë në tetor të vitit 2014, kurse Ministrisë së Drejtësisë iu dha detyrë që deri kah mesi i shkurtit 2014 të miratojë një rregullore që do të përshkruante mënyrën e vlerësimit të provimit. Rregullorja nuk u miratua deri në mbyllje të këtij raporti.

Miratimi i një ligji të rëndësishëm siç është Ligji për Provimin e Jurisprudencës nuk mund dhe nuk duhej të ndodhte në një procedurë të shkurtuar. Gjegjësisht, procedura e shkurtuar sipas Rregullores së Punës së Kuvendit është paraparë për propozime të ligjeve që nuk janë komplekse dhe voluminoze. Komplexiteti i Ligjit për Provimin e Jurisprudencës reflektohet në faktin se ky provim është një nga elementët kyç për kryerjen e profesioneve juridike me përgjegjësi të lartë në sektorin privat, dhe veçanërisht në sektorin shtetëror. Nëpërmjet të provimit të jurisprudencës kontrollohen njohuritë e gjyqtarëve të ardhshëm, prokurorëve publikë, ombudsmanëve, noterëve, përmbauesve, avokatëve dhe pozicioneve të tjera të larta në administratën shtetërore. Ligji u miratua pa u konsultuar me Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Këshillin e Prokurorëve Publikë të RM-së, Dhomën e Noterisë, Dhomën e Përmbauesve, Odën e Avokatëve, Ministrinë e Drejtësisë, fakultetet juridike dhe opinionin tjetër profesional dhe shkencor.

Ligji përmban zgjidhje që nuk janë mjaft të qarta dhe mund të shkaktojnë huti dhe paqartësi gjatë zbatimit të tyre. Për shembull, ekzistojnë zgjidhje të tilla si „Pyetjet që janë pjesë përbërëse e studimeve të rastit janë të fushës së çështjes në të cilën bazohet studimi i rastit dhe kanë dhjetë përgjigje të mundshme, prej të cilave njëra është e saktë, pesë janë të ngjashme dhe katër janë të ndryshme”, se provimi „përmban 50 pyetje me pesë opsione rrumbullakimi, nga të cilat njëri është i saktë, dy janë të ngjashëm, një është i pasaktë në një shkallë të vogël (këtu humbet një numër i vogël pikësh) dhe një është i pasaktë në një shkallë të madhe (humben më shumë pikë)”. Mbetet e paqartë se sipas cilave kritere përpiluesi i pyetjeve do të përcaktojë se çfarë është e ngjashme dhe çfarë

është e pasaktë në „shkallë të vogël ”ose në „shkallë të madhe ”.

Gjatë hartimit të Ligjit, u morën parasysh disa zgjidhje të provimit amerikan të jurisprudencës.

Komiteti i Helsinkit konsideron se Ligji i propozuar për Provimin e jurisprudencës nuk është përpunuar mjaftueshëm, përmban shumë risi kështu që nuk duhet miratuar në procedurë të shkurtuar, shfrytëzon zgjidhje që nuk korrespondojnë me sistemin tonë juridik, i cili është shumë i ndryshëm nga ai Amerikan dhe mund të ketë ndikime negative në gjyqësor dhe punën e administratës shtetërore.

2. Ligji për ndërprerjen e shtatzanisë

Miratimi i ligjeve me procedurë të shkurtuar, madje edhe kur bëhet fjalë për rregullimin e fushave të ndjeshme që kërkojnë një debat të gjerë publik, është bërë një praktikë për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Nga kjo mënyrë e veprimit nuk u përjashtua as rregullimi i mënyrës së ndërprerjes së shtatzanisë, e drejtë e gruas e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Përfaqësuesit e Komitetit shpeshherë paralajmëruan për antikushtetutshmërinë dhe kufizimin e Ligjit të propozuar për ndërprerjen e shtatzanisë, si dhe për faktin se miratimi i tij me procedurë të shkurtuar, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, do të kontribuojë në shkelje thelbësore të të drejtave të njeriut dhe lirive të grave. Përkundër protestave të mbajtura para Parlamentit të Republikës së Maqedonisë nga disa shoqata të qytetarëve, fokusi i të cilave është barazia gjinore dhe mbrojtja e të drejtave të grave dhe mendimi negativ i shprehur në debatin publik në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, ligji i propozuar u miratua pa ndonjë ndryshim thelbësor.

Prandaj, Komiteti i Helsinkit së bashku me organizatat joqeveritare H.E.R.A. - Shoqata për edukim dhe kërkim shëndetësor, Koalicioni „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara”, Reaktori - kërkime në veprim dhe Doc.Dr. Karolina Ristova Asterud bashkarisht paraqitën një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë për të filluar një procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për ndërprerjen e shtatzanisë.

Në iniciativën e paraqitur kontestohen nenet dhe pikëpamjet që bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me dokumentet ndërkombëtare që i ka ratifikuar shteti dhe që në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj.

Në këtë drejtim, iniciatorët e mësipërm konstatuan se shtimi i formulimit „procedura

për miratimin e abortit”, si dhe vetë procedura për ndërprerjen e shtatzanisë, ndalimi për ndërprerje të përsëritur të shtatzanisë brenda një viti, leja e prindit / kujdestarit për vajzat e mitura dhe personat me aftësi të kufizuara, paraqitja e një kërkesë me shkrim për ndërprerjen e shtatzanisë, këshillimi i detyrueshëm, detyra e mjekëve për të këshilluar mbi përparësitë e shtatzanisë dhe miratimi i akteve dhe rregulloreve në lidhje me ndërprerjen e shtatzanisë nga Ministri i Shëndetësisë, përbërja e Komisionit që vepron sipas kërkesave të paraqitura dhe mungesa e mbrojtjes gjyqësore krijojnë mundësi për ndërhyrje të shtetit në të drejtën për zgjedhje dhe vendim të lirë të gruas dhe janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Konventën për të gjitha format e eliminimit të diskriminimit ndaj gruas, Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe protokolin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Në fakt, Ligji për Abortin shkel drejtpërdrejt të drejtën e privatësisë, i cili përfshin edhe jetën familjare, bëhet diskriminim sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, shkelje e rëndë e rendit juridik, përkatësisht ndarje e pushtetit në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ekzistojnë baza për torturë, përkatësisht trajtim çnjerëzor të kategorive të cënueshme të qytetarëve. Për më tepër, Ligji ka shkelur legjislacionin ekzistues ose Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe në mënyrë të vrazhdë ndërhyr në fushën e shëndetit riprodhues, duke shkurtuar aftësinë afariste të gruas për t’u kujdesur në mënyrë të pavarur për shëndetin e saj, në pajtim me nenin 39 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

3. Ligji për mbrojtje nga ngacmimet në vendin e punës (Mobing)

Komiteti i Helsinkit mirëpriti iniciativën për të miratuar një ligj të veçantë për mbrojtje nga ngacmimet në vendin e punës, sepse nenet ekzistuese në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës nuk ishin të mjaftueshme për të mbrojtur punonjësit nga ngacmimet psikologjike dhe seksuale në vendin e punës. Megjithatë, besojmë se i njejtë është i paqartë dhe nuk është gjithëpërfshirës, për ç’arsye nuk do të jetë në gjendje të mbrojë punonjësit nga ngacmimet psikologjike dhe seksuale në vendin e punës.

Në procesin e përgatitjes së Ligjit, Komiteti i Helsinkit, në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale paraqiti vërejtjet e veta mbi këtë projektligj, dhe atë si vijon:

Mungon përkufizimi i asaj se çfarë paraqet ngacmim seksual; ekziston nevoja për plotësimin e nenit 3 me një paragraf që përcakton se një person i ekspozuar ndaj mobingut nga ana e organit punëdhënës, personit juridik ose personit fizik si punëdhënës, mund të fillojë procedurë gjyqësore për mbrojtje nga mobingu, pa qenë i detyruar të drejtohet me shkrim për të treguar se i pengon sjellja e tij; domosdo duhet të precizohen kushtet që punëdhënësi duhet t’i sigurojë në procesin e punës, me qëllim që puna të kryhet në një atmosferë të respektit të ndërsjellë e bashkëpunimit, pa sjellje armiqësore, poshtëruese

ose fyese, nevoja për precizim të profilit profesional, kualifikimet dhe trajnimet që duhet t'i kenë personat që mund të jenë ndërmjetës në procedurën e pajtimit, të paraparë me projektligj; propozoi fshirjen e nenit 19 që parasheh se personi i cili mendon se po i bëhet mobing duhet të drejtohet me shkresë deri te punonjësi ose personi për të cilin konsideron se po i bën mobing, si kusht për fillimin e një procedure për mbrojtje nga mobingu, pasi që me këtë ngarkohet dhe zvarritet procedura për mbrojtje nga mobingu; domosdoshmërinë e specifikimit të dispozitave që përcaktojnë barrën e provës në rast të një kontesti gjyqësor, me qëllim që i njehti të bjerë mbi të pandehurin.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale na informoi se janë pranuar vërejtjet në lidhje me mungesën e një përkufizimi të asaj se çfarë përbën ngacmim seksual, nevojën për të plotësuar nenin 3 me një paragraf që përcakton se një person i ekspozuar ndaj mobingut nga një organ punëdhënës në person juridik ose person fizik si punëdhënës, mund të fillojë procedurë gjyqësore për mbrojtje nga mobingu pa u drejtuar me shkrim, për të treguar se sjellja e tij e shqetëson, si dhe që projektligji është plotësuar në përputhje me vërejtjet e pranuar.

Komiteti i Helsinkit gjithashtu ishte i ftuar në debatin publik për ligjin në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, ku vërejtjet e mësipërme u ritheksuan, duke përfshirë edhe vërejtjet mbi ndryshimin e marrëveshjeve kolektive për sektorin publik dhe privat, barrën e provës në rast të kontestit gjyqësor, mosfunksionalitetin e ligjit kur është fjala për ndërmarrje të vogla me disa të punësuar.

Megjithatë, vërejtjet e Komitetit të Helsinkit nuk u pranuan dhe Ligji u miratua në formën e propozuar. Prandaj, jemi të bindur që dispozitat e konceptuara në këtë mënyrë nuk mbrojnë plotësisht të drejtat e viktimave të mobingut dhe nuk lehtësojnë procedurën e provës së mobingut, gjë që lehtë mund të shkaktojë huti tek punëtorët, punëdhënësit, por edhe në veprimet e organeve gjyqësore.

VEPRIMET E POLICISË DHE INSTITUCIONET E MBYLLURA

1. Hyrje

Në vitin 2009, përmes ndryshimeve të Kodit Penal, u ashpërsua politika ndëshkimore për veprën penale torturë dhe dënim ose trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues. Sipas dispozitave aktuale, sanksioni i parashikuar për torturë është nga tre deri në dhjetë vjet burgim, ndërsa për maltretim gjatë kryerjes së detyrës, dënimi është prej një deri në pesë vjet burg. Republika e Maqedonisë ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha konventat në lidhje me parandalimin e torturës. Kështu, legjislacioni kombëtar zyrtarisht është harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Ligji për Policinë, si dhe aktet nënligjore që dalin prej tyre, megjithëse janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, nuk zbatohen plotësisht, kështu që shteti dështon në zbatimin e detyrimeve të veta ndërkombëtare.

Në periudhën 2009-2012, vetëm tetë persona u dënuan për maltretim gjatë kryerjes së detyrës, dy prej të cilëve u dënuan me burg, ndërsa gjashtë të tjerëve iu shqiptua dënimi me kusht. Në këto vite, përfshirë edhe vitin 2013, nuk është shqiptuar asnjë aktgjykim për veprën penale torturë. Nga ana tjetër, në tre vitet e fundit, Komiteti i Helsinkit ka marrë dhjetra ankesa nga viktimat e torturave dhe nga anëtarët e familjeve të tyre, por Komiteti gjithashtu ka vepruar edhe me vetëiniciativë, duke u takuar me viktimat dhe duke u ofruar atyre ndihmë juridike. Shumë prej këtyre viktimave iu nënshtruan torturave fizike dhe psikologjike në institucione të mbyllura (stacionet e policisë, njësitë e paraburgimit, burgjet dhe institucionet psikiatrike), larg vëmendjes së publikut dhe mediave.

Mekanizmat e mbikëqyrjes janë vetëm pjesërisht funksionale dhe nuk mund të konsiderohen të pavarura. Me hyrjen në fuqi të Protokollit Opsional të Konventës kundër torturës dhe dënimit ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, në vitin 2009, Ombudsmani u emërua si Mekanizmi kombëtar parandalues i cili filloi të ushtrojë kompetencat e veta në vitin 2011. Efikasiteti i këtij mekanizmi në tri vitet e para është në nivel jo të kënaqshëm, veçanërisht për shkak të mungesës së stafit profesional dhe të mospjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile, kështu që, edhe pse është i mundur, ky mekanizëm nuk zbatohet në praktikë. Puna e Ministrisë së Brendshme (MPB) i nënshtrohet kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe Avokati i Popullit kryejnë kontrollin e jashtëm, ndërsa Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në Ministrinë e Brendshme kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e brendshme. Komisioni Shtetëror për mbikëqyrjen e Institucioneve

ndëshkuese - rehabilituese, vendimet e të cilit do të ishin të obligueshme për të gjithë ata të cilëve u referohet, është i formuar vetëm në letër. Nuk është aktiv dhe nuk i kryen kompetencat e tij. Prandaj, me përjashtim të Avokatit të Popullit, në Maqedoni nuk ka mekanizma të tjerë të përhershëm për mbikëqyrjen e burgjeve dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Për shkak të këtyre parregullësive, vazhdojnë akoma të jenë të pranishme problemet kryesore të identifikuara në fushën e institucioneve të mbyllura: mbipopullimi, kushtet substandarde të jetesës, higjiena e papërshtatshme, qasja e pamjaftueshme në shërbimet juridike, etj. Në vitin 2013, një numër i konsiderueshëm i të dënuarve dhe të paraburgosurve u ankuan në Komitetin e Helsinkit duke theksuar se nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbrojtje shëndetësore. Këta qytetarë, si rezultat i përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, me vetëiniciativë kërkojnë që me shpenzimet e veta, t'u mundësohet mjekim i përshtatshëm ose të ekzaminohen nga mjekët e tyre të familjes. Përmes disa shembujve, Komiteti i Helsinkit vërtetoi se punonjësit në institucionet e mbyllura vonojnë pa nevojë procedurat për kërkesat e tilla, kurse shumë shpesh nuk mundësohen ekzaminimet jashtë institucioneve.

2. Torturë policore në Ohër

Gjatë muajit prill, personi Jane Milloshoski nga Ohri iu drejtua Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Sipas pretendimeve të tij të mbështetura nga provat (deklarata noteriale e një dëshmitari dhe raporti mjekësor), në mars të vitit 2013, z. Milloshoski u sulmua fizikisht, u maltretua dhe u poshtërua nga disa policë. Personat e përmendur, të gjithë të punësuar në Ministrinë për Punë të Brendshme, në njësinë speciale "Alfa" Shkup, në mbrëmje, një ditë para zgjedhjeve lokale në Ohër, e kanë ndaluar z. Milloshoskin dhe me forcë e kanë nxjerrë nga automjeti i tij. Me tri mjete motorike pasagjerësh, pa asnjë arsye dhe shpjegim, rreth dymbëdhjetë pjesëtarë të armatosur të forcave speciale, me pushkë automatike të drejtuar nga z. Milloshoski, e kanë prangosur, e kanë shtrirë në asfalt dhe kanë filluar ta shqelmojnë me shqelma, grushta dhe me armët automatike në tërë trupin. Përderisa ka zgjatur maltretimi fizik, një nga personat, me automatik i ka përzënë kalimtarët e rastit, të cilët janë habitur se për ç'arsye po e rrahnin. Kjo ngjarje dëshmohet nga dy dëshmitarë okularë të cilët ishin thjesht vëzhgues memecë të asaj që po ndodhte, sepse megjithëse janë përpjekur të ndihmonin z. Milloshoskin, kanë qenë të dëbuar me forcë nga policët e armatosur, me ç'rat edhe u shanë dhe u kërcënuan.

Pastaj, z. Milloshoskit i kanë vënë një lloj xhakete në kokë dhe me forcë e kanë futur në një automjet dhe pa kurrfarë arsye e kanë dërguar në Stacionin policor të Ohrit, ku ka vazhduar tortura fizike, pas së cilës shëndeti i tij është përkeqësuar dhe është dërguar në spitalin e Ohrit. Për shkak të lëndimeve të rënda, të jashtme dhe të brendshme, në të gjithë

trupin, urgjentisht është transferuar në spitalin e Strugës, ku iu nënshtrua një intervenimi kirurgjik - operacion, dhe pastaj u mbajt për rreth 15 ditë në mjekim intensiv në spitalin në Strugë. Pas arrestit, persona zyrtarë të Sekretariatit për punë të brendshme të Ohrit, kanë bërë një kontroll të hollësishëm të automjetit të z. Milloshoskit, por pas inspektimit u konstatua se nuk u gjetën kurrfarë gjurmësh për një vepër penale të pretenduar.

Zyrtarët e policisë e regjistruan këtë rast si „Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë”, gjë që sipas z. Milloshoskit është një gënjeshtër e kulluar, me qëllim që policët të mbrohen nga abuzimi që e kanë bërë. Në këtë drejtim, për Komitetin e Helsinkit mbetet e paqartë cili do të ishte motivi i një personi për të sulmuar një duzinë personash zyrtarë, të cilët sipas z. Milloshoskit, por edhe sipas dëshmitarëve, kanë qenë të armatosur me armë automatike.

Duke pasur parasysh të gjitha ato që u thanë më lartë, sipas Komitetit të Helsinkit, ekzistojnë indikacione të forta dhe dyshim i arsyeshëm se oficerët e policisë në fjalë, kanë kryer veprën penale Torturë, ndëshkim dhe trajtim tjetër mizor, çnjerëzor e degradues (neni 142, paragrafi 1 i Kodit Penal të RM - së). Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit i dërgoi një ankesë Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, me kërkesë që Sektori, në përputhje me kompetencat e veta ligjore, të marrë masa urgjente për të hetuar këtë rast. Pas një inspektimi të shkurtër, sipas Sektorit, nuk janë gjetur shkelje të kompetencave të policisë. Komiteti i Helsinkit monitoron gjykimin, në të cilin z. Milloshoski, në vend të personit të dëmtuar, paraqitet si i pandehur.

3. Torturë policore në Demir Hisar

Në gusht të vitit 2013, Miroslav Vasilevski, një viktimë e torturave të policisë, iu drejtua Komitetit të Helsinkit. Në qershor 2013, ai u thirr për një bisedë informative nga oficerët e policisë në stacionin policor në Demir Hisar, pa iu thënë arsyeja. Vasilevski pohon se, menjëherë pasi ka hyrë në stacion, një inspektor policie filloi t'i bërtiste dhe ta fyente, duke e akuzuar për vjedhje të baterive. Pastaj, në dhomë ka hyrë një tjetër oficer policie, i cili pa kurrfarë arsyeje, me gju e ka goditur në brinjë. Edhe pse z. Vasilevski është rrëzuar në dysheme, inspektori policor ka vazhduar ta godasë në kokë dhe ta shkelë.

Pas këtij sulmi të parë, inspektori është larguar nga dhoma, por pas një kohe të shkurtër është kthyer dhe ka vazhduar me sulmin fizik, duke i rënë Miroslavit me grushta në pjesën e pasme të kokës dhe në gju. Pas këtij sulmi, ai përsëri është rrëzuar në dysheme, pastaj inspektori i policisë e ka ngritur dhe e ka dërguar në një dhomë tjetër ku ka pasur persona të tjerë të dyshuar për vjedhje të baterive. Inspektori ka filluar t'i kërcënojë dhe t'u bëjë presion për të pranuar se edhe viktima ka qenë me ta, kur kanë vjedhur. Përkundër presionit, të dyshuarit nuk e konfirmuan këtë teori, kështu që inspektori policor ka filluar

t'i rrahë. Në prani të të dyshuarve të tjerë, inspektori fillimisht e ka shtyrë z. Vasilevskin në derë, pastaj në mur dhe më në fund edhe një herë e ka shtyrë me kokë nga tavolina.

Në fund, inspektori që kreu torturën e informoi z. Vasilevskin se kamioni i tij ishte kontrolluar dhe se në të nuk kishte asnjë bateri të vjedhur. Pas kësaj e ka liruar. Në të dalë nga stacioni i policisë, inspektori e ka kërcënuar z. Vasilevskin se nëse e denoncon rastin, nuk do ta shohë kurrë më fshatin e vet. Miroslavi, së bashku me babanë e tij, menjëherë është nisur drejt spitalit në Demir Hisar, prej ku u dërgua në departamentin kirurgjik në Entin publik shëndetësor Manastir. Për shkak të dhimbjeve dhe plagëve të rënda, ai u ndalua për dy ditë në spital.

Pas kontrollit të pretendimeve, të mbështetura me dokumentacion mjekësor (për intervenim kirurgjik dhe ekspertizë psikiatrike), Komiteti i Helsinkit filloi ndjekjen e gjykimit në vazhdim, të iniciuar nga një padi private të viktimës e cila vetë e ka ngritur procedurën, për shkak të mungesës së informacionit se vepra penale "Torturë, ndëshkim dhe trajtim tjetër mizor, çnjerëzor dhe fyes" (neni 142, paragrafi 1 i Kodit Penal) është një vepër që është dashur të ndiqet nga Prokuroria Publike, sipas detyrës zyrtare.

4. Maltretim policor në shërbimin në Shkup

Në maj të vitit 2013, në lagjen e Shkupit "Fushëtopanë", Ministria për Punë të Brendshme zhvilloi një aksion për kapjen e personit të dënuar i cili, pas shfrytëzimit të fundjavës jashtë Institucionit ndëshkimor rehabilitues Idrizovë, nuk është kthyer për të vuajtur dënimin me burg. Pasi morën informacione rreth përdorimit të tepruar të forcës nga oficerët e policisë, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit vizituan lagjen "Fushëtopanë" dhe biseduan me viktimat, të gjithë pjesëtarë të komunitetit Rom. Katër prej tyre u arrestuan dhe u sollën para gjykatësit hetues i cili ka hapur procedurë hetimore në të cilën ata u akuzuan për gjoja vepër të kryer „sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë“.

Sipas pretendimeve të një grupi të madh qytetarësh, që ishin dëshmitarë të ngjarjes, një grup i madh pjesëtarësh të forcave policore, në mesin e të cilëve ka pasur edhe anëtarë të njësive speciale të policisë, u shfaqën në Rrugën 376. Menjëherë pas arritjes, policët në mënyrë të shpejtë dhe të organizuar kanë filluar të sulmojnë qytetarët që u gjetën në rrugë. Sipas vlerësimit të bashkëbiseduesve, rreth 50 oficerë policie morën pjesë në aksion, dhe në momentin e parë u sulmua një duzinë qytetarësh. Aksioni nuk është zhvilluar vetëm përgjatë rrugës, por oficerët e policisë, pa një urdhër gjykate dhe pa ndonjë njohuri ose tregues për vepër penale të kryer, kanë hyrë në 2 shtëpi dhe 2 dyqane. Prej dyqanit të parë ka një video incizim, që tregon se si policia sulmon qytetarët e befasuar, të gjetur në dyqan. Në dyqanin e dytë u sulmuan 3 persona të tjerë. Në një nga shtëpitë, u sulmua një person i cili ishte ulur në tarracën e shtëpisë së tij dhe nuk e sfidoi policinë me asgjë.

Katër persona u transferuan në Stacionin Policor „Kisela Voda“. Aty u vendosën në 2 qeli dhe megjithëse ishin të mbyllur, atyre nuk iu hoqën pranga nga duart. Ata u lanë në pranga për 2 orë, dhe në kërkesën që t'u hiqen prangat, nga oficerët e policisë morën përgjigje se prangat nuk mund t'u hiqeshin, pasi që çelësat i kishin vetëm anëtarët e njësisë speciale „Alfa“. Njoftimi i arsyeve të arrestimit të tyre u bë pesë orë pas arrestimit. Atyre nuk iu dha udhëzimi i detyrueshëm për mundësinë e informimit të një anëtari të familjes, kurse një inspektor u ka thënë se për deklaratën e tyre, nuk do të kenë nevojë për avokat.

Pas bisedës dhe këqyrjes së vendimit për kryerjen e hetimit, Komiteti i Helsinkit ndihmoi katër personat e përmendur në përpilimin e ankesës kundër vendimit për ngritjen e hetimit. Në qershor të vitit 2013, gjyqtari hetues në këtë rast, me kërkesë të Prokurorisë Publike Shkup, ndaloi hetimin, duke konfirmuar që personat nuk janë autorë të veprës penale, siç pretendonin oficerët e policisë në akuzat penale. Me veprime të tilla, oficerët e policisë kryen veprat penale maltretim në kryerjen e detyrës (neni 143 и Kodit penal), heqje të paligjshme të lirisë (neni 140 i KP), shkelje të paprekshmërisë së shtëpisë (neni 145) dhe raportim të rrejshëm të një veprë penale (neni 366 i KP). Për më tepër, oficerët e policisë shkelën të drejtat procedurale të të arrestuarve për njohtimin e një anëtari të familjes dhe të drejtën për avokat, kurse në stacionin policor u trajtuan në mënyrë çnjerëzore dhe jo të denjë.

Për të gjitha arsyet e përmendura, Komiteti i Helsinkit paraqiti një ankesë në Sektorin për kontroll të brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe morri përgjigje se policia ka vepruar në përputhje me kompetencat e veta.

5. Torturë në Institutin për ndëshkim dhe rehabilitim Idrizovë

Komiteti i Helsinkit monitoroi dhe veproi në mënyrë aktive në rastin e torturës në Institutin për ndëshkim dhe rehabilitim Idrizovë, në të cilin personit të dënuar Zuher Ibrahimov, pas sulmit nga një anëtar i policisë së burgut, me intervenim kirurgjik ia hoqën veshkën dhe shpretkën. Incidenti ka ndodhur në Institutin për ndëshkim dhe rehabilitim Idrizovë, në mars të vitit 2013, kur z. Ibrahimov së bashku me një person tjetër të dënuar, kanë qenë duke riparuar një televizor. Kur një pjesëtar i policisë së burgut, e ka parë Zuherin, e ka pyetur se çfarë po bënte aty, dhe menjëherë pas kësaj, pa ndonjë arsye, ka filluar ta rrihte.

Pas rrahjes brutale, z. Ibrahimov e kanë mbyllur në qelinë e tij, por në mbrëmje pas përkeqësimit të shpejtë të shëndetit të tij, ai ka vënë re se kishte gjak në urinë. Ai menjëherë i ka lajmëruar të jatit dhe të nesërmen u shtrua në klinikën për urologji, jashta burgut. Duke pasur parasysh natyrën dhe seriozitetin e lëndimit, ishte i nevojshëm intervenim urgjent kirurgjik, ku ka qenë e domosdoshme heqja e veshkës së majtë dhe shpretkës.

Sipas gjetjeve mjekësore, kjo gjendje shëndetësore do të ishte kërcënuese për jetën e z. Ibrahimov, për ç'arsye drejtoresha e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve lejoi një pezullim prej 30 ditësh të dënimit me burg. Në bashkëpunim me avokatin e z. Ibrahimov, Komiteti i Helsinkit kërkoi nga drejtori i INR Idrizovë dhe nga gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve, një mungesë më të gjatë nga burgu. Në të dy rastet pati një përgjigje pozitive.

Prokuroria Themelore Publike, në vend që ta identifikojë këtë rast si një shembull klasik të torturës dhe ta ndjekë penalisht, në përputhje me nenin 142 të Kodit Penal - Torturë dhe trajtime dhe dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, ngriti një aktakuzë për vepër penale - Lëndim i rëndë trupor. Përkundër faktit se për veprën e dytë penale, kur dëmtohet një organ i rëndësishëm, parashihet dënim me burg deri në 10 vjet, Gjyqi Themelor Shkupi 1 solli një aktvendim me të cilin të pandehurin e dënoi me 6 muaj burg. Pas një apeli nga Prokuroria Themelore Publike, Gjykata e Apelit e Shkupit e rriti dënimin në 1 vit e gjysmë. Në ndërkohë, z. Ibrahimov u kthye për të vuajtur dënimin me burg në kushte jetese që paraqesin rrezik për përkeqësimin e mëtejshëm të shëndetit të tij.

Komiteti i Helsinkit përkujton se shteti ende nuk siguron mbështetje përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale për viktimat e torturës. Prandaj është i domosdoshëm zbatimi Direktivës së BE - së 2012/29 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.

6. Mbipopullim në njësitë e paraburgimit të burgjeve

Gjatë vitit 2013, në Komitetin e Helsinkit u paraqitën një duzinë ankesash dhe kërkesash për ndihmë juridike falas në lidhje me përcaktimin e masës së paraburgimit. Ankesat u referohen procedurave për përcaktimin dhe zgjatjen e masës së paraburgimit nga gjyqtarët hetues, kohëzgjatjen e masës, mospërdorimin e masave më të lehta alternative, mbipopullimin, kushtet e jetesës dhe kujdesin joadekuat shëndetësor. Komiteti iu drejtua Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe kërkoi informata mbi kapacitetin e mjediseve të paraburgimit dhe numrin e të paraburgosurve që qëndrojnë aty. Sipas Drejtorisë, situata me mbipopullimin në mjediset e paraburgimit është si më poshtë:

Reparti i paraburgimit	Kapaciteti	Gjendja në 31.10.13	Mbipopullimi
Burgu Shkup	290	378	130%
Burgu Manastir	11	30	270%
Burgu Prilep	17	29	170%
Burgu Tetovë	11	27	245%
Burgu Gjevgjeli	6	2	/
GJITHSEJ	335	466	139%

Edhe pse legjislacioni i vendit dhe standardet ndërkombëtare kërkojnë që masa e paraburgimit të përdoret si përjashtim, e jo si rregull; masa e paraburgimit nuk duhet të zgjasë shumë dhe fillimisht duhet të shqyrtohet mundësia e përdorimit të masave më të buta parandaluese, Komiteti i Helsinkit ka bindjen se paraburgimi ndonjëherë përdoret si masë ndëshkimore dhe në disa raste si metodë frikësimi. Këtë qëndrim e mbështesim në shembujt ku: paraburgimi përcaktohet edhe për vepra penale më të lehta; vendime gjyqësore ku paragjykohet faji i të pandehurit para fillimit të gjykimit; shqiptohen dënime me burg që korrespondojnë me kohën e kaluar në paraburgim; si dhe në mënyrën në të cilën forcat e policisë shoqërojnë të dyshuarit në gjykatë para kamerave televizive.

Hetimi i arsyeve për përcaktimin e masës së paraburgimit është një veprimtari e gjyqtarit hetues, detyrimi i të cilit është të argumentojë, të shpjegojë në detaje dhe të sqarojë pse e konsideron të domosdoshëm paraburgimin si dhe për ç'arsye sigurimi i të dyshuarit gjatë procesit gjyqësor nuk do të ishte i mundur me përcaktimin e një mase më të butë parandaluese. Në Maqedoni, akoma është prezente praktika e zgjidhjeve të mangëta, në të cilat mungon një analizë dhe shpjegim më specifik për secilën bazë të veçantë, për shkak të së cilës përcaktohet paraburgimi.

Vendimet për zgjatjen e paraburgimit janë zakonisht identike me njëra-tjetrën dhe bazohen në një parafrzim të thjeshtë të kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në çështjen "Syri i gjarprit", në të cilin Komiteti përfaqësonte të pandehurit para Gjykatës së Strasburgut, kjo praktikë maqedonase u karakterizua si në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

7. Precedent gjyqësor me mbikëqyrje ndërkombëtare të paraburgimit

Gjatë muajit shtator, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) paraqiti kërkesë në Gjykatën Penale në Shkup për të vizituar të paraburgosurit gjatë njëres prej seancave gjyqësore në të ashtuquajturin rast “Monstra”. Gjatë njëres prej seancave dëgjimore në këtë rast, Kryetari i Këshillit Gjyqësor informoi se kërkesa ishte refuzuar sepse KNKK nuk ishte dakord me kushtet e vendosura nga gjykata, në lidhje me mënyrën në të cilën do të realizohej vizita. Publiku i pranishëm në seancë nuk ishte informuar për detajet në lidhje me kushtet e përcaktuara.

Megjithëse refuzimi i kërkesave për të vizituar të burgosurit nga OJQ-të dhe organizatat e pavarura (përfshirë Komitetin e Helsinkit) nuk është asgjë e re, brengos fakti që kësaj rradhe është refuzuar një nga organizatat ndërkombëtare më me renome. Aktivitetet e KNKK-së janë të një natyre thjesht humanitare dhe i referohen mbrojtjes së të drejtave të burgosurve. Përmes vizitave të rregullta në institucione të mbyllura, KNKK synon të parandalohet çdo lloj i torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera johumane. Në vitin 2012, kjo organizatë ka vizituar mbi gjysmë milioni të burgosur në të gjithë botën. Në Republikën e Maqedonisë janë bërë 4 vizita në institucione të mbyllura, me ç’rast janë vizituar 16 të burgosur. KNKK vizitat i realizon sipas një metodologjie të standardizuar, sipas së cilës i janë lejuar vizitat në vitet e kaluara në Maqedoni. Andaj, mbetet e paqartë nevoja për kushtëzim të ndryshëm në këtë rast konkret, përballë rasteve të tjera.

Rëndësia e të drejtave të njeriut që KNKK ka në mbikëqyrjen e autoriteteve gjatë zbatimit të masës së paraburgimit konfirmohet edhe në nenin 211 të Ligjit për Procedurën Penale i cili përcakton se „Përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq kanë të drejtë që, pas marrjes së pëlqimit nga gjyqtari hetues, t’i vizitojnë dhe pa mbikëqyrje të bisedojnë me personat e paraburgosur”. Për më tepër, mandati ndërkombëtar i KNKK-së rrjedh edhe nga Konventat e Gjenevës të vitit 1949, nënshkruese e të cilave është edhe Republika e Maqedonisë.

Përmes refuzimit të kësaj kërkesë për të vizituar të paraburgosurit, si dhe përmes refuzimit të para pak kohësh të z. Frank La Roux - Raportues Special i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtës së Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes, për të vizituar gazetarin Tomisllav Kezharovski dhe disa refuzimeve të kërkesave të ngjashme të paraqitura nga ana e Komitetit të Helsinkit, Gjykata Penale e Shkupit vetëm forcon dyshimet se mjediset e paraburgimit në Maqedoni janë vendet ku nuk respektohen standardet ndërkombëtare dhe të vendit për trajtimin e të paraburgosurve.

DISKRIMINIMI

1. Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike

Sipas numrit të ankesave për diskriminim gjatë gjithë vitit 2013, mund të konkludojmë se më i pranishëm ishte diskriminimi i bazuar në përkatësinë politike, përkatësisht afiljacioni. Besojmë se numri i shtuar i ankesave për diskriminim politik është rezultat i zhvillimit të zgjedhjeve lokale në prill të vitit 2013 dhe ndryshimit të qeverisjes lokale në disa komuna. Numri më i madh i ankesave u dorëzua nga komuna e Gostivarit, por ka pasur ankesa edhe nga komuna e Ohrit si dhe nga Karposhi. Rasti më specifik është largimi nga puna i 8 drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Gostivarit nga ana e kryetarit të ri të komunës, pa respektuar procedurën e shkarkimit, përkatësisht vendimi për largim është dashur të merret nga këshillat shkollor në shkollat përkatëse. Drejtorët e shkarkuar paraqitën ankesa në Komitetin e Helsinkit, në bazë të të cilave iu siguria ndihmë juridike falas dhe u ngrit procedurë gjyqësore për verifikim të diskriminimit, e cila është ende në vazhdim. Gjithashtu, është ngritur procedurë gjyqësore edhe për verifikimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë politike ndaj udhëheqësve të sektorëve në Ndërmarrjen Publike Komunalec - Gostivar, të kryer nga ushtruesi i detyrës së drejtorit.

Procedura para gjykatës së shkallës së parë ka përfunduar dhe vendimi është negativ, me vërejtjen e Këshillit gjyqësor që paditësit, para se të dorëzojnë padinë, është dashur të paraqesin ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Përmes këtij shembulli, ne duam t'u tregojmë gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë se Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është një organ i pavarur që sjell mendime dhe rekomandime për ankesat e paraqitura për diskriminim të pretenduar dhe nuk ka të bëjë aspak me mbrojtjen gjyqësore nga diskriminimi. Pavarësisht nëse viktimat e diskriminimit i janë drejtuar ose jo, Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, ata mund të ngrejne procedurë gjyqësore për verifikim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Në rastet kur një procedurë është iniciuar dhe nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është dhënë mendim se në rastin konkret është bërë diskriminim, mendimi mund të përdoret si provë në procedurën gjyqësore, i cili, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk e detyron gjykatën të marrë të njëjtin vendim. Gjithashtu, në rast se një procedurë është iniciuar para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Komisioni ende nuk ka marrë vendim për ankesën e paraqitur, viktimat e diskriminimit të pretenduar mund të inicojnë procedurë gjyqësore dhe për këtë të informojë Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me çka pezullohet procedura para Komisionit.

2. Diskriminimi ndaj bashkësive etnike

2.1 Romët

Për vite me radhë, Komiteti i Helsinkit ka raportuar mbi marginalizimin, diskriminimin shoqëror dhe sistematik ndaj Romëve si bashkësi etnike. Si tema tejet të ndjeshme, do të veçonim diskriminimin ndaj Romëve në pikat kufitare, ndarjen e fëmijëve Romë në sistemin arsimor, mungesën e qasjes në mallra dhe shërbime, kufizimet në të drejtën e punësimit dhe të drejtat e marrëdhënies të punës. Do të dëshironim të veçojmë rastin e diskriminimit ndaj Romëve në pikat kufitare, i cili është një shembull i qartë se situata ka filluar të marrë një dimension edhe të diskriminimit racor, sepse ekziston diskriminim i bazuar edhe në ngjyrën e lëkurës së qytetarëve.

Ekzistencën e diskriminimit racor e dëshmon edhe ngjarja në Qendrën Tregtare Shkup City Mall, ku menaxhmenti i qendrës tregtare, përmes një e-maili dërguar kompanisë Land Service, ka kërkuar që personat, pjesëtarë të komunitetit Rom të mos angazhohen me detyra pune për të mbajtur higjienën në departamentin për ushqim. Besojmë se me këtë mënyrë të veprimit bëhet diskriminim racor dhe diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike, gjë që kufizon të drejtën për punë dhe realizimin e detyrave të punës për shkak të arsyeve të cekura dhe e njejta është e ndaluar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Kodin Penal dhe Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga diskriminimi. Për më tepër, një trajtim i tillë rrezikon drejtpërdrejt edhe integritetin moral, i cili sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë është i paprekshëm, rrezikon reputacionin dhe dinjitetin e personave romë, duke shkelur kështu të drejtat themelore të njeriut. Për këto arsye, Komiteti i Helsinkit, si anëtar i Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi, së bashku me anëtarët tjerë dënuan këtë ngjarje dhe i bënë thirrje Prokurorisë Publike dhe Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi ta hetojnë rastin dhe të inicojnë procedura për verifikimin e përgjegjësisë për trajtimin e pabarabartë ndaj personave të nacionalitetit rom, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje juridike e viktimave të diskriminimit.

Për shkak të mungesës së reagimit nga Prokuroria Publike për të filluar procedurë për hetimin e rastit dhe verifikimin e përgjegjësisë së mundshme të të pandehurve, Komiteti i Helsinkit me anëtarët tjerë të Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi ngritën kallëzim penal në Prokurorinë Publike kundër Qendrës tregtare Shkup - City mall dhe udhëheqësisë së saj. Megjithatë, edhe pas 8 muajsh nga kallëzimi penal, nuk ka asnjë përgjigje në opinion se a është duke u vepruar lidhur me këtë rast dhe a është ngritur procedurë gjyqësore.

Ky është vetëm një nga rastet e diskriminimit të përjetuar, që romët ia paraqesin Komitetit, nëpërmjet të cilit dëshmohet se në Republikën e Maqedonisë, ky komunitet është ende në margjina, i përjashtuar nga proceset shoqërore. Përjashtimi nuk është i rastësishëm, sepse Romët janë ende një nga grupet më të cënuara shoqërore që përballen me

diskriminim dhe getoizim që ndikon negativisht në proceset gjithëpërfshirëse dhe kufizon progresin dhe barazimin e tyre me grupet e tjera shoqërore.

Lidhur me diskriminimin ndaj Romëve në sistemin arsimor, pranë Komitetit arritën disa ankesa. Birhan Kasupi dhe Senat Emini, prindër të nxënësve në shkollën fillore Strasho Pinxhur, dorëzuan kërkesë për ndihmë juridike. Gjegjesisht, personi Birhan Kasumi na informoi se më 6 nëntor 2012, para fillimit të ndërrimit të dytë në shkollë, rreth orës 13:10, djali i tij dhe një fëmijë tjetër i klasës së gjashtë u shtyen në shkollë, me ç'rast një fëmijë iu drejtua me fjalët "Ti nuk je njeri, ti je jevg". Menjëherë pas kësaj, i njëjti fëmijë ka thirrur prindin e vet, i cili ka hyrë në klasë dhe ka filluar të fyejë djalin e Birhanit për shkak të kombësisë rome dhe e ka goditur me shuplaka dhe shkelma fëmijën e mitur. Prindi Kasumi na informoi se edhe oficeri i policisë që veproi në vendngjarje, gjithashtu ka treguar sjellje të papërshtatshme, joprofesionale, fyerje dhe qëndrim diskriminues ndaj tij dhe fëmijës së tij. Një rast i ngjashëm është edhe me djalin e personit Senat Emini, i cili në orën e edukatës fizike, së pari u fye nga një prind i shokut të tij të klasës për shkak të përkatësisë etnike, e pastaj ai ka filluar ta godasë në kokë dhe trup, dhe fëmija ka rënë në tokë. Në të dy rastet, policia nuk është thërritur nga autoritetet e shkollës, por nga prindërit e fëmijëve, kur kanë kuptuar për ngjarjet. Për shkak të këtyre rasteve, prindërit e fëmijëve romë paraqitën një peticion për diskriminim ndaj fëmijëve romë në këtë shkollë.

Duke vepruar në bazë të kërkesës për ndihmë juridike falas, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i dërgoi një kërkesë për njoftim drejtorit të shkollës fillore „Strasho Pinxhur“ në lidhje me veprimet e ndërmarra për ndriçimin e rasteve si dhe për veprimet e ndërmarra për promovimin dhe edukimin e nxënësve dhe prindërve të tyre për tolerancë dhe mosdiskriminim në bazë të përkatësisë kombëtare. Drejtori i shkollës na informoi se ishte mbledhur këshilli i shkollës, është biseduar me arsimtarët dhe se në shkollë vazhdimisht promovohet ndërkulturalizmi, respektimi i përkatësisë kombëtare dhe parimi i mosdiskriminimit në çfarëdo lloj baze.

Letër iu dërgua gjithashtu edhe Ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, i cili lidhur me këto raste, në media deklaroi se ai dënon dhunën ndaj fëmijëve dhe se institucionet e sistemit do të ndërmarrin masat për sanksionimin e tyre. Megjithatë, nga Ministria morrëm përgjigje se Ministria në fakt nuk është kompetente për të vepruar në këto raste, përveç në fushën e diskriminimit.

Për rastin e Birhan Kasupit u informua edhe Avokati i Popullit, kurse për diskriminimin e pretenduar të kryer në bazë të përkatësisë kombëtare nga shkolla dhe oficeri i policisë, Birhan Kasupi paraqiti një ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili nuk gjeti diskriminim në këtë rast.

Mendojmë se ky rast tregon se duhet të sigurohet edukim për prindërit dhe nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe trajnime për arsimtarët dhe profesorët mbi

parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë njerëzve, pavarësisht dallimeve të tyre, si dhe të sigurohen mjete nga komunat që do të kishin për qëllim angazhimin e personave për sigurinë e shkollave, për të parandaluar incidentet e ardhshme të dhunës ndaj fëmijëve dhe për të siguruar respektimin e të gjitha të drejtave të qytetarëve, të njohura me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, me çka do të arrihet tolerancë më e madhe për diversitetin në çdo bazë midis nxënësve, dhe kështu edhe siguri më e madhe në shkollë.

2.2 Boshnjakët

Në janar 2013, Komiteti i Helsinkit i dorëzoi ankesë Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, për diskriminim të bërë ndaj popullit Boshnjak, në bazë të përkatësisë etnike, për shkak të mospërmendjes së popullit Boshnjak si popull që jeton në Republikën e Maqedonisë, në tekstin shkollor „Njohja e mjedisit” për klasën e 3-të në arsimin fillor. Gjegjësisht, në njësinë mësimore për popujt që jetojnë në Republikën e Maqedonisë thuhet se në vendin tonë jetojnë maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vllahë dhe serbë, gjithashtu edhe përshkruhen veçoritë dhe traditat e tyre kulturore, ndërsa populli boshnjak nuk përmendet fare. Ankesa u bë kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë dhe autoreve të librit shkollor, pas një kërkesë të paraqitur paraprakisht për ndihmë juridike falas. Duke vepruar lidhur me ankesën e paraqitur, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi dha mendim se në rastin konkret është kryer diskriminim në bazë të përkatësisë etnike, sipas nenit 3 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi.

Komiteti i Helsinkit e mirëpriti mendimin, por në të njëjtën kohë kërkoi që Komisioni të plotësojë dhe të precizojë mendimin, pasi që në mendimin e dhënë nuk specifikohet se ku ka ndodhur ngjarja për të cilën është dhënë ankesa, nëse ishte çështje e diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasi që bëhet fjalë për një diskriminim të zgjatur, me që libri shkollor „Njohja e mjedisit” ku është kryer shkelja, është botuar në vitin 2011. Kjo kërkesë është dorëzuar në shtator të vitit 2013, por edhe pas 7 muajsh, nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje apo mendim të plotësuar.

3 Diskriminimi ndaj grave dhe shkeljet e të drejtave

Komiteti i Helsinkit gjatë vitit të kaluar vuri re rritje dhe aktivizim të një fushate negative ndaj statusit dhe pozitës së gruas në Republikën e Maqedonisë, si dhe diskriminimin e saj publik, diskreditim, etiketim dhe minimizim të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe shkelje të të drejtave konkrete, siç është zgjedhja e lirë, privatësia, pavarësia në

marrjen e vendimeve lidhur me trupin e saj, si dhe vartësia e saj përballë rolit të burrit. Ky diskriminim i hapur arriti kulmin me miratimin e Ligjit për Abortin, i cili kufizoi ashpër të drejtat e riprodhimit të gruas dhe lirinë e saj për të vendosur për të pasur fëmijë, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

3.1 Deklarata e Mitropolitit Petar

Komiteti i Helsinkit dënoi deklaratën e Mitropolitit Petar, përmes së cilës ai përsëriti pretendimet se gratë janë arsyeja për rritjen e numrit të divorceve në Republikën e Maqedonisë, pasi që ato nuk dëshirojnë të pranojnë se koka e shtëpisë është është burri dhe se gratë duhet t'i nënshtrohen burrit. Sipas Mitropolitit Petar, gratë ose do të shpëtojnë ose do të shkatërrojnë kombin maqedonas dhe kishën, sepse ajo që do të ngjizet në barkun e nënave duhet të lindë nëse duam të mbijetojmë si një komb, popull, shtet dhe si kishë.

Përmes pikëpamjeve të tilla të shprehura publikisht, Mitropoliti Petar bëri një shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 9 të Kushtetutës së RM - së, i cili përcakton se të gjithë qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pa marrë parasysh gjininë, nenit 25 i cili garanton respektimin dhe mbrojtjen e privatësisë dhe jetës personale dhe familjare të çdo qytetari, të dinjitetit dhe reputacionit të tij dhe nenit 41 i cili përcakton të drejtën e njeriut për të vendosur lirisht për lindjen e fëmijëve, si dhe shkelje të dispozitave të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligjit për mundësitë e barabarta për burrat dhe gratë. Për më tepër, me deklaratatë të tilla çënohet edhe karakteri sekular i shtetit nga kisha, që është kategori kushtetuese dhe sipas së cilës kisha, bashkësitë fetare dhe grupe të tjera fetare janë të ndara nga shteti.

Deklarata të tilla misogyniste janë në kundërshtim me të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë që garantojnë barazinë e grave, të drejtën e saj për të zgjedhur dhe të drejtën e riprodhimit, veçanërisht me dispozitat e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, nënshkruese e së cilës është edhe Republika e Maqedonisë.

Gjegjësisht, neni 5 i Konventës përcakton që shtetet i marrin të gjitha masat e duhura për të ndryshuar zakonet shoqërore dhe kulturore në lidhje me sjelljen e burrave dhe grave, në mënyrë që të hiqen paragjykimet, si dhe praktikat e zakonshme dhe çdo praktikë tjetër, e bazuar në kuptimin e inferioriteti ose epërsisë së njëres apo tjetres gjini, ose rolit tradicional të burrave, gjegjësisht grave.

Komiteti i Helsinkit u bëri thirrje Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi dhe përfaqësuesit juridik që në rast të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave, si pjesë e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, të inicojnë procedurë për vërtetimin e diskriminimit në

bazë të seksit dhe gjinisë, të kryer nga Mitropoliti Petar, por nuk pati asnjë reagim nga përfaqësuesit e këtyre organeve për barazi.

3.2 Leje prindërore e papaguar që vlen vetëm për gruan - nënën

Rrjeti për mbrojtjen nga diskriminimi, i koordinuar nga Komiteti i Helsinkit, vërtetoi se inkorporimi i të drejtës së re të punës për leje prindërore pa pagesë në Ligjin e Punës që i referohet gruas - nënës, paraqet një pozitë jo të barabartë të gruas - nënë në raport me burrin - baba dhe thekson dhe inkurajon rolin tradicional të gruas si nënë dhe person që përkujdeset.

Në Republikën e Maqedonisë, gratë punëtore përballen me shkelje të të drejtave të tyre si gjatë punësimit, ashtu edhe në vendin e punës, ndërsa puna e grave është e pambrojtur dhe më pak e paguar. Gratë punëtore nuk kanë në dispozicion mekanizma efikasë dhe efektive juridikë dhe institucionale dhe trupa që mund t'i shfrytëzojnë për të mbrojtur të drejtat e tyre, kështu që shpesh ndodh që të marrin një vendim pushim nga puna, motivi i të cilit është shtatzania ose të përballen me viktimizimin, kur raportojnë shkeljen e dispozitave të Ligjit për marrëdhënie pune.

Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, i cili monitoron situatën në lidhje me të gjitha format e diskriminimit, beson se në mungesë të mekanizmave efektive të mbrojtjes, e drejta për leje prindërore pa pagesë do të rrisë edhe më shumë mundësitë për abuzim dhe shkelje të të drejtave të punëtoreve nga ana e punëdhënësve.

Andaj, ne besojmë se Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale duhet të gjejnë zgjidhje të përshtatshme ligjore që do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të tilla dhe duhet të tregojnë vullnet të fortë politik për të zbatuar legjislacionin ekzistues që mbron gratë nga diskriminimi në bazë të gjinisë në marrëdhëniet e punës.

Rrjeti për mbrojtjen nga diskriminimi mbështet idenë e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës në drejtim të kuptimit të nevojës se prindët duhet të kalojnë më shumë kohë me fëmijët e tyre dhe të kujdesen për rritjen dhe zhvillimin e tyre të duhur. Por, roli në rritjen dhe zhvillimin e drejtë të fëmijës nuk i përket vetëm nënës, por edhe babait. Zgjidhja ligjore e propozuar i diskriminon burrat, duke u mohuar atyre të drejtën për leje prindërore pa pagesë, e nga ana tjetër, vetëm që thekson rolin e gruas në shtëpi rreth rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve.

Barazia gjinore dhe ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë është pjesë e dispozitave pozitive të Republikës së Maqedonisë dhe është parimi themelor i konventave të shumta ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është Republika e Maqedonisë.

4. Diskriminimi ndaj grupeve të marginalizuara - personave LGBTI

Gjatë gjithë vitit 2013, komuniteti LGBTI ishte nën sulme të vazhdueshme në opinion, shënjestër e gjuhës së urrejtjes, gjë që kulmoi me vepra urrejtjeje ndaj aktivistëve konkretë, por edhe kundër Qendrës për Mbështetje LGBTI. Gjegjesisht, sulmet e shumta ndaj Qendrës së Mbështetjes, sulmi ndaj të pranishmëve në Qendrën LGBTI gjatë „Javës së Krenarisë”, sulmet në Manastir ndaj aktivistëve që luftojnë për të drejtat e personave LGBTI, kërcënimet homofobike në rrjetet sociale, rrahja e dy djemve në qendër në Shkup, përfshirë sulmin ndaj shtëpisë së aktorit i cili foli publikisht për orientimin e tij seksual, flasin për diskriminim shoqëror ndaj këtij komuniteti.

Heshtja e institucioneve për rastet e përmendura dëshmoi diskriminimin e hapur ndaj komunitetit LGBTI dhe selektivitetin në veprime nga ana e institucioneve. Për shkak të kësaj, Komiteti i Helsinkit dhe anëtarët e tjerë të Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi më 08.10.2013 ngritën kallëzime penale në Prokurorinë Themelore Publike - Shkup. Kallëzimet penale u ngritën kundër personave të panjohur për shkak të ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm se, ndër të tjera, ata kryen edhe veprat penale „Dhunë”, „Diskriminim racor dhe tjetër”, „Shkelje të barazisë së qytetarëve” dhe „Nxitje të rrezikut të përgjithshëm”. Megjithëse kanë kaluar 6 muaj nga ngritja e kallëzimeve penale, deri më sot ende nuk ka asnjë përgjigje nga Prokuroria Publike.

Gjithashtu do të dëshironim të theksonim se ka kaluar një vit e gjysmë nga sulmi i parë ndaj Qendrës për mbështetje LGBTI dhe Komiteti i Helsinkit e as opinionin nuk morrën asnjë përgjigje nëse institucionet kompetente kanë marrë masa për të identifikuar autorët dhe nëse është ngritur procedurë me të cilën do të kërkohej përgjegjësi nga autorët.

Rasti i vetëm ku Qendra e Mbështetjes LGBTI u sulmua dhe për të cilën institucionet reagueshan shpejt, ishte sulmi i 2 marsit. Në e mirëpresim verdiktin e Gjykatës Themelore Shkupi 1 me të cilin sulmuesit e Qendrës u shpallën fajtorë për krimin „Pjesëmarrje në turmë që do të kryejë një vepër penale”. Gjatë marrjes së vendimit për masën dhe kohëzgjatjen e dënimit për autorët e veprës, gjykata mori parasysh rrethanat rënduese për vepra penale të urrejtjes në bazë të origjinës kombëtare dhe shoqërore, bindjes politike dhe fetare, gjinisë, racës ose ngjyrës së lëkurës, duke shmangur të përfshijë ose të njohë bazat e orientimit seksual dhe identitetin gjinor si motiv për veprën e kryer.

Sulmet e autorëve të krimit shkaktuan rrezik të konsiderueshëm për jetën dhe trupin e të pranishmëve në Qendër, shkelje të barazisë së qytetarëve dhe diskriminim (bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor). Si rezultat i kësaj, u shkelën integriteti personal dhe moral, dinjiteti dhe reputacioni i personave LGBTI.

Ne besojmë se institucionet duhet të njohin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për dhunë dhe diskriminim, në mënyrë që më në fund komuniteti LGBTI të marrë mbrojtje dhe mbështetje nga institucionet, të cilat duhet të mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe të parandalojnë përsëritjen e një dhunë e tillë.

5. Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar fizike - persona të verbër

Komiteti i Helsinkit vërtetoi trajtimin e pabarabartë të personave të verbër nga bankat në Republikën e Maqedonisë, kur përdorin shërbime bankare dhe produkte për të cilat është i domosdoshëm nënshkrimi i përdoruesit, me ç'rast bankat nuk e pranojnë nënshkrimin e personave të verbër, nuk lejojnë përdorimin e faksimilit dhe i detyrojnë të autorizojnë një palë të tretë për të nënshkruar në emër të tyre dhe për llogarinë e tyre. Personat e verbër gjithashtu përballen me probleme edhe gjatë përdorimit të online banking, për shkak të dispozitave të brendshme të bankave (përdorimi i tokenave, kodeve dhe mjeteve të ngjashme të sigurisë, të cilat personat e verbër nuk janë në gjendje t'i përdorin).

Bankat nuk ofrojnë përdorimin e teknologjisë ndihmëse, siç janë për shembull bankomat zëri, alfabeti Braj, zgjidhje softuerësh për qasje në shërbimet elektronike, etj. Bazuar në këtë, Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi iu dorëzua një ankesë, e cila u mbështet nga të gjithë anëtarët e Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi, Unioni kombëtar i të verbërve të Republikës së Maqedonisë dhe nga Unioni kombëtar i invalidëve civilë të luftës në Maqedoni. Për më tepër, u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi midis Komitetit të Helsinkit të Maqedonisë, Unionit kombëtar të të verbërve të Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Komerciale SHA Shkup, i cili parashikon bashkëpunim të ngushtë midis dy shoqatave të qytetarëve dhe bankës në fjalë, në mënyrë që të tejkalohen problemet me të cilat përballen të verbrit dhe personat me shikim të dëmtuar. Për këtë qëllim, Banka Komerciale trajnoi 6 punonjës, të cilët tashmë punojnë në fushën e punës elektronike bankare, hapjen e llogarive rrjedhëse dhe hapjen e kasafortave.

Gjithashtu, deri më tani, banka ka trajnuar 22 persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar për të përdorur shërbimet dhe produktet e punës bankare elektronike (internet, e - aplikime, etj.). Banka gjithashtu ka përshtatur edhe procedurën për marrjen me qira të një kasafortë nga personat e verbër dhe me shikim të dobësuar, kështu që ata tani mund të hapin një kasafortë në prani të dy nëpunësve të bankës.

Mendojmë se kjo praktikë e Bankës Komerciale duhet të jetë një shembull pozitiv për bankat e tjera, që edhe ato t'i përshtasin shërbimet e tyre me nevojat e këtij grupi njerëzish. Njëherit, duam të theksojmë se Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, edhe në këtë rast nuk morri vendim brenda afatit të paraparë ligjërisht prej 90 ditësh.

6. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi

Mosefikasiteti në mbrojtjen nga diskriminimi dhe mosrespektimi i afatit 90-ditor për vendimmarrje nga Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi vazhdoi edhe në vitin 2013, ashtu si edhe në 2 vitet e mëparshme. Fakti që Komisioni nuk ka dorëzuar ende përgjigje për ankesën e paraqitur nga Komiteti i Helsinkit në prill të vitit 2011 për vërtetim të diskriminimit, përkatësisht ndarjes së fëmijëve romë në shkolla të caktuara fillore në Manastir, dëshmon aftësinë e Komisionit për të luftuar format më të rënda të diskriminimit dhe për t'i mbrojtur fëmijët dhe qytetarët e rritur nga çdo formë e diskriminimit.

Gjithashtu, në rastin e diskriminimit ndaj boshnjakëve, Komisioni ka treguar një qëndrim paushall në sjelljen e mendimeve, madje edhe në ato raste kur konstaton diskriminim. Mendojmë që mospecifikimi i formës së diskriminimit mund të ndikojë negativisht në praktikën që Komisioni do ta krijojë në periudhën e ardhshme të punës së vet.

Të gjitha vërejtjet e Komitetit të Helsinkit për Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht ato që lidhen me dispozitat që lejojnë që punonjësit në administratën shtetërore të jenë anëtarë të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, mospërfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për mbrojtje nga diskriminimi, mungesa e një mekanizmi që do të sigurojë respektimin e afatit prej 90 ditësh për marrjen e mendimeve nga ana e Komisionit, mbetën edhe në vitin 2013, sepse nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nuk pati asnjë nismë për të ndryshuar dispozitat e këtij Ligji.

VEPRA PENALE NË BAZË TË URREJTJES

Gjatë vitit 2013, në periudhën prej 28 shkurtit deri më 31 dhjetor, Komiteti i Helsinkit në kuadër të projektit “Monitorimi dhe raportimi mbi krimet e urrejtjes”, i financuar nga Misioni i OSBE-së në vend, regjistroi 116 krime / incidente nga urrejta.

Në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u raportuan 3 nga këto incidente, ndërsa të gjitha incidentet e tjera u raportuan nga mediat. Gjithashtu, 60 incidente u konfirmuan përmes kontaktit me policinë, përmes buletinëve të policisë, raportimit mediatik, takimeve me viktimat, si dhe nga dëshmitarët e incidentit. Nga incidentet e regjistruara, 56 nuk u verifikuan, por përsëri u përfshinë në raport për shkak të informatave të marra në lidhje me vendin e incidentit (për shembull, lagje dhe shkolla etnikisht të përziera, linja autobusi që shfrytëzohen nga pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, vende ku edhe më parë është kryer krimi i urrejtjes, etj.), lloji i incidentit (për shembull, një grup i madh i të miturve sulmon një ose më shumë viktime pa provokime, përleshje në grupe, sulm në autobus, në stacion autobusi, etj.), koha e incidentit (pas një rrahjeje, si formë e hakmarrjes, pas orëve mësimore, gjatë ose pas një ngjarjeje sportive, etj.) dhe pronës së dëmtuar gjatë incidentit (për shembull, kisha, xhami, ndërtesa multikulturore, etj.). Denoncimet e verifikuara dhe të paverifikuara për incidentet, mund të shihen ndaras në web portalin për denoncimin e krimeve të urrejtjes: www.zlostorstvaodomraza.com.

Shumica e incidenteve të regjistruara (103) klasifikohen si krime të urrejtjes për shkak të statusit të tyre si vepra penale sipas të drejtës kombëtare dhe faktit që ato janë kryer për shkak të një anshmërie të caktuar. Shumica e këtyre veprave penale janë kryer nga të mitur. Viktimat dhe autorët e krimit janë zakonisht pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike (maqedonase dhe shqiptare). Krimet e kryera përfshijnë: sulm, posedim dhe përdorim të armëve të paligjshme, dëmtim të pronës, vandalizëm, kërcënim, dhunë, djegie flamujsh, zjarrvënie, etj. Incidentet që nuk kualifikohen si krime të urrejtjes zakonisht trajtohen si kundravajtje (13) dhe në atë rast zakonisht bëhet fjalë për mbishkrime fyese, brohoritje të papërshtatshme dhe nacionaliste gjatë ngjarjeve sportive dhe të tjera.

Rreth 72 përqind e numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara, janë shënuar në Shkup dhe komunat përreth tij. Nga 7 incidente janë regjistruar në qytetet Kumanovë dhe Tetovë, 5 në Gostivar dhe 4 në Strugë. Të gjitha këto qytete janë në rajone ku ka pakicë të konsiderueshme të maqedonasve etnikë (Tetovë dhe Gostivar) ose shqiptarë etnikë (Shkup, Kumanovë dhe Strugë). Dibra është i vetmi qytet ku shqiptarët dhe maqedonasit jetojnë së bashku, por gjatë periudhës së projektit, nuk ka ndodhur asnjë incident. Përveç në Shuto Orizarë, një komunë e populluar kryesisht nga pjesëtarë të bashkësisë etnike

rome, krimet e urrejtjes u regjistruan në të gjitha 9 komunat e tjera në Shkup. Fakti që nuk janë regjistruar incidente që përfshijnë pjesëtarë të bashkësisë etnike rome, nuk duhet të na çojë në përfundimin se nuk ndodhin incidente të tilla, por mund të mos jenë raportuar.

Shumica e incidenteve të regjistruara në Shkup, kanë ndodhur në Çair (një komunë e banuar kryesisht me shqiptarë), Qendër dhe Aerodrom (komuna kryesisht të banuara me maqedonas). Përqindja e incidenteve të regjistruara për këto tri komuna është 72 përqind e numrit të përgjithshëm të incidenteve që kanë ndodhur në zonën e qytetit të Shkupit. Të paktën 21 incident në Shkup ka ndodhur në autobusë (mediat nganjëherë raportonin për vendndodhjen e autobusit që u sulmua, por jo edhe për numrin e autobusit). Shumica e autobusëve qarkullojnë midis vendbanimeve të banuara me maqedonas dhe shqiptarë, dhe nga të gjitha sulmet në autobusë, 66 përqind ndodhën në autobusët numër 9 dhe 65. Shumë prej sulmeve fizike ndodhën ose afër stacioneve të autobusëve ose autobusi ishte në shënjestër të sulmit. Përveç sulmeve në dhe ndaj autobusëve, u raportuan gjashtë sulme ndaj trenave. Afër stacionit hekurudhor në Shkup-Veri ndodhën 4 sulme, kurse trenat e sulmuar po qarkullonin në relacionin Shkup - Kërçovë dhe Shkup - Prishtinë.

Ndërkaq, 14 incidente që përfshinin sulm të një grupi nxënësish kundër një nxënësi, ose përleshje midis dy grupeve të kundërta, ndodhën brenda ose afër gjashtë shkollave të mesme në Shkup. Tri prej këtyre shkollave janë të vendosura në të njëjtin bulevard në Komunën e Aerodromit. Në të gjitha shkollat ku janë regjistruar incidente, mësojnë nxënës maqedonas dhe shqiptarë. Për më tepër, në nivelin kombëtar, u regjistruan incidente në të cilat u sulmuan tri kisha, një xhami, një qendër multikulturore dhe një muze (i alfabetit shqip), i cili u sulmua dy herë.

Pothuajse gjysma e incidenteve të regjistruara ndodhën në mars, shtator dhe tetor. Shumica e incidenteve në mars ndodhën për shkak të protestave dhe kundërprotestave lidhur me emërimin e Talat Xhaferit (ishkomandant i UÇK-së) si Ministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Në shtator dhe tetor, mesatarisht, një incident ndodhte çdo të dytën ditë, për faktin se kjo periudhë shënon fillimin e vitit shkollor dhe nxënësit kthehen në shkollë, kështu që në shumicën e incidenteve ishin të përfshirë nxënës të shkollave të mesme, ndërsa koha kur rëndomë ndodhin incidentet, është pas orëve mësimore. Gjatë zgjedhjeve lokale në vend, që u mbajtën në vitin 2013, është interesante të theksohet se midis dy raundeve zgjedhorë, ku raundi i parë i votimit u zhvillua në 24 mars, ndërsa i dyti në 7 prill, nuk u regjistrua asnjë incident. Gjatë muajit qershor, muaj në të cilin mbaron viti shkollor, ndodhën vetëm 7 incidente.

Rreth 84 përqind e krimeve të urrejtjes janë kryer për shkak të përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës. Pothuajse në të gjitha këto incidente, janë të përfshirë maqedonasit dhe shqiptarët. Orientimi seksual, së bashku me identitetin gjinor, ishte shkak i 9 përqind të incidenteve, ndërsa incidentet për shkak të përkatësisë fetare përbëjnë 7 përqind.

Gjatë periudhës së projektit, u regjistruan më së paku 130 viktima dhe 490 autorë të krimeve të urrejtjes. Për nevojat e këtij raporti, gjithmonë kur mediat raportojnë numër të papërcaktuar të autorëve të krimeve (për shembull midis 10 dhe 15), është marrë parasysh numri më i vogël i autorëve të krimeve. Kur raportohet se një “grup” autorësh kishin kryer një krim urrejtjeje, numri i përdorur në këtë raport është 3 persona. Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se një pjesë e madhe e viktimave janë të mitur, ku viktima më e re është 10 vjeç, kurse në mesin e viktimave janë edhe 5 vajza nën moshën 18 vjeç.

Lidhur me reagimin e institucioneve si përgjigje për këtë fenomen negativ, duhet përmendur që policia arriti të gjejë autorë të dyshuar në lidhje me të paktën 27 nga 116 incidente. Duke qenë se aktualisht nuk ka një bazë të dhënash për krimet e urrejtjes, Komiteti i Helsinkit regjistroi rastet e zgjidhura duke marrë informacion nga policia, duke ndjekur mediat dhe duke u informuar drejtpërdrejt nga viktimat. Në polici janë denoncuar 56 incidente të tjera dhe po bëhen hetime. Në lidhje me 33 incidentet e tjera, Komiteti nuk ka informacion mbi statusin e tyre. Deri më tani, vetëm një incident mori epilog gjyqësor, incident në të cilin Komiteti i Helsinkit mori pjesë si palë e dëmtuar dhe i referohet rastit në lidhje me një nga sulmet e shumta ndaj qendrës së mbështetjes LGBTI.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Komiteti dëshiron të theksojë se shteti nuk mbledh të dhëna për krimet e urrejtjes dhe duke qenë se ky problem nuk është shfaqur në diskursin publik, është e pasigurtë nëse në të ardhmen e afërt do të kemi në dispozicion të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për krimet e kryera nga urrejtja. Shumë pak përpjekje janë bërë edhe sa i përket marrjes së masave parandaluese, përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes së opinionit.

Për më tepër, krimet e urrejtjes nuk raportohen ose nuk hetohen siç duhet nga autoritetet, të cilët duhet të kenë kaluar trajnim për identifikimin dhe përgjigjen ndaj krimeve të urrejtjes. Duke qenë se krimet e urrejtjes nuk trajtohen si çështje e veçantë, shteti nuk ofron mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për viktimat. Pjesëtarët më të prekur të shoqërisë janë të rinjtë, por gjithashtu edhe pjesëtarët e komunitetit LGBTI, për faktin se orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk njihen si baza mbi të cilat mund të kryhen krime të urrejtjes. Krimet e urrejtjes zakonisht ndodhin në vend publik dhe siç u përmend, një numër i madh incidentesh kanë ndodhur në autobusë, pranë stacioneve të autobusëve, në oborret e shkollave dhe afër shkollave, kurse ka pasur raste kur janë sulmuar edhe trenat. Shumë krime të urrejtjes janë kryer për hakmarrje ose si pasojë e një incidenti të mëparshëm midis të rinjve maqedonas dhe shqiptarë. Gjithashtu, një numër i madh incidentesh ndodhën pas orëve të mësimi.

Nga numri i përgjithshëm i incidenteve të regjistruara, vetëm 2 incidente janë regjistruar në Maqedoninë Lindore. Numri i vogël i incidenteve në këtë pjesë të vendit mund të jetë

për shkak të faktit se kjo pjesë e vendit është e populluar kryesisht nga popullatë etnike maqedonase, por edhe për shkak të numrit më të ulët të denoncimit të incidenteve të tilla si dhe nivelit të ulët të vetëdijes në publik, në lidhje me krimet e urrejtjes dhe paragjykimet që shfaqen si motive të këtyre krimeve.

TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

Nga aspekti i të drejtave sociale dhe ekonomike të qytetarëve, vitin e kaluar Komiteti i Helsinkit pranoi një numër të madh të ankesave nga qytetarët të cilëve u cenohet e drejta për mbrojtje sociale, e drejta për punësim dhe e drejta për mbrojtje shëndetësore.

Në përgjithësi, Qendrat për Punë Sociale si një shërbim publik për të gjithë qytetarët, duke theksuar rolin e këtyre institucioneve në lehtësimin e qasjes në realizimin e të drejtave të qytetarëve në rrezik shoqëror, dështojnë në punën e tyre. Gjithashtu dështuan edhe në pjesën me informimin e nevojshëm të qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre në fushën sociale. Përfituesit e të drejtave të mbrojtjes sociale shpesh janë përballur me vendime që i privojnë nga disa të drejta, pikërisht për shkak të mungesës së përgjithshme të informacionit në lidhje me njohtimin për ndryshimet financiare të llogarive të transaksioneve, dhe si pasojë, për shkak të shërbimeve profesionale jofunksionale në Qendrat për Punë Sociale. Kështu, shumë shpesh ndodhte që e drejta për ndihmë financiare shoqërore të ndërpritej, pavarësisht nga shumica e parëndësishme e padeklaruar në lidhje me mirëqenien e qytetarëve. Përkundër procedurave të iniciuara të apelimit, por edhe procedurave para Gjykatës Administrative të RM - së në fushën e mbrojtjes sociale, për shkak të procedurave të gjata dhe punës joefikase, qytetarët edhe më tutje nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale.

Mosfunksionimi institucional vërehet gjithashtu edhe në rastin e një grupi të madh të njerëzve të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar, që nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre në komunikim, për shkak se nuk sigurohen interpretues që përdorin gjuhën e shenjave, pavarësisht detyrimit në bazë të Ligjit për Përdorimin e Gjuhës së shenjave. Komiteti i Helsinkit shpreh shqetësim për qasjen në të drejtat dhe drejtësinë për këtë kategori të prekshme të qytetarëve, veçanërisht për shkak të faktit që Republika e Maqedonisë me ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka detyrimin të sigurojë kushte për qasje të plotë dhe realizimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Andaj, Komiteti për këtë çështje reagoi në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave me disa shkresa, si vazhdimësi e protestave të kësaj kategorie të qytetarëve, që rezultoi me fillimin e trajnimit për interpretues të rinj, si dhe trajnim të punonjësve në disa farmaci për përdorimin e gjuhës së shenjave në punën e tyre.

Si kategori e prekshme e qytetarëve konsiderohen edhe personat e zhvendosur brenda vendit, për shkak të statusit të pazgjidhur, edhe pse nga konflikti i vitit 2001 kanë kaluar

12 vjet. Disa nga këta persona iu drejtuan Komitetit të Helsinkit dhe deklaruan se ata janë fshirë nga evidenca dhe me këtë është bërë ndryshim i statusit të tyre, gjë që rezulton me faktin që një pjesë e personave të zhvendosur brenda vendit u gjetën në një vakuum sistemor, i cili i përjashton ata nga jeta shoqërore dhe pamundëson shfrytëzimin e benefiteve për këta persona. Megjithëse disa prej tyre kanë çështje gjyqësore në të cilat është vendosur që t'u jepet kompensim, pagesa në bazë të kompensimit të dëmit nuk i plotëson standardet për krijimin e kushteve themelore të jetesës. Duke pasur parasysh faktin se statusi i personave të zhvendosur brenda vendit, të akomoduar në katër qendrat e tjera të pritjes është i panjohur, Komiteti i Helsinkit kërkoi informacion nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për situatën e këtyre personave dhe beson se Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të marrë edhe veprime të tjera për të zgjidhur statusin përfundimtar të të zhvendosurve brenda vendit. Është i pakontestueshëm fakti që fshirja nga evidenca dhe përfundimi i statusit „të zhvendosur brenda vendit“, nuk është një zgjidhje efektive dhe afatgjate për këtë kategori të qytetarëve.

Në sferën e të drejtës për punësim, interesim të jashtzakonshëm në opinion zgjoi rasti i shpalljes publike për punësim në Ndërmarrjen Publike „Pyjet e Maqedonisë“, me ç'rast nga qytetarët arritën më shumë ankesa për jotransparencë, padrejtësi dhe selektivitet në përzgjedhje. Kështu, pas shpalljes së parë, disa qytetarë iu drejtuan Komitetit të Helsinkit, të cilët, edhe pasi janë përzgjedhur nga kompania, ende nuk janë informuar për statusin e tyre të punës në këtë ndërmarrje, e as nuk janë informuar për shpërndarjen e vendeve të punës, dhe të njejtit ende paraqiten në Agjencinë e Punësimit. Kritika për mënyrën e zgjedhjes pati edhe në reagimet e qytetarëve që aplikuan në shpalljen e dytë publike për punësim për personat me aftësi të kufizuara.

1. Përkeqësimi i statusit të personave të zhvendosur brenda vendit

Duke vepruar pas një kërkesë për ndihmë juridike, Komiteti i Helsinkit gjatë muajve korrik dhe gusht monitoroi në mënyrë aktive situatën e dy familjeve të mbetura në qendrën e pritjes (konvikti i nxënësve) „Profesor Mijalkoviq“ - Kumanovë, të cilat vazhdojnë të llogariten si persona të zhvendosur brenda vendit që nga konflikti i vitit 2001.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përmes drejtorit të konviktit të nxënësve i ka informuar familjet që, përfundimisht me datë 31.07.2013 duhet ta lëshojnë qendrën e pritjes, për shkak të pagesës së plotë të borxhit nga shteti në lidhje me kontestet gjyqësore për kompensim të dëmit. Familjet morën rreth tre mijë euro dëmshpërblim nga Republika e Maqedonisë, në emër të dëmit material të shkaktuar nga akte dhune dhe terrori, për një shtëpi pjesërisht të dëmtuar gjatë konfliktit të vitit 2001, kështu që në bazë të pagesës së bërë, u është ndërprerë statusi i tyre si persona të zhvendosur brenda vendit.

Për këto arsye, një familje pesëanëtarëshe, me tre fëmijë të mitur, që nga gushti i këtij viti tashmë është zhvendosur në shtëpinë e tyre në fshatin Debarshanë - Kumanovë, e cila është ndërtuar me fondet e paguara nga shteti si dëmshpërblim. Me shumën e paguar, familja nuk ka mundur të sigurojë as kushtet minimale të jetesës dhe lidhur me këtë, Komiteti i Helsinkit informoi Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Kjo familje jeton pa energji elektrike, pa ujë dhe pa gjërat elementare shtëpiake.

2. Personat me dëgjim të dëmtuar

Duke monitoruar protestën e personave me dëgjim të dëmtuar (të shurdhër dhe dëgjim të dobët) të mbajtur më 25.09.2013, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë vuri në dukje kërkesat dhe problemet me të cilat përballet çdo ditë kjo kategori e prekshme e qytetarëve. Protesta kaloi qetë, pa ndonjë incident, dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme vepruan në përputhje me kompetencën e tyre ligjore.

Revolta e shprehur është për shkak të punës jotransparente të Unionit kombëtar të personave të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar, të udhëheqësve të tij dhe mënyrës se si Unioni e mundëson qasjen e anëtarëve në të drejtat e tyre, megjithëse sipas statutit dhe aktiviteteve parashihet mundësim i ndihmës juridike dhe këshillim për këta persona. Për këto arsye, u kërkua dorëheqja e kryetarit të Unionit kombëtar të të shurdhërve dhe me vështirësi në dëgjim, si dhe një rishikim i punës së kësaj organizate nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe institucioneve të tjera përkatëse. Problemi kryesor i theksuar nga personat me dëmtime të dëgjimit, është pamundësia për të ushtruar të drejtën e garantuar ligjërisht për përkthyes në gjuhën e shenjave. Është tejet e vështirë të sigurohet qasje në përkthyes në gjuhën e shenjave, gjë që është edhe e kuptueshme, kur merret parasysh fakti se në një grup prej 6000 personash, në regjistrin e mbajtur nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, janë të evidentuar vetëm 12 përkthyes që kanë certifikatë.

Puna e Unionit kombëtar të shurdhërve dhe me vështirësi në dëgjim të Maqedonisë, është e rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhës së shenjave, ku është përcaktuar edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, veçanërisht në pjesën e trajnimit të përkthyesve dhe marrjen e certifikatave të punës. Duke marrë parasysh që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në përputhje me nenin 22 është e detyruar të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji, ajo është e detyruar të monitorojë edhe punën e Unionit në zbatimin e aktiviteteve në pjesën e sigurimit të çfarëdo ndihme të mundshme për personat me dëmtime të të dëgjuarit, përfshirë edhe procedurën për marrjen e certifikatës së përkthyesit.

Komiteti i Helsinkit mirëpret rishikimin e Strategjisë kombëtare për barazimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara 2010-2018 dhe njëkohësisht përkujton në zbatimin e saj sistematik në praktikë, në mënyrë që të mos lejohet kjo kategori e qytetarëve të mbetet e padukshme, e mbyllur në shtëpitë e tyre dhe pa mundësi socializimi dhe bashkëveprimi në jetën shoqërore. Komiteti tashmë ofron këshilla juridike falas për një pjesë të kësaj kategorie qytetarësh dhe i informon për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe për mënyrën e vendosjes së komunikimit me institucionet shtetërore në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Punësimi jotransparent i kategorive të cënueshme të qytetarëve

Pas reagimeve të para për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në Ndërmarrjen Publike “Pyjet e Maqedonisë”, Komitetit të Helsinkit iu drejtuan disa qytetarë që aplikuan për shpalljen publike dhe të cilët u informuan se nuk ishin zgjedhur për vendin e punës për të cilin kishin aplikuar.

Nga pretendimet dhe deklaratat e palëve, konstatojmë se procedura e përzgjedhjes publike elektronike e kandidatëve është e paqartë për qytetarët e prekur, veçanërisht për shkak të faktit se gjatë përzgjedhjes dhe vendimmarrjes nuk janë marrë parasysh kriteret për pikëzim, të publikuara në shpalljen publike. Si rezultat i kësaj, qytetarët e vendbanimeve më të vogla në Republikën e Maqedonisë, ku shpejt u përhapën informatat se cilët nga kandidatët „kishin fatin” të përzgjidhen për punësim, reagojnë se midis të zgjedhurve ka më shumë anëtarë të të njejtës familje, si dhe persona që janë në gjendje shumë më të mirë sociale e ekonomike, se sa personat që nuk janë zgjedhur.

Duke u nisur nga reagimet e forta dhe pakënaqësia e qytetarëve, konkludojmë se zgjedhja elektronike e paraparë si një mekanizëm publik dhe objektiv për përzgjedhjen e kandidatëve, nëpërmjet të cilit do të mënjanoheshin dyshimet për subjektivitet, favorizim dhe padrejtësi në procedurë - u shndërrua pikërisht në të kundërtën. Është e pasigurtë nëse aplikacionet kanë kaluar përmes filtrit të parë për përzgjedhje, në përputhje me kriteret e publikuara të aplikimit, gjë që le mundësinë e konkurrencës së padrejtë gjatë përzgjedhjes.

Konfuzion shtesë krijohet edhe nga njoftimet e NP „Pyjet e Maqedonisë”, sipas të cilave refuzohen kandidatët që kanë aplikuar jashtë afatit të paraparë me ligj prej 5 ditësh, e në të cilat arsyetimi i vetëm i qëndrueshëm është se i udhëzojnë në web faqen e internetit, ku mund të shohin të dhënat për aplikimet. Me këtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë është bërë shkelje e nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune, i cili, ndër të tjera, detyron punëdhënësin që në njoftim të tregojë emrin e kandidatit që është zgjedhur për vendin e shpallur të punës.

Disa nga qytetarët reagojnë edhe ndaj të dhënave të publikuara, të cilat nuk korrespondojnë fare me të dhënat reale të shënuara në aplikacion. Komiteti i Helsinkit u tregoi palëve mjetet juridike në dispozicion, të cilat ata mund t'i përdorin në procedurën e mëtutjeshme të ankimimit.

4. Labirinthet juridike në fushën e mbrojtjes sociale

Duke vepruar në bazë të kërkesës për ndihmë juridike falas, Komiteti i Helsinkit identifikoi një varg parregullësish dhe lëshimesh nga organet kompetente në pjesën e procedurës për ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore.

Në rast të një kërkesë për ndihmë të përhershme financiare të dorëzuar në Qendrën ndërkomunale për punë sociale të qytetit të Shkupit (Qendër), personat profesionalë kanë kryer një inspektim të drejtpërdrejtë për të përcaktuar situatën aktuale të personit / aplikuesit dhe familjes së tij. Dy muaj pas inspektimit të bërë, aplikuesi i është drejtuar Qendrës, ku është informuar se vendimi për kërkesën e tij është pozitiv dhe se pritet që vendimin ta nënshkruajë personi juridik. Megjithatë, edhe pas kalimit të dhjetë muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës, Qendra nuk i ka dorëzuar palës vendim.

Pas urgjencës të cilën Komiteti e dërgoi në Qendër, në të cilën vumë në pah afatin e parashikuar prej 60 ditësh, brenda të cilit është obligative marrja e një vendimi, në përputhje me Ligjin për Mbrojtje Sociale, pala u thirr për të marrë vendimin me të cilin i aprovohet kërkesa për ndihmë të përhershme financiare. Paralelisht me këtë procedurë, i njejt person është edhe në një labirinth juridik, në lidhje me një procedurë ankimimi para Ministrisë së Shëndetësisë, kundër një vendimi të Zyrës Rajonale të Fondit për sigurim shëndetësor. Në këtë rast, fjala është për kërkesë për rimbursim të shpenzimeve për intervenim të kryer kirurgjik, ku vendimi i organit të shkallës së dytë përsëri pritet më shumë se dhjetë muaj. Komiteti i Helsinkit edhe për këtë rast i dërgoi një urgjencë Ministrisë së Shëndetësisë, ku u vu në pah detyrimi për vendimmarrje brenda afatit ligjor prej 60 ditësh, në pajtim me Ligjin për sigurim shëndetësor, por deri në mbylljen e këtij raporti nuk morrëm përgjigje.

TË DREJTAT E FËMIJËS

Gjatë vitit 2013, Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, iu dorëzuan një numër i madh i kërkesave për ndihmë juridike nga prindër të cilët theksuan problemin lidhur me realizimin e mundësisë për t'u takuar me fëmijën, përkatësisht problemet e njërit prind me prindin me të cilin jeton fëmija, me çka bëhet shkelje e të drejtave të fëmijës, por edhe e të drejtave të prindit me të cilin nuk jeton fëmija. Një numër i konsiderueshëm i rasteve ka të bëjë me rrethanat kur njëri prind është shtetas i huaj, ose jeton jashtë vendit, por pranë Komitetit u paraqitën edhe raste të thyerjes flagrante të drejtave të fëmijës, kur fëmija është rrëmbyer nga njëri prind ose nga familja e tij, e madje ka raste kur fëmija dërgohet jashtë shtetit. Në të gjitha këto raste, Qendra kompetente për çështje sociale, brenda kompetencave të saj rregullon takimin e fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton, por siç mund të vërtetohet nga rrethanat e të gjitha rasteve, problemi më i madh është zbatimi, gjegjësisht moszbatimi i vendimeve të marra nga Qendra kompetente për çështje sociale, duke shkurtuar kështu edhe të drejtën e fëmijës për të vendosur kontakte me prindin me të cilin nuk jeton.

1. Rregullimi i marrëdhënieve familjare në rastet me element të huaj

Gjatë vitit 2013, Komiteti i Helsinkit disa herë ka vërtetuar se në rastet e shkurorëzimit, në të cilat është e nevojshme të rregullohen marrëdhëniet familjare midis bashkëshortëve (ku njëri nga prindërit përveç shtetësisë maqedonase ka edhe shtetësi të një vendi të huaj ose është shtetas i huaj) dhe fëmijëve të tyre, ekziston një lloj joefikasiteti në zbatimin e dispozitave ligjore nga institucionet kompetente.

Në rrethana kur fëmija i është caktuar për kujdes dhe edukim njërit prind, e që rëndomë është prindi që jeton dhe punon në Republikën e Maqedonisë, takimi i prindit të dytë me fëmijën e tij, sipas ligjit, është rregulluar me vendim të marrë nga qendra kompetente për çështje shoqërore. Por, problemi qëndron në faktin se vendimet e miratuara, nuk zbatohen në praktikë. Komiteti i Helsinkit beson se fakti që prindi, takimet e te cilit me fëmijën janë rregulluar me vendim të qendrës kompetente për punë sociale, përveç shtetësisë maqedonase ka edhe shtetësi të huaj, tek prindi tjetër shkakton frikë të caktuar se mund t'i merret fëmija dhe t'i dërgohet në shtet tjetër, kështu që për këtë arsye nuk lejon realizimin e takimeve, pavarësisht faktit se ekziston një vendim i miratuar ligjërisht.

Megjithatë, kjo frikë, shpesh e pajustificuar, e njërit prej prindërve të fëmijës, nuk duhet të jetë bazë për mosrespektim e një vendimi të miratuar ligjërisht nga një autoritet kompetent, duke marrë më tej parasysh se është gjithashtu një vepër penale. Prandaj, Komiteti konsideron që institucionet kompetente përgjegjëse për rregullimin e marrëdhënieve familjare dhe marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve të tyre duhet të gjejnë një mënyrë për të vepruar më së miri në një situatë ku njëri nga prindërit, përveç shtetësisë maqedonase, gjithashtu ka shtetësi të një vendi të huaj ose është shtetas i huaj, me qëllim të mundësimit që fëmija të ketë kontakt me të dy prindërit. Kjo për më tepër sepse në këtë mënyrë të drejtat e fëmijës nuk respektohen në përputhje me legjislacionin vendas si dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ndaj të cilave ka obligime Republika e Maqedonisë, veçanërisht Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Në nenin 9, paragrafi 3 i kësaj Konvente thuhet se „Shtetet anëtare e respektojnë të drejtën e fëmijës, që nuk jeton me njërin apo me të dy prindërit, për të mbajtur kontakte personale dhe të drejtpërdrejta me të dy prindërit mbi një bazë të përhershme, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës“. Në kontekstin e rrethanave të mësipërme, nëse njëri prind jeton dhe punon jashtë vendit, ai ose ajo do të kenë përsëri të drejtën të mbajnë kontakte të përhershme me fëmijën e vet, në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 i kësaj Konvente.

2. Rasti Atanas Iliev - shkelje e vrazhdë e të drejtave të fëmijës

Rasti i Atanas Ilievit është një rast që dëshmon për një shkelje të rëndë të të drejtave të fëmijës, si dhe të drejtave të tij si baba i fëmijës. Gjegjesisht, Atanas Iliev në vitin 2008 u martua me një shtetase të Republikës së Serbisë dhe disa muaj më vonë, në të njëjtin vit, u lindi një vajzë. Në vitin 2011, me pretekstin se do të shkojë për të gjetur punë, gruaja e Atanas Ilievit, me pëlqimin e tij, shkon në Republikën e Serbisë, duke marrë me vete edhe vajzën e tyre të mitur, por në të njëjtën kohë duke deklaruar se ajo do të kthehej në Republikën e Maqedonisë më së voni për tre muaj dhe do vazhdojë të jetojë në bashkësinë martesore.

Pas disa muajve dhe pas ndërprerjes së të gjitha kontakteve, Atanas Iliev vërtetoi se gruaja e tij, e cila kishte shkuar në Republikën e Serbisë së bashku me vajzën e tyre, nuk kishte ndërmend të kthehej në Republikën e Maqedonisë. Ai iu drejtua institucionit publik, Qendrës ndërkombëtare për çështje sociale - Shkup, me qëllim të informimit për situatën e krijuar dhe kërkoi ndihmë në realizimin e takimeve me vajzën e tij dhe në të njëjtën kohë kërkoi që vajza e tij të kthehej në Republikën e Maqedonisë. Ai gjithashtu në ndërkohë mësoi që gruaja e tij tashmë kishte bërë kërkesë për divorc në Gjykatën Themelore në Shabac.

Pas shfrytëzimit të të gjithë mekanizmave juridikë në dispozicion të tij, Atanas Iliev në vitin

2012 gjithashtu paraqiti një kërkesë në Institucionin publik Qendrën ndërkomunale për çështje sociale - Shkup për të vepruar në përputhje me Konventën e Hagës për aspektet civile - juridike të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve¹, ku kërkoi autoritetet të vepronë në përputhje me kërkesën, në mënyrë që t'i kthehet fëmija, pasi që tashmë ishte vërtetuar që ishte rrëmbyer nga nëna. Kjo kërkesë iu përcoll edhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, e cila si organ qendror, është e detyruar të veprojë sipas këtyre kërkesave.

Pasi u morën të gjitha masat e nevojshme nga autoritetet kompetente në Republikën e Maqedonisë, Atanas Iliev u informua se Gjykata Themelore në Shabac, Republika e Serbisë, tashmë kishte vendosur për kërkesën për të vepruar në përputhje me Konventën e Hagës për aspektet civile - juridike të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve dhe kishte marr vendim sipas të cilit refuzohet kërkesa e këtij personi për kthimin e vajzës së tij të mitur në Republikën e Maqedonisë. Sipas pohimeve të autoriteteve kompetente në Republikën e Maqedonisë, refuzimi i kërkesës për kthimin e fëmijës në Republikën e Maqedonisë është për shkak të mosgatishmërisë së autoriteteve kompetente në Republikën e Serbisë për të ndihmuar në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Është e rëndësishme të theksohet se përgjigjen me të cilën refuzohet kjo kërkesë, autoritetet kompetente në Republikën e Maqedonisë ia kanë dorëzuar Atanas Ilievit me vonesë prej një viti, pasi që Gjykata Themelore në Shabac ka vepruar mbi atë kërkesë.

Për më tepër, në mënyrë që të mbrojtë të drejtat e tij si prind dhe të drejtat e fëmijës së tij, në vitin 2011 Atanas Iliev në Gjykatën Themelore Shkupi 2 Shkup dorëzoi kërkesë për divorc dhe i kërkoi gjykatës që kujdestarinë, edukimin dhe mbështetjen e pjeshme financiare t'ia besojë atij, si babai i vajzës dhe ta detyrojë nënën që të paguajë alimentacion për fëmijë të mitur në vlerë prej 3,000 denarësh.

Pas një shtyrjeje 20 mujore të procedurave të divorcit, Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup, morri vendim me të cilin refuzoi kërkesën e padisë së Atanas Ilievit, me shpjegimin se edhe pse sipas Ligjit për Procedurën Civile dhe Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup është kompetente për të vepruar lidhur me këtë padi, nuk mund ta bëjë këtë, duke pasur parasysh faktin se një procedurë divorci tashmë ka filluar para Gjykatës Themelore në Shabac, Republika e Serbisë.

Duke ushtruar të drejtën e tij për të ankimim, Atanas Iliev paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit të Shkupit kundër vendimit të marrë nga Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup. Në momentin e përpilimit të raportit, Gjykata e Apelit nuk ka vendosur ende mbi ankesën.

Pas kësaj shtate të vërtetuar faktike, Komiteti i Helsinkit dëshiron t'u bëjë thirrje të gjitha institucioneve dhe organeve kompetente të vepronë me kujdes dhe seriozitet në këtë rast, me qëllim të zgjidhjes së plotë, duke i marrë parasysh të drejtat dhe interesat e

1 http://www.hcch.netindex_en.php?act=conventions.text&cid=24

fëmijës së mitur dhe mbrojtjen e të drejtave të prindit të fëmijës, i cili nuk e ka parë fëmijën për më shumë se 2 vjet e gjysmë.

3. Rasti Tatjana Boshnjakovska

Duke vepruar në rastin e të miturës A. B., e cila nuk e kishte parë nënën e saj, Tatjana Boshnjakovska, për më shumë se 2 vjet, Komiteti i Helsinkit konstatoi pasivitet dhe joefikasitet të institucioneve, madje edhe kur bëhet fjalë për ushtrimin e të drejtave të fëmijës.

Gjegjësisht, përkundër faktit se vendimi me të cilin Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup të miturën A.B. ia kishte lënë në përkujdesje dhe edukim nënës së saj, ishte ekzekutues, i njëjti nuk mund të zbatohet, pasi që nëna edhe pas dy vitesh nuk kishte mundësi të kontaktojë me fëmijën. Për shkak të kësaj, Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup, vendosi që person i autorizuar zyrtar i gjykatës të veprojë sipas aktgjykimit përfundimtar ekzekutiv në mënyrë që do ta zbatonte me forcë, në prani të Entit publik Qendra ndërkomunale për punë sociale - Shkup (QNPS) dhe asistencës së Ministrisë së Brendshme.

Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për fëmijë që nuk ka pasur kontakt me nënën për më shumë se dy vjet dhe ku babai, ku gjendej fëmija aktualisht, refuzonte ta dorëzonte vullnetarisht atë tek nëna, Komiteti i Helsinkit menjëherë iu drejtua institucioneve kompetente me një kërkesë për urgjencë reagimi për zbatimin e vendimit të gjykatës.

Nga përmbaruesi dhe policia merrnin informata se vajza do të gjendej së shpejti, por edhe dy muaj pas vendimit për zbatimin e detyruar, nuk u arrit asnjë rezultat. Me shkresë iu drejtua edhe Ministres së punëve të brendshme, me qëllim që ta informojmë në lidhje me rastin dhe me faktin se deri më tani nuk ka rezultate në procedurë dhe se as nëna nuk është informuar për veprimet e ndërmarra dhe nëse ka ndonjë përparim për gjetjen e vajzës.

Nëna u udhëzua të merrte një vërtetim nga shkolla ku e mitura A.B. duhej të ndiqte mësim për numrin e mungesave, me ç'rast u konkludua se në vitin shkollor 2012/2013 fëmija pandërprerë ka munguar nga shkolla për shtatë muaj, për shkak të së cilës është caktuar një datë në gusht për të dhënë provimin për klasën e parë. Ky vërtetim iu dorëzua përmbaruesit gjyqësor, shërbimeve të Ministrisë së Brendshme dhe Ministres së Brendshme.

Komiteti arriti në përfundimin se në këtë rast ka shkelje të të drejtave të fëmijës, që nuk jeton në kushte normale familjare, i pamundësohet kontakti me nënën për më shumë se 2 vjet dhe i kufizohet e drejta për arsim.

Shërbimet policore arritën të gjejnë të miturën A.B. më 05.09.2013 në një automjet taksifër Mavrovi Anovi - Mavrovë. Akuza penale u ngritën edhe ndaj gjyshit, gjyshes dhe babait të të miturës A.B. për rrëmbimin e një të miture dhe neglizhencën dhe maltretimin e fëmijës së mitur, në bazë të së cilës filloi një procedurë gjyqësore. Gjykata Themelore Shkupi 1 Shkup i shpalli personat fajtorë për veprën penale rrëmbim të një të miture dhe i dënoi ata me dënim me kusht prej një viti burgim, nëse nuk e përsërisin krimin brenda katër vitesh.

Edhe pse e mitura A.B. u gjet dhe iu dorëzua nënës së saj, megjithatë mendojmë se përmbaruesi gjyqësor dhe policia nuk arritën të zbatojnë me shpejtësi dhe me efikasitet vendimin e gjykatës dhe të përfundojnë procedurën për gjetjen e të miturës AB, andaj konkludojmë se rasti konkret është dëshmi se institucionet nuk mund të sigurojnë mbrojtje efektive as kur bëhet fjalë për të drejtat e fëmijës. Kjo i referohet posaçërisht Institucionit publik Qendrës ndërkomunale për punë sociale - Shkup, e cila si institucion është drejtpërdrejt përgjegjëse për të përcaktuar dinamikën e takimit të fëmijës me nënën, si dhe detyrimin për të mundësuar takimin. Në këtë rast, kjo Qendër nuk arriti të zbatojë vendimim dhe të mbrojë të drejtat dhe interesat e fëmijës për më shumë se dy vjet.

TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

1. Nisma qytetare „AMAN“

Komiteti i Helsinkit monitoroi procesin e mbledhjes dhe dorëzimit të 13,169 nënshkrimeve të qytetarëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, si rezultat i nismës së parë civile të zbatuar me sukses nga një shoqatë joformale e qytetarëve. Gjithashtu, Komiteti, duke ndjekur procesin e praktikimit të së drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve me interes publik, ndoqi me interes të veçantë punën e institucioneve dhe qëndrimin e tyre ndaj nismave qytetare.

Komiteti mirëpriti punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve si një organ i autorizuar për zbatimin e nismave qytetare. Për një pjesë të madhe të procesit, Komisioni ishte në komunikim me nënshkruesin e autorizuar të nismës, me çka u tejkaluan disa probleme, që në pjesën dërmuese ishin rezultat i mungesës së praktikës në zbatimin e nismave qytetare. Njëherit, barra më e madhe e zbatimit bie mbi propozuesin e autorizuar, gjegjësisht mbi qytetarët. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka paraparë buxhet për nismat civile, përkatësisht është i përfshirë vetëm në një pjesë të vogël të kompetencave teknike, ndërkaq shtypja, dërgesa dhe distribuimi i formularëve në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë u lihet qytetarëve.

Pas mbledhjes së formularëve, qytetarët ia dorëzuan institucionit kompetent - Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Komiteti vuri re një mungesë të përgjithshme të vetëdijes së zhvilluar për demokraci parlamentare tek një pjesë e deputetëve përmes fyerjeve që ata ia drejtuan përfaqësuesve të iniciativës civile „AMAN“. Gjegjësisht, nisma kaloi procedurat parlamentare në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe u shqyrtua nga dy komisione parlamentare më 07 shkurt 2013, si më poshtë:

-Komisioni për çështje ekonomike, si organ amë ku shqyrtohen çështjet e energjetikës

-Komisioni Legjislativo-juridik, i cili përcakton nëse ndryshimet e kërkuara janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e RM - së.

Komisioni mirëpret qëndrimin e përfaqësuesve të partive parlamentare PDSH dhe RDK, të cilat u përpoqën të mbështesin iniciativën qytetare, veçanërisht duke shprehur dyshime për punën e institucioneve të diskutueshme, nën juridiksionin e të cilave është sektori i energjetikës dhe duke kërkuar diskutim publik mbi pikëpamjet e shprehura të

qytetarëve përballë Komisionit Rregullator të Energjetikës, Agjencisë për Energjetikë dhe Ministrisë së Ekonomisë. Lidhur me vërejtjet për punën e komisioneve, Komisioni shpreh pakënaqësi nga qëndrimi i deputetëve të grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së për ofendimet e shprehura ndaj përfaqësuesve të AMAN-it, posaçërisht ndaj propozuesit të autorizuar të ndryshimeve në Ligjin për Energjetikë. Komiteti Legjislativo-juridik nuk diskutoi nëse ndryshimet e kërkuara janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e RM-së. Pas diskutimeve në të dy komisionet, propozimi u vu në rend dite të seancës plenare, ku propozuesja e autorizuar, Zorica Dimovska, u prit keq nga disa deputetë të cilët asaj iu drejtuan me fjalët „komuniste ik“, „cilës parti i përket“, „kush të mësoi“ etj.

Përkundër këtyre rrethanave, Komiteti i Helsinkit nismën e konsideron si të sukseshme, e njëherit si përpjekje të parë të rëndësishme për pjesëmarrjen e qytetarëve në marrjen e vendimeve me interes publik përmes formave të demokracisë së drejtpërdrejtë.

2. Zgjedhjet lokale 2013

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, gjatë dy rraundeve të zgjedhjeve lokale 2013, përmes zyrës së vet të hapur u mundësoi qytetarëve t'i denoncojnë shkeljet e të drejtës së votës. Ankesat u pranuan përmes bisedave telefonike, postës elektronike dhe nga vetë qytetarët që kontaktuan zyrën e hapur. Njëherit, Komiteti bashkëpunoi me OJQ "Civil", e cila ishte e autorizuar / akredituar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve që të bëjë monitorimin e procesit zgjedhor, në mënyrë që në kohë të merrte informata nga vëzhguesit në terren. Gjatë zgjedhjeve u vu re:

- Agjitacion nga anëtarët dhe mbështetësit e partive politike para qendrës së votimit
- Shkelja e heshtjes zgjedhore përmes shpërndarjes së materialeve propaganduese në ndërtesat e banimit
- Lëshimi i dokumenteve personale, shërbimeve dhe transferimi i banorëve nga qyteti Pustec, Republika e Shqipërisë, në qendrat e votimit në Komunën e Qendrës
- Frikësimi i qytetarëve dhe vëzhguesve të akredituar nga partitë politike, dhënie rryshfet votuesve
- Shënimi joadekuat i kutive të votimit dhe leximi me zë të lartë i të dhënave personale nga anëtarët e komisioneve zgjedhore

- Presioni ndaj qytetarëve të punësuar në institucione publike dhe shkelja e paprekshmërisë dhe fshehtësisë së të drejtës së votes
- Prania e oficerëve të policisë në vendvotim, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor ndikojnë në zhvillimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave politike dhe civile.

Për më tepër, parregullsitë gjatë zgjedhjeve lokale ndikojnë në imazhin e përgjithshëm të vendit në politikën e jashtme dhe, në këtë mënyrë, në zhvillimin e përgjithshëm demokratik të vendit.

Komiteti përkujton se shumica e shkeljeve e parregullësive u konstatuan në Komunën e Qendrës, rast për të cilin nuk ishte kryer ndonjë hetim i duhur nga institucionet kompetente. Pavarësisht nga apeli i Komitetit tek institucionet kompetente për të hetuar pretendimet dhe për të zbuluar faktet në lidhje me banorët e qytetit Pustec, Republika e Shqipërisë, deri në publikimin e këtij raporti, hetimi nuk u krye. Kjo mundëson manipulim të Kodit Zgjedhor dhe të njerëzve që ishin të përfshirë në procesin e sigurimit të votave nga diaspora.

Komiteti vëren me keqardhje se në Republikën e Maqedonisë e drejta zgjedhore e qytetarëve ende rrezikohet nga pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor, përkatësisht nga partitë politike dhe aktivistët. Duke pasur parasysh atmosferën e përgjithshme zgjedhore, shkeljen e fshehtësisë dhe paprekshmërisë të së drejtës për të votuar, është e qartë se bëhet fjalë për një deficit demokratik në sistem, dhe kështu, mungesë të kapacitetit për të përmirësuar kornizën legislative dhe për të mundësuar zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike në Republikën e Maqedonisë.

3. Shkeljet e të drejtës së tubimit dhe lirisë së shprehjes

Në vitin e kaluar, Komiteti i Helsinkit u ka kushtuar vëmendje të madhe shkeljeve të së drejtës për tubim dhe lirisë së shprehjes përmes një forme të protestës ose tubimit publik. Në këtë drejtim, në vitin 2013 Komiteti ndoqi disa protesta, gjatë të cilave policia reagoi në mënyrë të parakohshme ose joprofesionale, por gjithashtu gjeti shkelje ose përpjekje për të penguar një tubim publik, duke inkorporuar kështu praktikën e kufizimit të së drejtës së garantuar me kushtetutë për të protestuar. Aq më shqetësues është fakti që në shumë prej protestave paqesore dhe tubimeve publike të vëzhguara, kufizimet u vendosën nga oficerët e policisë duke pamundësuar qasjen në vendin e protestës. Gjithashtu shqetësuese është mungesa e efikasitetit për të mbrojtur një grup të nxënësve të shkollave të mesme që protestuan në Shkup kundër testimit ekstern, veçanërisht kur

gjatë njëres prej protestave të tyre, grupi u sulmua fizikisht nga disa të rinj që u arratisën para oficerëve të policisë, të cilët për arsye të panjohura, nuk bënë ndonjë përpjekje për t'i legjitimuar dhe ndaluar ata.

Fjala është për dy grupe të qytetarëve që ushtronin të drejtën për protestë paqesore; njëri grup shprehte pakënaqësinë për ndalimin e gazetarit Tomisllav Kezharovski, kurse grupi tjetër ishin nxënës të shkollave të mesme që protestuan kundër „Testimit të jashtëm”.

Komiteti konkludon se protesta që ishte e organizuar dhe u paralajmërua përmes mediave më 23 tetor 2013 nga Këshilli nismëtar për lirimin e gazetarit Tomisllav Kezharovski u pengua nga oficerët e policisë. Gjegjësisht, para fillimit të tubimit të paralajmëruar, rreth Muzeut të Luftës Maqedonase për Shtetësi dhe Pavarësi (i njohur edhe si Muzeu i VMRO - së) ishte e dukshme prania e rreth pesëdhjetë oficerëve të policisë nga rradhët e shërbimeve të rregullta policore, por edhe nga Njësia e ndërhyrjes së shpejtë. Kufizimi i lëvizjes së qytetarëve drejt vendit të paraparë për mbajtjen e protestës paqesore u bë duke vendosur një kordon i cili bllokonte plotësisht të gjitha qasjet drejt Muzeut dhe nuk lejohej as lëvizja e qytetarëve dhe as mbajtja e protestës së njoftuar.

Në lidhje me protestat e nxënësve të shkollave të mesme kundër zbatimit të testimit të jashtëm nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Komiteti konstatoi se oficerët e policisë nuk iu përgjigjën detyrës së tyre për të siguruar të drejtën e protestës paqesore, duke i ekspozuar nxënësit e shkollave të mesme dy herë ndaj rreziqeve serioze. Gjatë protestës së parë, nxënësit e shkollave të mesme nuk morën mbështetje në kohë nga oficerët e policisë në rregullimin e trafikut, gjë që i ekspozoi ata ndaj sulmeve verbale nga pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Gjatë protestës së dytë, nxënësit e shkollave të mesme u sulmuan fizikisht nga një grup i vogël të rinjsh, të cilët u përpoqën të trembnin dhe lëndonin nxënësit me shishe qelqi dhe gurë. Oficerët e policisë ishin dëshmitarë të ngjarjes, por fatkeqësisht, nuk morrën masa përkatëse për kapjen e autorëve. Lidhur me rastin në fjalë, nuk është e njohur se cilët shin autorët e veprës dhe nëse të njejtit ishin sanksionuar nga institucionet kompetente.

Komiteti i Helsinkit thekson se e drejta për tubim publik dhe liria e lëvizjes së qytetarëve janë vlera themelore të rendit kushtetues maqedonas. Ligji për tubimet publike përcakton që një tubim publik, me qëllim të shprehjes paqesore të mendimit ose protestë, mund të mbahet në çdo vend që është i përshtatshëm për atë qëllim, përveç në afërsi të institucioneve shëndetësore, kopshteve për fëmijë dhe shkollave. Kësisoj, muzetë nuk paraqesin zona të ndaluara, por institucione të karakterit publik. Kodi Penal përcakton që nëse një person zyrtar, duke keqpërdorur pozitën ose kompetencat zyrtare, me forcë ose në ndonjë mënyrë tjetër parandalon ose pengon mbajtjen e një tubimi paqesor publik, ai do të dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

4. Protestat e dhunshme

Vitin 2013 e shënuan gjithashtu një varg protestash të dhunshme që rezultuan me dhunë, prishjen e rendit publik dhe shkaktimin e dëmit material në pronën publike dhe private. Sipas Kushtetutës dhe ligjeve në Republikën e Maqedonisë, përdorimi i formave të dhunshme të shprehjes së pakënaqësisë gjatë tubimeve publike në formë proteste ose lloji tjetër të tubimeve publike, paraqesin vepra të dënueshme. Komiteti ndoqi të gjitha protestat e dhunshme në vitin e kaluar dhe arriti në përfundimin se në Republikën e Maqedonisë, grupe të caktuara lejohen, ndërsa grupe të tjera të caktuara nuk lejohen të përdorin dhunë, përkatësisht janë ose nuk janë ndëshkuar për këtë vepër.

4.1. Protestat e dhunshme dhe urrejtja etnike

Protestat e para të dhunshme u zhvilluan në mars dhe atë rradhazi, njëra pas tjetrës. Gjegjesisht, Komiteti ndoqi protestat në 02; 03 dhe 08 mars, të cilat u përcollën me fjalime dhe krime të kryera nga urrejtja ndaj një grupi të caktuar etnik. Protesta e parë ose 02/03/2013 u organizua nga një grup të rinjsh që i përkisnin grupit etnik maqedonas të cilët shprehën pakënaqësinë e tyre me zgjedhjen e Talat Xhaferit si Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë. Në përgjigje të trazirave të kësaj dite dhe dëmtimeve të rënda që iu shkaktoan disa kalimtarëve të rastit në sheshin „Maqedoni“, të rinj që i përkisnin bashkësisë etnike shqiptare, protestat e dyta të dhunshme u zhvilluan në 03/03/2013. Gjegjesisht, një grup të rinjsh që i përkisnin bashkësisë etnike shqiptare protestuan kundër dhunës që rezultoi me prishjen e rendit publik dhe dëmtimin serioz të pronës publike dhe private. Protestat e fundit, ose përpjekjet për protesta të dhunshme ishin në 08/03/2013, por u parandaluan në kohë nga oficerët e policisë, të cilët, ndryshe nga dy protestat e mëparshme, ishin më të përgatitur për t’iu përgjigjur detyrës.

4.2. Lëshimet e oficerëve të policisë dhe marrja e përgjegjësisë së institucioneve dhe pjesëmarrësve në protestat e dhunshme

01 Mars 2013

Sipas gjetjeve të ekipit të Komitetit të Helsinkit mbi parandalimin dhe përshkallëzimin e mundshëm të trazirave, oficerët e policisë nuk kishin kontroll mbi grupin e mbledhur para Qeverisë. Midis lëshimeve të vërejtura ishte edhe shpërndarja e turmës, përkatësisht grupi përfundoi në sheshin „Maqedoni“ pasi oficerët e policisë filluan të ndiqnin pjesëmarrësit në atë drejtim. Pastaj,

në sheshin „Maqedoni” ndodhi një përplasje tjetër, ku pësuan edhe shumë kalimtarë të rastit. Gjithashtu, oficerët e policisë në disa raste përdorën forcë fizike ndaj personave tashmë të ndaluar, duke i mbajtur në rrugë me pranga, duke i shqelmuar dhe duke i rrahur. Përfaqësuesit e Komitetit ishin dëshmitarë pikërisht të një ngjarjeje të tillë dhe atyre u ishte thënë që menjëherë të largohen nga vendi i ngjarjes dhe të mos dokumentonin maltretimin e pjesëmarrësve të ndaluar në protestë. Përveç kësaj, një numër i madh i oficerëve të policisë u lënduan nga pjesëmarrësit në protestë, për shkak të moskoordinimit dhe mungesës së gatishmërisë të oficerëve të policisë për t’iu përgjigjur detyrës. Lidhur me këtë protestë, institucionet nuk filluan procedurë kundër autorëve të veprimeve të mësipërme dhe as nuk u mor përgjegjësi për reagimin e papërshtatshëm të oficerëve të policisë që u përleshën me turmën e revoltuar.

02 Mars 2013

Për vëzhguesit e Komitetit, mbetet e paqartë pyetja dhe ndarja e turmës në grup më të madh dhe më të vogël, ku grupi më i vogël ishte siguruar dukshëm nga oficerët e policisë. Njëherit, Komiteti vëren se përveç protestës së imagjinuar kundër dhunës ndaj komunitetit shqiptar, kishte një përplasje të brendshme brenda turmës midis dy grupeve. Nuk u vërejtën lëshime më të mëdha të oficerëve të policisë, përveç shoqërimit dhe mbrojtjes së grupit më të vogël, i cili shprehu pakënaqësi për grisjen e pankartave, me çka nxiti përplasje me grup më të madh. Oficerët e policisë përdorën forcë në mënyrë proporcionale për të zbrapsur turmën dhe për ta mbajtur larg qëllimit që të vazhdojë me veprime të dhunshme. Edhe në këtë protestë, si edhe në të mëparshmen, numër i madh i policëve u plagosën nga pjesëmarrësit në protestë. Në lidhje me këtë protestë të dhunshme, pjesëmarrësit u identifikuan dhe u nxorrën para organeve kompetente dhe u dënuan me burgim, por edhe financiarisht për shkak të dëmtimit të pronës publike dhe private.

08 Mars 2013

Protestat e planifikuara për 8 Mars, siç thuhet në tekstin e mësipërm, kaluan pa pasoja të konsiderueshme dhe përpjekja për dhunë u parandalua në mënyrë adekuate. Duke i pasur parasysh dy protestat e mëparshme, policët ishin të përgatitur të përgjigjeshin në mënyrë të përshtatshme, poqese grupi relativisht i vogël me tendencë për dhunë, vendoste të merrte ndonjë veprim.

4.3. Protesta të dhunshme të organizuara nga lëvizja joformale civile "Veritas"

Përfaqësuesit e Komitetit konstatuan një varg parregullësish në sjelljen e qytetarëve që shprehnin pakënaqësinë e tyre për gjoja ndalimin dhe prishjen e ndërtimit të kishës së Shën Konstandinit në Komunën Qendër. Gjegjësisht, edhe pse kryetari i Komunës së Qendër informoi opinionin se ndërtimi i objektit në fjalë nuk do të ndalet ose priset, qytetarët megjithatë u drejtuan para Komunës për të protestuar. Më vonë, protestat paqesore u përshkallëzuan, protestuesit hynë me forcë në oborrin e komunës. Pas kësaj, policia reagoi pa përdorur forcë fizike, duke mos ndaluar ose identifikuar asnjë person, gjë që është në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 4 i Ligjit për Policinë e RM - së.

Protesta vazhdoi deri pasdite vonë, e përcjellë me gjuhë të urrejtjes në baza kombëtare dhe politike dhe me përshëndetje antisemitike - një përshëndetje me duar e njohur si „hail”. Për shkak të gjuajtjes me gurë, u shkaktua edhe dëm material mbi pronën publike. Për sulmet, nuk u ndalua asnjë pjesëmarrës. Përveç shkeljeve të sipërpërmendura, përfaqësuesit e Komitetit vunë re një sasi të konsiderueshme alkooli në mesin e protestuesve, gjë që është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për tubime publike.

Komiteti i Helsinkit konstaton se në rastet e sipërpërmendura, përveç një sërë parregullësish në veprimet e policëve, ekziston një tendencë për ndëshkim ose drejtësi selektive, kur bëhet fjalë për prishjen e rendit dhe qetësisë publike dhe shkaktimin e dëmit material dhe jo material gjatë protestave të dhunshme. Gjegjësisht, protestat e 01 marsit dhe ato në Komunën Qendër nuk kanë kurrfarë epilogu kundravajtës ose penal ndaj autorëve, identiteti i të cilëve mund të verifikohet, duke pasur parasysh videomaterialet të cilat u shpërndanë nga disa media në Republikën e Maqedonisë.

5. Gjuha e urrejtjes

Gjatë vitit të kaluar, gjuha e urrejtjes ishte përgjithësisht e pranishme në hapësirën publike, veçanërisht e shprehur përmes urrejtjes dhe intolerancës ndëretnike. Si rezultat i protestave të tensionuara të dhunshme në muajin mars, gjatë vitit të kaluar në hapësirën publike pati edhe shumë vepra penale në bazë të urrejtjes. Gjithashtu ngjall brengosje gjuha e shprehur e urrejtjes në bazë kombëtare dhe politike. Por më shqetësuese është shfaqja e përshëndetjeve antisemitike - përshëndetja me dorë, e njohur si „hail” dhe përdorimi i simboleve naziste në formën e mbishkrimeve në të gjithë Republikën e Maqedonisë. Veçanërisht e frikshme është gjuha e urrejtjes në hapësirën publike e drejtuar kundër qytetarëve - pjesëtarë të komunitetit LGBTI.

6. Iniciativa për përcaktimin kushtetues të martesës si bashkësi midis një burri dhe një gruaje

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është akti më i lartë juridik që përmban të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ndryshe nga ligjet, procedura për ndryshimin e rregullave dhe normave të përgjithshme të përfshira në Kushtetutë kërkon mbështetje më të gjerë politike për shkak të qëllimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit të sundimit të ligjit dhe barazisë. Në të njëjtën kohë, u mundëson qytetarëve siguri juridike nga ndërhyrjet e drejtpërdrejta dhe kufizimet e shtetit, përkatësisht pushtetit ekzekutiv në të drejtat dhe liritë themelore, zbatimin e parimit të barazisë në të drejtat dhe liritë dhe sundimin e ligjit në një sistem demokratik. Në pajtim me atë që u tha më lartë, të drejtat dhe liritë themelore, siç është e drejta për vetidentifikim, e drejta për privatësi me një theks të veçantë në jetën familjare, statusi dhe njëherit e drejta për zgjedhje të lirë, nuk duhet t'u nënshtrohen përkufizimeve. Kjo veçanërisht u referohet restriksioneve që mund të ndikojnë në vendosjen e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminimit në shoqëri, si tërësi, duke pasur parasysh se grupet shoqërore kanë karakter heterogjen dhe individët mund t'i takojnë, ose mos t'i takojnë ndonjë kolektivi.

Në këtë drejtim, nisma e paraqitur nga ana e grupit parlamentar të VMRO-DPMNE për ndryshime në Kushtetutë, përkatësisht të nenit 40, paragrafët 1 dhe 2, të cilat i referohen si vijon: "Republika siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë për familjen. Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësi jashtëmartesore rregullohen me ligj", nuk ka asnjë justifikim juridik për të ndryshuar sepse:

1. Ligji për Familjen i Republikës së Maqedonisë rregullon këtë çështje në mënyrë identike si parashtruesi i iniciativës për ndryshimin e Kushtetutës, përkatësisht se martesë dhe bashkësia jashtëmartesore, janë bashkësi midis një burri dhe një gruaje. Prandaj, parashtruesi nuk ka asnjë justifikim juridik dhe argumente që do të tregonin nevojën për të ndryshuar nenin 40 të Kushtetutës dhe kërcënimin e Ligjit për familjen, që e rregullon këtë çështje.

2. Duke pasur parasysh karakterin laik, ose ndarjen e kishës nga shteti, si një parim kushtetues, referimi në "traditën shekullore dhe parimet etike, morale dhe fetare të të gjitha religjioneve në Republikën e Maqedonisë, që e përcaktojnë martesën si bashkësi midis një burri dhe një gruaje" - f.7, do të thotë ndërhyrje e drejtpërdrejtë e një sistemi paralel të rregullimit, që nuk bazohet në parimin e sundimit të së drejtës. Njëherit, argumenti se në Republikën e Maqedonisë të gjitha fetë e përcaktojnë martesën si bashkësi midis një burri dhe një gruaje, nuk është i saktë përnga pikëpamja fetare dhe tradicionale tek pjesëtarët e bashkësisë islamike. Kjo sepse sipas mësimave fetare në këtë komunitet, martesë e një burri me më shumë gra, ishte tradicionalisht e lejuar. Kjo praktikë fetare sipas Kodit Penal në Republikën e Maqedonisë nuk lejohet, sepse paraqet bigami dhe

poligami, të cilat konsiderohen vepër penale dhe e njëjta, në shoqërinë moderne nuk praktikohet nga pjesëtarët e bashkësisë fetare islame. Andaj, justifikimi për respektimin e parimit të sekularizmit të shtetit duhet të merret seriozisht nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike në mënyrë që të mos manipulohet me ndjenjat fetare dhe përkatësinë e qytetarëve ndaj ndonjë komuniteti fetar.

Gjithashtu, çdo restriksion i kësaj të drejte, do të thoshte ndërhyrje e drejtpërdrejtë e shtetit në jetën private dhe familjare të individit, duke përfshirë definimin përkufizues të lidhjeve sociale, shoqërore dhe familjare, duke vendosur një detyrim që është në kundërshtim me drejtësinë. Në të njëjtën kohë, një restriksion i këtillë, do të ndikojë drejtpërsëdrejti tek qytetarët që i përkasin komunitetit LGBTI, jeta private dhe familjare e të cilëve nuk është në përputhje me ndryshimin e propozuar. Duke pasur parasysh se të gjithë qytetarët në Republikën e Maqedonisë sipas Kushtetutës janë të barabartë në të drejtat dhe detyrimet, ndërhyrja e drejtpërdrejtë e shtetit në privatësi, do të shkaktonte trajtim të pabarabartë dhe kështu edhe diskriminim të një grupi të caktuar të qytetarëve, në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe parimeve demokratike mbi të cilat bazohet sistemi i rregullimit të Republikës së Maqedonisë. Njëherit, propozimet e tilla ndikojnë në përhapjen e propagandës negative të shumicës së popullsisë ndaj njerëzve të komunitetit LGBTI, të cilët në periudhën e kaluar kanë qenë viktime të dhunës psikologjike dhe fizike.

7. Të burgosurit politikë

7.1 Jovan Vranishkovski

Kryepeshkopi Jovan Vranishkovski është i burgosuri i parë politik në Republikën e Maqedonisë, që nga pavarësia e saj. Gjatë vitit 2013, z. Vranishkovski, së bashku me 18 persona të tjerë (përfshirë nënën, motrën dhe dajën, klerikët, idhtarët dhe mbështetësit e Kryepeshkopatës Ortodokse të paregjistruar të Ohrit) u akuzuan për kinse pastrim parash përmes një shoqate qytetarësh që kishte planifikuar të ndërtojë një objekt për takime të besimtarëve. Aksioni policor për arrestimin e të pandehurve u quajt „skizmatik“, që barazohet me paragjykime dhe paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurve. Me një vendim të pavlefshëm të Gjykatës Penale në Shkup, z. Vranishkovski u dënua me tre vite burg, kurse të gjithë të pandehurit e tjerë me dy vite burg, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse personat nuk kryejnë vepër të re penale, brenda pesë viteve. Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit ndoqën të gjitha seancat gjyqësore, por nuk u bindën në argumentet që i ofroi Prokuroria Publike për të provuar fajësinë e cilitdo nga të pandehurit.

Në ditën kur duheshte të shpallet vendimi, këshilli gjyqësor vendosi ta kthejë çështjen

në shqyrtimin kryesor dhe në të njëjtën kohë, pa dijeninë e të pandehurve dhe avokatit të tyre, njoftoi se para Gjyqit do të dëshmojë person, i cili gjoja ka negociuar shitjen e pronës me z. Vranishkovskin. Dëshmitari pretendonte se ai për parcelën e tokës kishte negociuar në emër të vetin dhe në emrin e fqinjëve të tij që e kishin autorizuar atë përmes një prokure me shkrim. I pandehuri i parë mohoi që ai të ishte takuar ndonjëherë me dëshmitarin dhe pas kësaj avokati kërkoi që prokura të paraqitej si provë para gjykatës. Në atë moment, këshilli gjyqësor u largua nga salla e gjyqit dhe pas këshillimit 20 minutësh njoftoi se propozimi refuzohet dhe se përfundon procedura gjyqësore. Vendimi i shkallës së parë u apelua, kurse Gjykatës së Apelit në Shkup iu deshtën më shumë se shtatë muaj për të caktuar një seancë dëgjimore publike për prill të vitit 2014. Kur përfundimisht duheshte të mbahej seanca dëgjimore publike, gjykata e shtyu atë për në maj, sepse z. Vranishkovski nuk u soll nga Institucioni ndëshkimor rehabilitues „Idrizovë“. Në maj, Drejtoria e burgut, pa e informuar gjykatën për arsyet, përsëri nuk e solli të pandehurin.

Republika e Maqedonisë refuzon të regjistrojë Kryepeshkopatën Ortodokse të Ohrit si një kishë ose si grup fetar, që nga viti 2004. Kjo paraqet shkelje të nenit 9 (liria e besimit fetar), nenit 11 (liria e tubimit) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Komiteti i Helsinkit përfaqëson Kryepeshkopatën Ortodokse të Ohrit para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që nga viti 2006 dhe pret një vendim gjatë vitit 2014. Përveç diskriminimit dhe barrierave administrative me të cilat përballen pjesëtarët e kësaj kisha, të cilët stigmatizohen publikisht dhe quhen „tradhtarë, skizmatikë dhe kriminelë“, z. Vranishkovski është në ndjekje penale të vazhdueshme nga ana e pushtetit. Në 11 vitet e fundit, ai është dërguar në burg gjashtë herë, kurse për momentin vuan dënimin në Institucionin ndëshkimor rehabilitues „Idrizovë“.

7.2 Ljube Boshkovski

Në maj të vitit 2013, Gjykata Supreme në Shkup, lidhur me çështjen e ashtuquajtur „Fushata“, Ljube Boshkovski i dorëzoi aktvendim me të cilin refuzoheshin ankesa e tij dhe ankesat e avokatëve të tij, si të pabazuara, duke konfirmuar verdiktin e Gjykatës së Apelit në Shkup, me të cilin Boshkovski u dënua me pesë vjet burg për keqpërdorim të fondeve për financimin e fushatës zgjedhore. Të gjitha vendimet e gjykatave lidhur me këtë rast janë rezultat i një procesi të montuar dhe politik, në të cilin një rol të madh e ka pushteti ekzekutiv, dhe të gjitha u marrën në procedurë dhe mënyrë që është në kundërshtim me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare. Komiteti i Helsinkit ka monitoruar këtë çështje që nga fillimi, dhe për shkak të shkeljes së nenit 6 (e drejta për një gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, dërgoi një ankesë pranë Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Ankesa në fjalë u dorezua për arsye se me gjykimin e z. Boshkoskit nuk udhëhoqi një gjykatë e paanshme, pati shkelje të prezumimit të pafajësisë, publiku u përjashtua nga gjykimi në një mënyrë të paligjshme, procedura nuk ishte kontradiktore dhe u zhvillua në kundërshtim me parimin e “barazisë së armëve”, pjesëmarrja e të pandehurit ishte joefektive (pa mundësinë e pyetjes së dëshmitarit të rrezikuar), dhe gjatë procedurës u përdorën prova të paligjshme.

Komiteti i Helsinkit monitoroi procesin gjyqësor për vrasjen e Marijan Tushevskit dhe Kiro Janevit, të kryera në vitin 2011, në të cilin u akuzuan 15 persona, tre prej tyre për ekzekutim të drejtpërdrejtë dhe 12 të tjerët për ndihmë, përfshirë edhe Ljube Boshkovskin (atëherë ministër për punë të brendshme), që në opinion njihet si rasti „Rover“. Ashtu si edhe në procedurën gjyqësore për çështjen „Fushata“ edhe në çështjen „Rover“, përsëri ishim dëshmitarë të përjashtimit të publikut nga marrja në pyetje e dëshmitarit të mbrojtur nën pseudonimin „FF15“. Pëlqim pozitiv për mospërjashtimin e publikut profesional nga marrja në pyetje e dëshmitarit të mbrojtur dha edhe Prokurorja publike, si përfaqësuese e prokurorisë dhe propozues i dëshmitarit, me çka për herë të parë Prokuroria publike tregoi vullnet për një transparencë më të madhe në procedurën e marrjes në pyetje të një dëshmitari të mbrojtur. Megjithatë, këshilli vendosi të përjashtojë plotësisht publikun, përfshirë edhe prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, profesor i procedurës penale në Fakultetin e Drejtësisë „Justiniani I“, pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“, si përfaqësues i publikut profesional.

Komiteti i Helsinkit në raportet e veta mujore reagoi se vendimet e vazhdueshme të këshillave për të përjashtuar publikun në rastet kur shfaqen dëshmitarë të mbrojtur, nuk japin hapësirë për të përcaktuar nëse realizohet parimi i një gjykimi të drejtë dhe fer. Në veçanti, nuk e justifikojmë përjashtimin e publikut profesional, i cili vetëm do të vëzhgonte mënyrën e veçantë të dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur, në mënyrë që të përcaktohet zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë mënyrën e mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimin e saj në parimin e gjyqimit të drejtë dhe fer.

Karakteristike është edhe koha e gjatë e shkruarjes, përkatësisht e dorëzimit të vendimit të shkallës së parë të pandehurve që u shpallën fajtorë dhe të cilët janë në paraburgim. Gjegjësisht, vendimi ishte shpallur më 12 korrik 2013, kurse sipas pretendimeve të të pandehurve, vendimi u është dorëzuar pas katër muajsh, pra në nëntor 2013. Konsiderojmë se kjo ndikon seriozisht në zvarritjen e procedurës dhe në të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet në të cilat disa nga të pandehurit janë në paraburgim.

7.3 Tomisllav Kezharovski

Që nga fillimi, Komiteti i Helsinkit ka ndjekur me shqetësim të veçantë rastin e gazetarit të dënuar në mënyrë të paligjshme Tomisllav Kezharovski. Që në fillim të procedurës hetimore, Komiteti konstatoi se këshilli penal i Gjykatës Themelore 1 në Shkup, vendimet për zgjatjen e masës së paraburgimit i morri në një procedurë dhe në mënyrë që bie ndesh me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pati shkelje thelbësore dhe procedurale në lidhje me vlerësimin dhe argumentimin mbi domosdoshmërinë e zgjatjes së paraburgimit nga Gjykata Themelore, kurse Gjykata e Apelit në Shkup nuk veproi mbi ankesën e paraqitur. Në rastin e Tomisllav Kezharovskit, ekzistonte një gjendje e marrjes së vendimeve për zgjatjen e paraburgimit në një mënyrë identike, përmes formulimit stereotip të fjalive dhe pa shpjeguar arsyet pse ekziston rreziku i arratisjes ose i përsëritjes së veprës, gjë që paraqet shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Në tetor të vitit 2013, Gjykata Penale e Shkupit dënoi gazetarin Tomisllav Kezharovski me katër vjet e gjashtë muaj burg. Ky vendim është një precedent serioz, veçmas nëse marrim parasysh se në rajon, nuk është shënuar asnjë rast që një gazetar të dënohet me burgim kaq të lartë, për kryerjen e veprimtarive gazetare. Në kushtet kur liria e mediave dhe liria e shprehjes në Republikën e Maqedonisë rrezikohen seriozisht, vendimi paraqet edhe një mesazh të rradhës për heshtjen dhe censurimin e të gjithë atyre që kanë një qëndrim dhe mendim kritik. Një nga elementët thelbësorë për të cilin Prokuroria Publike duhet të kishte reaguar në kohën e duhur dhe të fillonte një procedurë të re, është kontrolli i pretendimeve të dëshmitarit të mbrojtur në çështjen „Oreshe”, sepse sipas deklaratës së tij, atij i ishte bërë presion për të dhënë një deklaratë të përgatitur nga përfaqësuesit e policisë. Nëse vërtetohen pohimet e dëshmitarit të mbrojtur, atëherë gazetari Kezharovski është ai që zbuloi kryerjen e një vepre penale, e jo kryerësi i një vepre të tillë.

7.4 Miroslav Shipoviq

Kryetari i Këshillit të Komunës Qendër, Miroslav Shipoviq, është edhe një person në listën e të burgosurve politikë, arrestimi dhe ndalimi i të cilit është definuar si politik në Rezolutën 1900 të Këshillit të Evropës të vitit 2012. Gjegjësisht, sipas paragrafit 3 të rezolutës së përmendur, i burgosur politik është personi, heqja e lirisë e të cilit është rezultat i përcaktimit të paraburgimit në kundërshtim me ndonjë prej garancive themelore të përfshira në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe / ose paraburgimi është rezultat i një procedure që është padyshim e padrejtë dhe ka të ngjarë të jetë e lidhur me motivet politike të pushtetit.

Komiteti i Helsinkit arriti në përfundimin se nuk janë përmbushur parakushtet ligjore për përcaktimin dhe zgjatjen e masës së paraburgimit për z. Shipoviqin. Gjegjësisht, ai u përball me akuzën dhe dha mbrojtjen e tij, vullnetarisht dhe më herët seç ishte planifikuar udhëtoi nga SHBA-ja drejt Maqedonisë dhe nuk e ankimoi kërkesën për ekstradim që Maqedonia ia drejtoi Austrisë, me çka u eliminua mundësia e arratisjes. Miroslav Shipoviq më nuk është person i autorizuar në kompaninë ku dyshohet se është kryer vepra penale dhe nuk ekziston asnjë mundësi për të përsëritur ose përfunduar veprën, kurse rreziku i ndikimit të mundshëm tek dëshmitarët është inekzistent sepse hetimi ka mbaruar dhe të gjithë të pandehurit dhe dëshmitarët, tashmë janë dëgjuar nga gjykatësi hetues dhe disa edhe nga këshilli gjyqësor që po shqyrton çështjen. Zgjatja e paraburgimit është në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut edhe për shkak se nuk u përdorën masat më të buta alternative, konkretisht nuk u pranua garancia prej rreth 300,000 eurosh, dhe për shkak të motiveve të dukshme politike të pushtetit, që praktikisht pengojnë vendimmarrjen dhe funksionimin e njëres nga komunat e pakta në shtet, ku shumicën e kanë partitë opozitare në nivel kombëtar.

[KOMUNITETI LGBTI]

Hyrje

Viti i kaluar 2013 do të mbahet mend si një vit i përhapjes së urrejtjes, dhunës dhe rritjes së rrezikut për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, si dhe për të gjitha lesbiket, biseksualët, homoseksualët, transgjinatorët dhe personat ndërseksualë. Lajm i mirë është se viti 2013 do të mbahet mend gjithashtu për forcimin e komunitetit LGBTI dhe forcimin e bashkëpunimit midis organizatave që punojnë për të drejtat e personave LGBTI. Këto procese tregojnë kompleksitetin e momentit në të cilin jetojmë. Të gjitha aspektet e shoqërisë së dhunshme që po i përjetojmë, nuk janë të rastësishme, por një strategji e mirëmenduar për ngulfatjen e individit nga sistemi, i cili për shkak të qasjes së dhunshme nuk është legjitim, por është manipulues dhe si i tillë (do të jetë) është jetëshkurtër. Shtypja dhe fushata homofobike e organizuar e këtij sistemi është e pasuksesshme, sepse ajo që ka arritur (përveç dhunës) është edhe forcimi i vetë komunitetit LGBTI (edhe pse qëllimi ishte të frikësojë dhe ndalojë organizimin e komunitetit, që do ta bënte atë një subjekt relevant politik), si dhe lidhja e organizatave të ndryshme që punojnë në këtë fushë.

Ajo që është më shqetësuese është pasiviteti i institucioneve shtetërore dhe mosndëshkimi i autorëve të dhunës. Deri më tani nuk ka rezultate nga hetimi i udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me sulmet e shumta ndaj Qendrës dhe ndaj aktivistëve. Përfundoi vetëm hetimi dhe procesi gjyqësor kundër sulmuesve të Qendrës që ndodhi më 02 mars, por kjo ndodhi kryesisht për shkak të karakterit etnik të këtij incidenti. Edhe pse në këtë rast një nga dëshmitë kryesore ishin regjistrimet nga kamerat e sigurisë së Qendrës, në rastet tjera incizimet duket se nuk ndihmuan. Ky pasivitet i institucioneve është shqetësues sepse të jep përshtypjen se jo vetëm që mbështesin dhunën ndaj personave LGBTI, por që edhe e promovojnë atë me pasivitetin e tyre.

1. Homofobia dhe dhuna

Vitin e kaluar, veprat penale të urrejtjes ku orientimi seksual ose identiteti gjinor shfaqen si motiv, zunë vendin e dytë në listën e rasteve të denoncuara dhe statistikave të mbajtura nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë. Dhjetë raste janë denoncuar në qytete të ndryshme si Shkup, Manastir, Tetovë.

1.1 Dhuna në familje

Në shkurt, përfaqësuesit e Qendrës vizituan grupe në qytete jashtë Shkupit, për shkak të ndërhyrjes së nevojshme në rastin e një vajze të re që ishte viktimë e dhunës në familje për shkak të orientimit të saj seksual. Përveç dhunës psikologjike dhe fizike, vajza u la në rrugë pa ndihmë financiare për të përfunduar arsimin e saj të detyrueshëm. Qendra ndërhyri si ndërmjetëse midis vajzës dhe Qendrës për Punë Sociale, ku çështja u pranua dhe akoma është në proces. Qendra ndërhyri edhe në shkollën e mesme ku ishte e regjistruar viktimja, me qëllim të heqjes së pengesave, të cilat, duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhej kjo lezbike e re, ia vështirësinin qasjen dhe përfundimin e arsimit të mesëm të detyruar.

Morrëm një denoncim edhe për një rast tjetër të dhunës në familje për shkak të orientimit seksual, të cilin viktimja e denoncoi në polici, por shpejt viktimja hoqi dorë nga vazhdimi i procesit, për shkak të qetësisë së situatës në familje.

Kjo tregon se duhet të reagohet në nivel kombëtar nëpërmjet të forcimit të mbrojtjes juridike të viktimave të dhunës në familje në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke filluar një fushatë për të zvogëluar dhunën në përgjithësi të shkaktuar nga urrejtja për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, me theks të veçantë të dhunës në familje. Gjithashtu presim që institucionet shtetërore të ndërmarrin masa në lidhje me trajnimin dhe sensibilizimin e temës së orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të të gjithë atyre që punojnë në organet dhe institucionet për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna. Qendra e Mbështetjes LGBTI është në dispozicion për të zhvilluar kurrikula të përshtatshme në këtë drejtim.

Dhuna ndodh, ndërsa për shkak të mungesës së praktikës në sistem dhe institucione, lihet hapësirë për një qasje selektive që zvogëlon mbrojtjen për viktimat e dhunës.

1.2 Dhunë ndaj aktivistëve në Manastir

Më 20 prill të vitit 2013, aktivistë të „LGBT United” dhe Koalicionit „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” zhvilluan aktivitete publike në Manastir, në kuadër të projektit „Iniciativa Civile për të Drejtat LGBT”. Aktivistët e të drejtave të njeriut vendosën pankarta me përmbajtje promovuese në lidhje me të drejtat e njeriut të personave LGBT dhe ecën nëpër „Shirok Sokak” me flamur me ngjyrat e ylberit.

Menjëherë pasi u larguan nga zona „Shirok Sokak”, para hotelit „Diamond”, aktivistët u sulmuan, fillimisht nga katër persona, dhe më vonë atyre iu bashkangjitën edhe tre

banditë të tjerë. Aktivistëve iu rrëmbyen me forcë pankartat që promovonin barazinë, mosdiskriminimin dhe jodhunën. Tre aktivistë u poshtëruan, u pështynë, u shtynë, u goditën me shuplaka në fytyrë dhe me pankarta në kokë. Kur një aktiviste ka bërtitur „Mos e godit”, atë e kërcënuan dhe i thanë: „Pankarta për pederastë vendosni në Shkup, jo këtu në Manastir!... Do t’ju rrah, përcillja të gjithëve! Kanë ardhur të kërkojnë barazi në Manastir?!” Kur një nga aktivistët e sulmuar u përpoq të kërkonte ndihmë përmes telefonit, njëri nga dhunuesit ia ka marrë telefonin nga dora dhe e ka kërcënuar me fjalët: „Unë do të të shqyej!”. Dhunuesit ua kanë marrë pankartat, telefonin e kanë hedhur në tokë dhe janë larguar. Dhuna ndaj aktivistëve LGBT është denoncuar menjëherë në stacionin policor në Manastir.

Sapo janë larguar sulmuesit, aktivistët kanë denoncuar sulmin në polici dhe i bënë thirrje Ministrisë së punëve të Brendshme t’i gjejë autorët dhe t’i sjellë para drejtësisë.

Pas sulmit, grupi LGBT United mori disa kërcënime për sulme fizike, ndonjëherë edhe kërcënime me vdekje, në web faqen e vet në Facebook. Një fotografi e aktivistëve u postua në faqen Facebook të grupit të tifozëve, me mbishkrimin „Në Manastir nuk do të shkelin këmbët e pederastëve”.

1.3 Sulme ndaj Qendrës për mbështetje LGBTI

Qendra e mbështetjes LGBTI u sulmua tri herë, ndërkaq herën e parë ndodhi në hapjen e Javës së krenarisë, përderisa brenda kishte njerëz. Edhe pse, me rastin e kësaj ngjarjeje, nga Ministria e punëve të Brendshme, me kohe u kërkua sigurim, madje u dorëzua edhe një vlerësim i sigurisë, Ministria e Punëve të Brendshme nuk arriti të mbrojë Qendrën dhe njerëzit që kishin ardhur në hapjen e Javës së Krenarisë. Atmosfera u ndez paraprakisht nga mediat, të cilat në muajin qershor njoftuan për një „paradë homoseksuale”, edhe pse ishte organizuar vetëm Java e Krenarisë, me më shumë shfaqje filmash, promovime, etj. Shtrembërimi i tillë i informatave çoi në dhunë në pjesën e tretë të muajit. Qendra LGBTI u sulmua për herë të katërt, dhe ky ishte sulmi i parë që ndodhi gjatë ditës kur në Qendër kishte rreth dyzet vizitorë. Grupet shfaqën dhunë edhe ndaj kalimtarëve të rastit në Sheshin „Maqedonia”. U regjistruan katër raste të tilla. Gjegjësisht, më 22 qershor të vitit 2013, pas paralajmërimit, marshimi kundër homoseksualëve filloi në orën 14, para Katedrales „Kliment Ohridski”, vazhdoi drejt Parlamentit të RM - së dhe përfundoi në Sheshin „Maqedonia”. Rreth orës 15:10 në Sheshin „Maqedonia”, katër persona të mitur u sulmuan nga një grup njerëzish që ishin pjesë e marshit kundër homoseksualëve. Incidenti u denoncua në polici, me ç’rast nga Ministria e Punëve të Brendshme mohuan të ketë ndodhur sulmi mbi të miturin, i cili mori plagë më të rënda nga një grup. Sidoqoftë, regjistrimet nga celularët dhe disa prej mediave, tregojnë se si pas sulmit grupi i njerëzve ik në drejtim të Qendrës Tregtare të Qytetit. Në buletin e MPB-së ende nuk ka asnjë

informacion në lidhje me sulmin, ndërsa zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme deklaroi se policia po ndërmerr të gjitha masat për gjetjen e autorëve. Pas këtij sulmi ndaj një të mituri, gjatë shfaqjes së një filmi, promovimit të një manuali dhe një debati në temë rreth personave transgjjinorë, në ambientet e Qendrës së Mbështetjes LGBTI, Qendra u sulmua nga rreth 40 persona të maskuar. Grupi kaloi në afërsi të Qendrës duke vrapuar dhe duke hedhur shishe qelqi, gurë dhe sende të tjera drejt vitrinës së Qendrës, me ç'rast u thye xhami. Në kohën e sulmit, në ambientet e Qendrës ndodheshin gjithashtu dyzet persona, dhjetë prej të cilëve ishin në katin poshtë, dhe disa prej tyre ishin ulur në hapësirën pranë xhamit, me ç'rast jeta e tyre u rrezikua drejtpërsëdrejti. Gjatë sulmit, në Qendër gjithashtu ishte i pranishëm një oficer policie.

Ndërsa përpiqeshin të mbrohen nga objektet e hedhura dhe xhamat, të pranishmit u drejtuan në ambientet e pasme, ku drejtoresha ekzekutive e Komitetit të Helsinkit u plagos lehtë, ndërsa polici doli para Qendrës dhe ishte një shënjestër e drejtpërdrejtë e disa prej sulmuesve. Sulmi përfundoi shpejt, ndërsa në katin e sipërm, ku mbahej promovimi i manualit, paniku u parandalua dhe ngjarja vazhdoi në një atmosferë të qetë. Komiteti i Helsinkit u kujdes për sigurinë e të gjithë të pranishmëve, deri në largimin e tyre.

Komiteti i Helsinkit reagoi zyrtarisht ndaj Buletinit Ditor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 23.06.2013, për shkak të përshkrimit dhe klasifikimit jo të plotë dhe të pasaktë të fakteve në lidhje me ngjarjen. Gjithashtu në të nuk përmendet shkelja e barazisë së qytetarëve, të cilën e shkaktuan njerëzit në turmë duke sulmuar ngjarjen kulturore dhe sociale me të cilën filloi „Java e Krenarisë” në Shkup. Gjithashtu, në buletin nuk përmendet fare fakti se në kohën e sulmit, dyzet persona, mysafirë dhe organizatorë të „Javës së Krenarisë” ishin të pranishëm në ambientet e Qendrës, si dhe persona të punësuar në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë. gjë që lë hapësirë për dyshime të arsyeshme se shënjestra e sulmit nuk ishte vetë Qendra Mbështetëse LGBTI, por edhe personat që ndodheshin aktualisht në ambientet e Qendrës, gjë që shkaktoi rrezik të konsiderueshëm për jetën dhe trupin e të pranishmëve. Gjithashtu nuk përmendet fare që oficeri i uniformuar i policisë u plagos gjatë sigurimit të ngjarjes.

Përpjekje për të vënë flakën në Qendër, pas takimit me përfaqësuesit e trupit diplomatik

Më 04.07.2013 në ambientet e Qendrës Mbështetëse LGBTI, në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, përfaqësuesit e trupit diplomatik u takuan me anëtarët e komunitetit LGBTI dhe me përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit.

Pavarësisht thirrjeve nga Qendra e Mbështetjes LGBTI dhe Komitetit të Helsinkit, nuk pati asnjë reagim nga institucionet shtetërore, as nga presidenti dhe kryeministri, gjë që i bën ata mbështetës të dhunës, përderisa jetët e një grupi të madh njerëzish rrezikohen çdo

ditë. Vetëm disa orë pas takimit të trupit diplomatik në Qendër, u bë një përpjekje e re për të djegur Qendrën e Mbështetjes. Institucionet edhe më tutje mbetën të heshtura.

1.4 Sulmet ndaj shtëpisë së aktorit Petar Stojkoviq

Niveli i rritur i homofobisë së shprehur publikisht shihet edhe në aspekte të tjera. Tri ditë pas sulmit në Qendrën LGBTI, më 25 qershor, u sulmua shtëpia e aktorit Petar Stojkoviq, i cili disa ditë më parë deklaroi publikisht orientimin e tij seksual. Sulmi në fakt ishte hedhje gurë drejt shtëpisë në orën 22:50 të mbrëmjes, i ndjekur nga thirrjet: „Pederastë! Do t’ua shkërdhejmë mamanë tuaj pederaste!” Për fat të mirë, askush nuk u lëndua dhe nuk pati dëme materiale. Rasti u raportua në polici dhe hetimi është ende duke vazhduar.

2. Institucionet

Në Republikën Maqedonisë, përvojat e diskriminimit bazuar në orientimin seksual janë injorante dhe plot paragjykime, urrejtje dhe dhunë. Nuk ka ndonjë legjislacion specifik për mbrojtjen e të drejtave të personave transgjiorë dhe orientimi seksual përmendet vetëm në disa ligje, ku nuk parashikohet shprehimisht si bazë për diskriminim, kurse gjykatat dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk e zbatojnë atë as tërthorazi si bazë në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, megjithëse në këtë i detyron legjislacioni evropian në këtë fushë.

Raportet e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi nuk përmbajnë të dhëna për rastet e diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe / ose identitetin gjinor. Në praktikën e shtetit, ekziston një obstrukcion institucional i dukshëmrisë së këtij lloji të diskriminimit, ndërsa nxitja dhe përhapja e urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes ndaj personave të komunitetit LGBTI nga serviset mediatike qeveritare dhe proqeveritare, përkeqësojnë më shumë situatën. Përherë e më shumë jemi dëshmitarë të veprave të urrejtjes, sulmeve ndaj njerëzve që marrin pjesë në manifestime të popullatës LGBTI dhe kush e di se sa herë sulmohen ambientet e Qendrës së Mbështetjes LGBTI.

Urgjentisht duhet të ndiqen rastet e dhunës ndaj anëtarëve të popullatës LGBTI, veçanërisht ato ku ka pasivitet të organeve shtetërore në zbulimin dhe ndjekjen penale të autorëve. Rasti i demolimit dhe djegies së Qendrës Mbështetëse LGBTI në Çarshinë e Vjetër të Shkupit është një shembull tipik i një rasti që duhet të procedohet duke nxjerrë në pah rrethanat rënduese të urrejtjes ndaj popullatës LGBTI, nga i cili është „frymëzuar” edhe pasiviteti i policisë dhe sistemit të injorimit të implementuar nga qeveria. Ndër rastet që duhet të procedohen urgjentisht është rasti i dhunës ndaj një aktivisti, pjesëmarrës

në një manifestim LGBTI, duke theksuar rrethanat rënduese të dhunës të frymëzuar nga urrejtja, ndaj një anëtari të një popullate të prekshme LGBTI.

Pas sulmeve ndaj Qendrës, aktivistëve në Manastir dhe incidenteve të tjera të dhunshme, aktivistët i bënë thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme t'i gjejë autorët dhe t'i përballë me drejtësinë. „LGBT United“, Koalicioni „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara“, Qendra për Mbështetje LGBTI dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë kërkuan nga Qeveria që të dënojë publikisht dhunën dhe gjuhën e urrejtjes ndaj personave LGBT dhe të ndalojë me fushatat diskriminuese të cilat promovojnë urrejtje, mostolerancë, përjashtim shoqëror dhe dhunë ndaj personave LGBT. Ende nuk ka asnjë dënim publik nga institucionet. Gjithashtu, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi kërkoi nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë të shqyrtojë Raportin e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi dhe të kërkojë informacion të detajuar mbi dobësitë e theksuara. Rrjeti arriti në përfundimin se raporti ka një numër mangësish, se nuk verifikon tendencat e diskriminimit në vitin 2012, dhe nuk verifikon për ç'arsye, në bazë të caktuar të diskriminimit, ka numër të shtuar të parashtrësave. Komisioni krijon një situatë të paraqitjes joreale të situatës me diskriminim, por sigurisht që kjo nuk është hera e parë që të vihet në dyshim mënyra e punës së vetë Komisionit. Në raportet e kaluara, tashmë disa herë është vënë në dukje se Komisioni nuk funksionon si një organ i pavarur.

Funksionimi i institucioneve shënon një shkelje tjetër të të drejtave, kësaj here në lidhje me personat transgjnorë. Gjegjesisht, një anëtare e grupit për mbështetjen e personave transgjnorë paraqiti kërkesë për njohjen e gjinisë dhe ndryshimin e dokumentacionit personal. Për kërkesën, u dha përgjigje negative, gjë që paraqet vendim arbitrar, duke qenë se në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston ligj që rregullon statusin specifik të personave trans, kështu që vendimet e institucioneve, si në këtë rast, varen nga shkalla e paragjykitit të nëpunësve publikë. Kjo është absolutisht e papranueshme, dhe për fat të keq, nuk është rasti i parë në të cilin pa ndonjë bazë ligjore është refuzuar kërkesa për ndryshimin e numrit amë nga një person trans.

Në promovimin e Raportit në hije, që u zhvillua më 23.05.2013, mes tjerëve, morrën pjesë, edhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme si dhe të Këshillit të radiodifuzionit. Këshilli i radiodifuzionit ishte i vetmi subjekt që në web faqen e vet publikoi Rekomandimin e Këshillit të Evropës mbi diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjnor. Megjithatë, vetë Raporti në hije, dëshmon për mungesën e vullnetit për bashkëpunim nga ana e institucioneve. Në Raport, disa herë është theksuar se institucionet nuk u përgjigjen as kërkesave për të dhënë informacione të karakterit publik, të dërguara nga Komiteti i Helsinkit. Raporti gjithashtu pasqyron nevojën për të miratuar ligje që përfshijnë orientimin seksual dhe identitetin gjnor. Është e qartë nevoja për sensibilizim të nëpunësve publikë, në mënyrë që ata të mos veprojnë ekskluzivisht sipas bindjeve të tyre personale, por koncepti i të drejtave të njeriut të bartet në praktikën e institucioneve

dhe të rregullohet me dispozita ligjore në të gjitha fushat.

Gjatë qershorit, institucionet përsëri heshtën pas dhunës ndaj komunitetit LGBTI. Pas dhunës ndaj të miturve në sheshin e qytetit, dhe menjëherë pas kësaj, sulmit ndaj Qendrës së Mbështetjes LGBTI dhe njerëzve që ishin aktualisht në të, asnjë zyrtar qeveritar nuk doli me një dënim publik të dhunës ndaj këtij grupi qytetarësh. Gjithashtu nuk pati kurrfarë reagimi as nga ana e Ombudsmanit, madje as për sulmet ndaj të rinjve në sheshin e qytetit. Megjithëse sulmet e tilla paraqesin vepër penale, për çka autorët ndiqen sipas detyrës zyrtare, joefikasiteti i organeve kompetente dhe mekanizmave për zbatimin e ligjit ishte i dukshëm në disa raste, kështu që sulmi i 22.06 ishte vetëm edhe një sulm i rradhës ndaj Qendrës LGBTI, i cili iu shtua listës së sulmeve, për të cilat ende nuk është arrestuar ose akuzuar asnjë person. Do të theksojmë përsëri se ky trajtim i situatës nga Ministria e Punëve të Brendshme tregon papërgjegjësinë e tyre dhe mungesën e vullnetit për të përmbushur detyrimet për mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, dhe u jep legjitimitet të rrejtshëm individëve dhe grupeve që mospranimin kanë vendosur ta shprehin nëpërmjet të dhunës, duke praktikuar drejtpërsëdrejti mosndëshkimin e autorëve dhe heshtje në një situatë të kërcënimit të drejtpërdrejtë të jetës së një pjese të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Subjektet e vetme politike që kanë folur pas dhunës ndaj komunitetit LGBTI janë Rilindja demokratike e Maqedonisë, Partia Liberal Demokratike dhe Partia Liberale, të cilat deklaruan se dënojnë publikisht vandalizmin dhe presin që policia të gjejë autorët, pasi mosndëshkimi i autorëve inkurajon dhunën edhe ndaj qytetarëve të tjerë të këtij shteti.

Në diskutimin e ashpër mbi Ligjin për ndërprerjen e shtazanisë, Ministri i Shëndetësisë Nikola Todorov, ashpërsoi më tej atmosferën, duke u përpjekur të diskreditojë organizatat civile që votuan kundër një ligji të tillë, vetëm për faktin se disa nga ato organizata, ndërmjet tjerash punojnë edhe me popullatën LGBTI në Republikën e Maqedonisë.

Gjykata themelore Shkupi 1 solli vendim me të cilin u shpallën fajtorë anëtarët e turmës që gjatë protestave të 02 marsit (protestat për ministrin Talat Xhaferi) kryen veprën penale „Pjesëmarrje në turmë që do të kryejë vepër penale“. Gjatë protestës u sulmua edhe Qendra për mbështetje LGBTI. Për protestat e 02 marsit, 14 të pandehurit u dënuan me gjithsej 12 vite burg. Komiteti i Helsinkit dhe Qendra e Mbështetjes LGBTI e mirëpritën vendimin.

Më 01 gusht, një ditë para se Parlamenti të shkonte në pushim vjetor, partia në pushtet VMRO-DPMNE paraqiti në Parlament propozim për ndryshime në Kushtetutë, sipas të cilave martesë përcaktohet ekskluzivisht si bashkësi midis një burri dhe një gruaje. Me ndryshimet e reja, birësimi i fëmijëve do të lejohej vetëm për bashkësinë e përbërë nga prindër të gjinive të ndryshme, si dhe për prindër të vetëm.

Debati mbi projektligjin mbi ripërcaktimin kushtetues të martësës vazhdoi edhe në shtator. Më 23 shtator, deputetët në Parlament filluan debatin mbi propozimin për ndryshime të Kushtetutës në pjesën e përcaktimit të martësës ekskluzivisht si bashkësi midis një burri dhe një gruaje, të paraqitur nga deputetët e shumicës qeverisëse. Argumenti kryesor i Vladimir Gjorçevit, deputet i VMRO-DPMNE në pushtet, partisë e cila propozoi ligjin, ishte se me ndryshimet në Kushtetutë do të parandalohet që ndonjë qeveri e ardhshme me një shumicë të thjeshtë prej 42 deputetësh, të ndryshojë Ligjin për familjen, i cili tashmë përcakton martësën si bashkësi midis burrit dhe gruas, ndërsa për ndryshimet në Kushtetutë kërkohet shumicë prej dy të tretave, dhe të gjitha këto me qëllim që të ruhen vlerat tradicionale të familjes. Në këtë u ndërlidh deputeti Dragisha Miletij, nga koalicioni opozitar, i cili në fjalën e tij deklaroi qartë se homoseksualitetin e konsideron sëmundje dhe e justifikon ndëshkimin e homoseksualitetit. Vijuan edhe disa shaka homofobike të deputetit në llogari të popullatës LGBTI. Deputeti i Partisë Liberale, Ivon Veliçkovski kundërshtoi, duke thënë se veprimet e partisë në pushtet nuk shkojnë në favor të ruajtjes së vlerave tradicionale dhe kërkoi një qasje më tolerante ndaj grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara. Debati i tillë midis deputetëve Miletij dhe Veliçkovskit provokoi një reagim të kryetarit të grupit parlamentar të LSDM, Igor Ivanovski, i cili në shenjë proteste kërkoi pushim gjysëmorësh dhe tha se debate të tilla „e kthyen Parlamentin në një leckë”. Ndaj deklaratave të deputetit Miletij reagues organizatat civile duke e cilësuar fjalimin e tij homofobik, diskriminues dhe zhvlerësues për komunitetin LGBTI dhe mendojnë se në një shoqëri demokratike, çfarë aspiron të bëhet shoqëria maqedonase, nuk ka vend për një gjuhë të këtillë. Paralajmëruan edhe ankesë deri tek Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi. Drejtori i Komisionit, Dushko Minovski tha se ata do të presin ankesën, do të shqyrtojnë rastin e gjuhës së urrejtjes në Parlament dhe do të reagojnë në mënyrë përkatëse. Nga ana e Komisionit nuk kishte asnjë iniciativë vetanake dhe vullnet për një shqyrtim më të thellë të rastit.

3. Korniza ligjore

Qendra për Mbështetje LGBTI si një filial i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), zyra në Shkup, filloi me implementimin e projektit Forcimi i kapacitetit të organizatave civile për të marrë pjesë në procesin legjislativ, ku Qendra do të angazhohet për zbatimin e iniciativës legjislative „Neni 3” - Nisma civile për harmonizimin e të drejtës kombëtare antidiskriminuese me të drejtën e BE-së. Qëllimi i projektit është i kufizuar në Nenin 3 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe aktivitetet e Qendrës Mbështetëse LGBTI do të përqëndrohen në përcaktimin ligjor të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza të veçanta të mundshme për diskriminim, përmes miratimit të një Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut si një vlerë universale, me

interes për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë, dhe duke pasur parasysh që Qendra parimisht është e hapur për pjesëmarrje të sa më shumë të interesuarve, realizimi i projektit do të koordinohet përmes një grupi punues, i përbërë nga disa organizata, aktive në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve të marginalizuara. Kështu, kjo mundësi mund të shfrytëzohet për të inkorporuar të gjitha bazat tjera, që mund të mos jenë përfshirë në Nenin 3, duke zgjeruar mbrojtjen e nevojshme nga diskriminimi të grupeve më të marginalizuara në shoqërinë tonë.

Ligji për ndërprerjen e shtatzanisë

Në fund të majit, Qeveria, me procedurë të shkurtuar, Parlamentit të Republikës së Maqedonisë ia paraqiti Projektligjin për ndërprerjen e shtatzanisë. Përkundër reagimeve të shumta mediatike dhe protestave të përfaqësuesve të më shumë qytetarëve dhe organizatave vendase dhe të huaja, përfshirë përfaqësuesit e Qendrës për Mbështetje LGBTI, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Koalicionit „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara“, H.E.R.A. dhe të tjerë, megjithatë, projektligji për ndërprerjen e shtatzanisë, me procedurë të shkurtuar u miratua më 10.06.2013.

Në përgjigje të protestave të komunitetit LGBTI në lidhje me miratimin e ligjit të ri për ndërprerjen e shtatzanisë, Ministri i Shëndetësisë, Nikola Todorov, shfrytëzoi foltoren parlamentare për të thënë „Nuk mund të besohet që me organizata që përfaqësojnë të drejta të këtilla (LGBTI) mund të pajtohem për çështjen e abortit“ dhe „Dje debatuan organizata që merren me të drejtat e burrave me burra, grave me gra dhe të atyre që kanë ndryshuar gjininë ... dhe si mund të harmonizoni qëndrim me një organizatë të tillë“. Deklaratat e Ministrit Todorov janë homofobe, diskriminuese dhe synojnë që diskutimit mbi ligjin t'i japin një dimension vlere që nuk është lëndë e rregullimit të tij, me çka vëmendja e opinionit largohet nga diskutimi në fjalë. Si të tilla, deklaratat e Ministrit janë të papranueshme, veçanërisht për shkak të pozitës së tij - anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përveç kompetencave të tjera, ka për detyrë të monitorojë dhe analizojë gjendjet për realizimin dhe përparimin e të drejtave të njeriut dhe lirive civile, dhe sigurisht që nuk mund ta bëjë këtë duke përhapur gjuhë të urrejtjes përmes deklaratave publike homofobe dhe diskriminuese të ministrave të saj.

Ligji i ri, në vend që të bëjë ndryshime të caktuara në favor të grave, t'i edukojë dhe informojë ato për të drejtat e tyre riprodhuese, përkundrazi, e ndërlikon procedurën, delegjitimon të drejtën për të zgjedhur, nënvlerëson inteligjencën e një gruaje që është e vetëdijshme dhe e di se kur dhe me kë dëshiron të ketë fëmijë. Aborti, para së gjithash është kryesisht një vendim intim i çdo gruaje dhe çdo grua duhet të ketë të drejtën e zgjedhjes së lirë për të planifikuar familjen e saj, të liruar prej burokracisë.

Projektligji fillestar pësoi ndryshime të caktuara në tekstin përfundimtar ligjor, duke

hequr ose ndryshuar disa dispozita, si p.sh. dispozitat për praninë e detyrueshme të bashkëshortit në këshillim, formimin e komisioneve të shkallës së parë në institucionet shëndetësore nga Ministri i Shëndetësisë, dënimet e larta në të holla si dhe inkorporimin e masës burgim për mjekët të cilët nuk i përmbahen dispozitave në ligjin për procedurat që nuk paraqesin kërcënim për jetën, si p.sh. mbajtja e evidencës.

Dispozita për informimin e bashkëshortit cënon drejtpërdrejt të drejtën e lirisë të zgjedhjes së gruas, kështu që kjo dispozitë u hoq nga ligji, gjegjësisht u pranua zgjidhje sipas së cilës, me kërkesë të gruas partneri mund të marrë pjesë në seancën e komisionit të shkallës së parë. Nëse do të pranohej informimi i detyrueshëm i burrave, pa respektuar vullnetin e grave, do të ekzistonte mundësia reale që gratë të sanksionoheshin moralisht, veçanërisht kategoritë e ndjeshme sociale të grave, si dhe gratë që jetojnë në zonat rurale, me vetëdije më të ulët.

Me ndryshimin e bërë në tekstin ligjor, komisionin e shkallës së parë për ndërprerjen e shtatzanisë do ta formojë drejtori i institucionit shëndetësor në të cilin do të kryhet aborti. Kjo është zgjidhje më e pranueshme, sesa formimi i komisioneve të shkallës së parë në institucionet shëndetësore të jetë nën kompetencat e Ministrisë të Shëndetësisë, me çka do të burokratizohet më tej procedura për gruan që ka paraqitur kërkesën, kurse tërthorazi ministri do të kishte rolin e personit që vendos nëse do të pranohej apo jo kërkesa e gruas.

Dënimet e larta në të holla për mosmbajtjen e evidencës, që ishin të përfshira në projektligj, nuk korrespondojnë me ndëshkimet për kryerjen e ndërhyrjeve të tjera mjekësore, dhe në të njëjtën kohë dëmtonin reputacionin e mjekëve dhe profesionin e mjekut, kështu që u përjashtuan nga teksti i miratuar ligjor.

Megjithëse u bënë ndryshimet e lartpërmendura në tekstin ligjor, mbetet mendimi se Ligji i ri për Abortin cënon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe meqenëse është një ligj kompleks që rregullon një çështje specifike, ai duhet të ishte miratuar në një procedurë të rregullt me përfshirjen e opinionit profesional, organizatave civile dhe të gjithë aktorëve të tjerë të rëndësishëm në shoqëri. Duke kontrolluar riprodhimin femëror, gratë diskriminohen drejtpërdrejt dhe theksohet pabarazia e tyre në shoqëri.

4. Mediat

Përfundimi i përgjithshëm është se vitin e kaluar mediat kryesisht raportuan në mënyrë sensacionale, negative dhe madje edhe nxitëse në momente të caktuara, duke mbajtur kështu një pjesë të përgjegjësisë për dhunën dhe përjashtimin e personave LGBTI në shoqërinë tonë. Një numër i vogël i mediave të pavarura raportuan në mënyrë etike, duke promovuar parimin e të drejtave të njeriut.

Në qershor, veçanërisht në gjysmën e dytë të muajit, hapësira mediatike u duk e përmbytur me artikuj dhe raporte mbi tema që adresojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çështje me interes për komunitetin LGBTI. Artikujt kryesisht u referohen raporteve për manifestimin „Java e Krenarisë“, organizimit dhe realizimit të protestës kundër homoseksualëve, dhunës anti-LGBTI që ndodhi në qershor, reagimeve të sektorit të OJQ-ve dhe partive politike në lidhje me të dhe mendimet dhe qëndrimet homofobike që Ministri i Shëndetësisë i RM - së, z. Nikola Todorov i ndau me publikun përmes foltores parlamentare. Duhet të theksohet se hapësira mediatike shënon rritje të mbulimit të temave që me të vërtetë përpiqen të analizojnë ndikimin më të gjerë shoqëror të dhunës ndaj komunitetit LGBTI. Ekziston gjithashtu një shkallë e keqkuptimit thelbësor në media rreth çështjeve që prekin komunitetin LGBTI, i cili mund të ketë luajtur një rol kryesor në përshkallëzimin e nivelit të homofobisë, gjuhës së urrejtjes dhe thirrjeve të hapura për dhunë ndaj komunitetit LGBTI, e që i paraprinë sulmit ndaj Qendrës për Mbështetje LGBTI.

Komuniteti LGBTI u mbulua nga pasqyrimi mediatik i deklaratave homofobike dhe diskriminuese të Ministrit të Shëndetësisë z. Nikola Todorov, i cili përdori foltoresh parlamentare për të thënë „Nuk mund të besohet se me organizata që mbështesin të drejta të tilla (LGBTI) mund të biem dakord mbi çështjen e abortit“ dhe „Dje debatuar për organizatat që merren me të drejtat e burrave me burra, gra me gra dhe ato që kanë ndryshuar gjini ... dhe si me një organizatë të tillë do të harmonizoni pozicionin tuaj“, si dhe duke mbuluar reagimin e sektorit të OJQ-ve ndaj deklaratave homofobike të Ministrit. Ajo që është karakteristikë e mbulimit mediatik të vetë deklaratës është se asnjë media nuk e karakterizon fjalimin e Ministrit si homofobik ose diskriminues, por përkundrazi, pjesa e fjalimit që i referohej komunitetit LGBTI u përdor në mënyrë të bujshme dhe u vendos në vetë titujt e artikujve të cilët iu referuan fjalimit të Ministrit në tërësi.

Pasqyrimi mediatik i sulmit në Qendrën e Mbështetjes LGBTI më 22.06.2013, si dhe i aktiviteteve të policisë që (nuk) pasuan, u bë në një mënyrë neutrale dhe etike nga numri i vogël i mediave të pavarura. Duhet të theksohet se sulmet ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI nxitën një nivel të caktuar të interesit të medias për të raportuar mbi ndikimin më të thellë shoqëror të dhunës ndaj komunitetit LGBTI. Në hapësirën mediatike mund të vërehen artikuj që u referoheshin të miturve të rrahur pas (mos) mbajtjes së paradës kundër-homoseksualëve dhe sulmit me gurë të shtëpisë së Petar Stojkoviqit. Ajo që mund të vërehet gjithashtu është se disa media dënuan këto sulme, kurse disa media reagues ndaj mungesës së rezultateve për masat e marra nga Ministria e Punëve të Brendshme për të identifikuar autorët e dhunës.

Mbulimi mediatik i debatit parlamentar mbi ndryshimet kushtetuese të propozuara nga partia në pushtet, mund të ndahet në dy pjesë: mbulimi i vetë debatit dhe mbulimi i reagimeve të sektorit të OJQ-ve që i referoheshin debatit. Sa i përket pjesës që mbulon vetë debatin, mund të themi se pasqyrimi mediatik ishte jo i plotë, sensacional dhe shumë sipërfaqësor. Gjithashtu duhet të përmendim se disa media theksuan se „kërcënimi“ i

legalizimit të martesave homoseksuale është abstrakt dhe mbajtën qëndrim kritik ndaj pjesës së parë të debatit, që ishte plot me gjuhë urrejtjeje dhe homofobi, kurse disa media propozimin për ndryshime kushtetuese e panë si një betejë për pikat politike, por fatkeqësisht numri i atyre mediave mbetet akoma shumë i vogël. Paraqitja jo e plotë e situatës i referohet faktit se asnjë nga mediat nuk e lexoi dhe analizoi Nismën për ndryshimin e Ligjit për Familje të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, por vetëm transmetuan informatat e partisë në pushtet, të cilat ishin të pavërteta. Sensacionalizmi dhe tendencioziteti janë më se të dukshëm në përzgjedhjen mediatike se cilat deklarata dhe fjalime deputetësh përcillen në artikuj, me ç'rast dominuan ose ekskluzivisht u përcollën deklaratat dhe argumentet e propozuesit të ndryshimeve kushtetuese. Mënyra objektive dhe etike e raportimit ishte karakteristikë e mbulimit mediatik të reagimeve të sektorit të OJQ-ve në lidhje me debatin parlamentar.

Në nëntor, interes të veçantë për komunitetin LGBTI në Republikën e Maqedonisë ngjalli mbajtja e Marshit të pestë të Tolerancës, me çka zyrtarisht përfundoi dhe u kurorëzua fushata „Maqedonia ka dashuri për të gjithë“, organizuar nga Qendra e Mbështetjes LGBTI dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, me mbështetje të Front Line Defenders (FLD). Sidoqoftë, interesi mediatik që e shkaktoi kjo ngjarje, në fund, nuk mund të mos binte në hijen e sërishme të sensacionalizimit mediatik, shtrembërimit të fakteve dhe prezantimit selektiv të informatave. Gjegjesisht, gjatë vetë fushatës (para njoftimit dhe mbajtjes së Marshit), mbulimi ekzistues mediatik, megjithëse u privua nga vëmendja e shumicës së mediave të televizionit kombëtar, u bë kryesisht në mënyrë etike, neutrale dhe në një mënyrë të ekuilibruar. Por gjërat filluan të ndryshojnë me njoftimin e Marshit të Tolerancës (i cili u zhvillua më 16 nëntor 2013).

Edhe pse fushata e radios ishte e drejtuar kundër dhunës ndaj popullatës LGBTI në RM, marshi ishte një aksion i përbashkët i katërmbëdhjetë organizatave joqeveritare me të cilin shprehën protestë kundër dhunës me të cilën përballemi çdo ditë në shoqërinë tonë. Mbështetja e popullatës LGBTI dhe dënimi i dhunës ndaj tyre ishte vetëm një nga aspektet përmes të cilave u dënua dhuna dhe mosndëshkimi i dhunuesve në RM, por pesë media tona, në shtatë raste të ndryshme panë një mundësi për të karakterizuar të gjithë ngjarjen si „(mini) gej paradë“. Fakti që asnjë nga këto media nuk shkruan për një „paradë homoseksuale“ në asnjë vend në tekst, përveç në titull, lë hapësirë që kjo sjellje mediatike të klasifikohet si liri e „redaktorit“ ose liri e „redaksisë“. Me këtë selektivitet, lexuesi mashtrohet dhe nuk respektohet detyra gazetareske për informim gjithëpërfshirës, duke e lënë gjithë tekstin konfuz, të pakuptueshëm dhe plot kundërthënie dhe të pathëna. Për më tepër, një media dha një klasifikim politik të ngjarjes, duke pretenduar se „në mbrojtje të popullatës gej“ qëndruan më shumë organizata të vogla joqeveritare, ideologjikisht afër opozitës dhe se „midis homoseksualëve dhe biseksualëve ishin edhe gazetarë të punësuar në portalet e opozitës“. Me këtë hap, media e përmendur përsëri dezinformoi publikun, duke diskredituar dhe duke njollosur politikisht të gjithë sektorin joqeveritar në RM, përsëri duke poshtëruar dhe tallur njerëzit LGBTI në Maqedoni, duke i paraqitur

ata si krahasues negativ, midis të cilëve ishin edhe „gazetarë të punësuar në portalet e opozitës”. Gjatë pjesës tjetër të mbulimit të radio fushatës dhe Marshit të Tolerancës, me të cilin përfundoi fushata, mund të themi se u respektuan parimet themelore të gazetarisë, megjithëse u vu re mungesa e një analize thelbësore të ndikimit shoqëror të temës së fushatës.

5. Gjuha e urrejtjes

Më 01.02.2013 në faqen e parë të gazetës ditore „Veçer” doli titulli „A ka homoseksualë midis gazetarëve”, i përcjellë me një tekst, që bënte thirrje për një linç të fshehur përmes etiketimit publik, në mënyrë që të nënvlerësohen individët, për shkak të theksimit të pakuptimtë të orientimit seksual të dikujt. Për shkak të kësaj që u tha më lartë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut reagoi ndaj këtij titulli dhe dërgoi një deklaratë për media, në të cilën, ndër të tjera, dënoi ashpër tekstin e gazetës „Veçer” të datës 01.02.2013.

Si pjesë të reagimit të vet dërguar mediave, Komiteti përkujtoi ndryshimin midis lajmit dhe komentit dhe ndryshimin midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes. Njëherit, përkujtoi kuptimin e thirrjes për linç, të mveshur në petkun e thirrjes drejtuar qytetarëve për të denoncuar individë, gazetarë për të cilët dyshohet se janë persona me orientim homoseksual. Mbrojtja e të drejtës për lirinë e shprehjes nuk do të thotë mbrojtje e gjuhës së urrejtjes, as nuk do të thotë mbrojtje e shprehjeve që nxisin urrejtje dhe dhunë.

Në vazhdim, Komiteti vuri në dukje se angazhimi i disa gazetarëve për gazetari të përgjegjshme dhe informim të pavarur të opinionit, ku gjuha e urrejtjes duhet të hiqet, u sulmua si një fushatë për një paradë homoseksuale që është përtej të gjitha kufijve të së vërtetës. E vërteta që është harruar përmes lojës manipuluese të kësaj gazete të përditshme është të largojë vëmendjen e opinionit nga problemi i vërtetë i rënies së lirisë së gazetarisë, duke drejtuar urrejtjen ndaj gazetarëve të caktuar të paraqitur si homoseksualë. Homoseksualiteti paraqitet si një tipar degradues në mënyrë që të degradojë individët pa ndonjë fakt dhe në të njëjtën kohë çënohet e drejta e tyre për privatësi, gjë që është krejtësisht absurde për një gazetë moderne që ekziston në një shtet demokratik që promovon vlerat e barazisë dhe diversitetit për njerëzit dhe një shtet që është anëtar i Këshillit të Evropës.

Përfundimisht, në deklaratën e vet, Komiteti i bëri thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që më në fund të njohin nevojën për përfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për gjuhën e urrejtjes dhe krimet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, që do të ishte fillimi i realizimit të parimit të respektimit të diversitetit, i cili duhet të jetë një nga parimet themelore të një shteti demokratik. Përmes kësaj deklaratë, Komiteti u bëri thirrje qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që të mos

marrin pjesë në aktivitete që do t'i japin legjitimitet urrejtjes, që po përpiqen të nxisin disa media të caktuara, sepse kushdo që kontribuon në këtë thirrje, bëhet bashkëpunëtor i drejtpërdrejtë në këto veprime.

6. Mbështetja ndërkombëtare

Takim me përfaqësuesit e trupit diplomatik në Qendrën e Mbështetjes LGBTI

Më 4 korrik 2013, në ambientet e Qendrës Mbështetëse LGBTI në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, përfaqësues të trupit diplomatik u takuan me anëtarët e komunitetit LGBTI dhe me përfaqësues të Komitetit të Helsinkit. Në takim morën pjesë përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Ambasadës së Hollandës, Ambasadës së Suedisë, Ambasadës së Gjermanisë, OSBE-së dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Maqedoni. Ata u njohën me sulmin ndaj Qendrës Mbështetëse LGBTI më 22.06.2013, i cili ndodhi në fillim të „Javës së Krenarisë“, kur një grup prej rreth 30 personash të maskuar sulmuan Qendrën, kurse gjatë sulmit në mjediset e saj kishte rreth 40 persona - organizatorë, bashkëpunëtorë dhe mysafirë. Përfaqësuesit e trupit diplomatik gjithashtu shikuan edhe videon nga kamerat e sigurisë të Qendrës Mbështetëse LGBTI të xhiruar gjatë sulmit. Ambasadorët mbështetën komunitetin LGBTI, dënuan sulmin e 22 qershorit ndaj Qendrës për Mbështetje LGBTI, u bënë thirrje institucioneve maqedonase të mundësojnë të drejta të barabarta për personat LGBTI, të përfshihen në mënyrë aktive në luftën kundër diskriminimit dhe theksuan se një dhunë e tillë nuk guxon të mbetet pa u ndëshkuar nga sistemi juridik dhe shprehën shpresë se autorët do të gjenden.

Human Rights Watch i dërgon letër Kryeministrit Nikolla Gruevski

Organizata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut “Human Rights Watch” më 10.07.2013 i dërgoi letër Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë, Nikola Gruevskit, Presidentit Ivanov dhe Ministrit të Drejtësisë, Bexheti, në të cilën kjo organizatë shpreh shqetësimin për atmosferën aktuale homofobike në të cilën jeton komuniteti LGBTI në Republikën e Maqedonisë, e përcjellë nga një seri sulmesh në qershor dhe korrik të këtij viti ndaj përfaqësuesve të saj, aktivistëve dhe ambienteve. Gjegjësisht, të shqetësuar për faktin se as Kryeministri, as dikush tjetër nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk i ka dënuar këto sulme në publik, dhe as nuk i kanë bërë thirrje popullit maqedonas që të përmbahet nga diskriminimi i bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor, „Human Rights Watch“ beson se mungesa e përgjigjes së Qeverisë ndaj këtyre sulmeve, rrezikon më tej personat LGBTI në Maqedoni dhe vë në pikëpyetje angazhimin e qeverisë ndaj parimeve të mosdiskriminimit dhe barazisë.

Takim me Raportuesin e Parlamentit Evropian për Republikën e Maqedonisë

Raportuesi Special i Parlamentit Evropian për Republikën e Maqedonisë, z. Richard Howitt dënoi ashpër dhunën anti-LGBTI në Maqedoni gjatë takimit të mbajtur më 29 tetor 2013 në Qendrën Mbështetëse LGBTI midis delegacionit të PE, përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë dhe Qendrës së Mbështetjes LGBTI.

Në takim, z. Hovit u njoftua se nuk ka përparim në hetimin e katër, nga pesë sulmet ndaj Qendrës së Mbështetjes LGBTI, edhe pse sulmi i parë ndodhi pikërisht një vit më parë. U diskutua edhe për heshtjen institucionale dhe në përgjithësi për mungesën e dialogut mbi kërcënimet dhe krimet e urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, niveli i të cilave po rritet në mënyrë drastike. Mungesa e dënimit publik nga institucionet kompetente që janë të detyruara të mbrojnë të gjithë qytetarët e tyre pa diskriminim, si dhe shkalla e ulët e ngritjes së procedurave gjyqësore në rastet e dhunës anti-LGBTI, tregojnë se dhuna anti-LGBTI në Republikën e Maqedonisë jo vetëm që tolerohet, por edhe inkurajohet.

Raportuesi i PE për RM, z. Hovit, në takim theksoi mbështetjen e Bashkimit Evropian për të drejtat e personave LGBTI dhe shprehu keqardhje për rritjen e dhunës të motivuar nga urrejtja ndaj personave LGBTI në RM. Ai gjithashtu foli për politikën e BE në lidhje me gëzimin e të drejtave themelore të njeriut dhe barazinë e qytetarëve para ligjit dhe gjithashtu përmendi detyrën e shteteve për të mbrojtur të gjithë qytetarët e tyre, pa një qasje selektive.

Radio fushata - Maqedonia ka dashuri për të gjithë

Pas atmosferës së krijuar të frikshme homofobike dhe pesë sulmeve, Qendra për Mbështetje LGBTI vazhdon në rrugën e saj dhe përpiqet të arrijë qëllimin - barazi për të gjithë njerëzit në Republikën e Maqedonisë.

Në vigjilje të rihapjes së qendrës në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe mbajtjes së Marshit të pestë të Tolerancës, Qendra për Mbështetjen LGBTI dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, me mbështetje të „Front Line Defenders“ (FLD) bënë një radio fushatë „Maqedonia ka dashuri për të gjithë“, e cila kryesisht përqëndrohet në dënimin e dhunës dhe mbështetje për personat LGBTI.

Gjëja më e rëndësishme është që në këtë proces të ringjalljes së komunitetit LGBTI dhe vazhdimin e luftës për barazi, komuniteti LGBTI nuk u tërhoq dhe nuk iu nënshtrua sulmeve të vazhdueshme, por përkundrazi, në një numër më të madh, shumë më e fortë dhe krenare, del në publik për t'i kërkuar të drejtat e veta. Organizatorët e kësaj fushate u janë mirënjohës të gjithë personave LGBTI që mbrojnë me krenari dhe haptas

të drejtat e tyre dhe morën pjesë në këtë fushatë, prindërve të tyre dhe të gjithë figurave publike që solidarizohen në këtë fushatë, duke mbrojtur barazinë, lirinë dhe dinjitetin.

Lidhur me përgatitjen dhe lançimin e kësaj fushate, FLD deklaroi se përkrahin me krenari këtë fushatë në mbështetje të mbrojtësve të të drejtave LGBTI në Maqedoni dhe besojnë se dhuna dhe diskriminimi ndaj komunitetit LGBTI dhe targetimi i atyre që punojnë për të përmirësuar të drejtat e njeriut është diçka për të cilën nuk ka vend në asnjë shoqëri sot. Për FLD, radioja është një medium që mund të arrijë tek një audiencë më e gjerë, kështu që kjo fushatë mund të ndihmojë në ndryshimin e diskursit publik dhe të ushtrojë presion mbi pushtetin që të parandalojë dhunën dhe të kërkojë përgjegjësi prej personave që kanë kryer vepra të dhunshme.

